

PAULLINA SIMONS
GJAHTARI I TIGRAVE
LIBRI I PARË I TRILOGJISË
FUNDI I PËRJETËSISË
ROMAN

BOTIMET TOENA

PAULLINA SIMONS

GJAHTARI ITIGRAVE

LIBRI I PARË
I TRILOGJISË
FUNDI I PËRJETËSISË

roman

Përktheu nga origjinali anglisht
Evi Pulla

BOTIMET TOENA
Tiranë

Autori: Paullina Simons
Titulli në original: The tiger catcher
Botoi në anglisht: HarperCollins Publishers

Botuese Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Diana Çuli
Korrektore letrare: Edona Marku
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-376-27-5

© 2019, Paullina Simons

Botuar fillimisht në gjuhën angleze nga HarperCollins Publishers Ltd. me titullin **The tiger catcher**.

© në shqip Botimet Toena

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

Për Tanjën, fëmijën tim të fundit, gëzimin e jetës sime.

*Një përrallë e parrezikshme
nuk tregon të vërtetën për asnjërën botë.*

J. R. R. Tolkien

PROLOG

RRETHI I TRANSITIT

DUHEJTË TË KISHA PUTHUR. XHULIANI ISHTE SHTRIRË lakuriq mbi krevatin e tij, duke shtrënguar në dorë beretën e kuqe, me shikimin ngulur mbi tavan. *Duhej të të kisha puthur herën e fundit që të pashë.*

Pasi kaloi kështu gjysmën e natës, hoqi dorë nga përpjekjet për të fjetur, u ngrit dhe filloi të bëhej gati. Kishte akoma shumë gjëra për të bërë, në mënyrë që të arrinte në Greenwich para orës dymbëdhjetë. Mos u hallakat, i kishte thënë kuzhinieri. Ke shumë pak kohë. Ke një pikosekundë brenda një minute. Dhe mos ngec. Kur të arrish, hapja do të jetë a gjerë sa për një burrë, por jo për çfarëdolloj burri.

Dhe si iu përgjigj Xhuliani?

- Sa zgjat një pikosekundë?

- Sa një e trilionta e sekondës, - ia ktheu kuzhinieri i irrituar.

Xhuliani u vesh me rroba të zeza. U rrua. I kreu flokët e tij kaf të shpupuritur dhe i kapi nga pas që të mos dukej se çfarë ishin - krifa leshtore e një burri që kishte kohë që nuk e çante kokën për asgjë. Xhuliani kishte pasur një fytyrë katrore, me nofull katrore, ballë të drejtë dhe mjekër si prej graniti - dikur. Sytë e tij ngjyrë lajthie tani dukeshin gri, të stërmëdhenj, të fundosur në faqet e tij thatanike, rrathët e zinj poshtë syve, sikur e kishte goditur dikush, goja e thatë. Ishte dobësuar aq shumë sa që iu desh të hapte një vrimë të re te rripi, dhe brenda xhaketës së tij tashmë nxinte dy Xhulianë.

U vonua pak për të dalë: harronte vazhdimisht njëren gjë, pastaj tjetren. Në moment të fundit u kujtua t'i dërgonte një mesazh nënës së tij dhe Eshtonit. Jo ndonjë mesazh alarmues - si për shembull

“më fal” - por gjithsesi, donte t’u linte diçka. Ndonjë shaka që t’i bënte të mendonin se Xhuliani i vjetër ishte akoma aty. Nënës së tij: “Ndihesha si një burrë i zënë kurth në trupin e një gruaje. Pastaj linda”. Eshtonit: “Nuk mund të humbasësh një pëllumb shtëpiak, Esh. Nëse pëllumbi yt shtëpiak nuk kthehet, ajo që ke humbur ishte thjesht një pëllumb”. Megjithëse la një shënim të veçantë për Eshtonin mbi komodinë.

Sipas udhëzimeve, Xhuliani la në shtëpi celularin, portofolin, stilolapsat e tij, si edhe fletoret. La jetën e tij pas, duke përfshirë edhe fjalët që kishte shkruar një ditë më parë, me titull “Kthetrat e Tigrin”:

*Çfarë kërkon nga jeta
Natën botën nuk e ndryshon dot
Dëshirë dehuri tërbim
Fluturon pas
Teksa ti rri shtrirë mbi kurriz
Nën kthetra dhe hardhuca
Në fushat e purpurta.*

Mori me vete katër gjëra: një kartëmonedhë pesëdhjetëpaundëshe, një kartë *Oyster* për në metro, varësen me kristalin rreth qafës së tij, dhe beretën e kuqe në xhepin e tij.

Te *Boots*-i në rrugën “Liverpool” bleu një elektrik dore. Kuzhinieri i kishte thënë që do t’i duhej. Dhe pastaj trenat ishin po aq të ngadaltë sa ai vetë. Xhuliani priti gjatë kur ndërroi tren në stacionin “Bank”. Në “Island Gardens” uli kokën për të parë duart e tij. I kishte mbajtur fort të mbledhura grusht që në “Shadwell”. Kohët e fundit ndihej sikur po lëkundej, po përmbysej, po mbytej. Pa ndjesinë e kohës, jeta e tij endacake ishte mbushur vetëm me përshtypje të zbehta, ditët e tij nuk kishin arkitekturë; ishin pa njëfarë baze ose përmbajtjeje; një lëmsh, një çmenduri, një ëndërr.

Por jo më. Tani ai kishte një qëllim. Ishte një qëllim i çmendur, por hej, ishte mirënjohës që të paktën po i ofrohej diçka në vend të asgjësë.

Në Greenwich, në peizazhin e sheshtë të parkut nën Observatorin Mbretëror duken vijat zigzage të shtigjeve që i kishin quajtur

Shtigjet e të Dashuruarve. Thellë në park, në majë të një kodre të rrëpirët me një kopsht të egër, astronomët britanikë kanë studiuar qiejt. Sot, në një ditë të stuhishme marsi, në kopsht nuk dukej asgjë përtej degëve të zhveshura që tundeshin nga era dhe bllokoni pamjen e asaj që po kërkonte Xhuliani teksa ngjitej drejt majës së malit.

Ndihej si idiot. Kishte blerë biletë? Ishte hallavitur deri në orën e paracaktuar? Kuzhinieri i kishte thënë të gjente një teleskop të quajtur Rrethi i Transitit, por Observatori kishte kaq shumë teleskopë. Ku ishte kjo pika e magjepsur ku gjërat e pamundura bëheshin të mundura? Xhuliani e ndjeu që po përqueshte veten duke shfryrë nga hundët dhe i erdhi turp. Nëna e tij nuk e kishte mësuar kështu; i kishte mësuar të mos të përqueshte kurrë diçka para së cilës je gati për t'u gjunjëzuar.

- Si shkohet te Rrethi i Transitit? - pyeti Xhuliani sportelistin pas banakut.

Vajza bukuroshe rregulloi flokët.

- Rrethi i Transitit i George Airy-t? Andej. Të përcjell unë nëse do. Vetëm një biletë për vete? - buzëqeshi ajo.

- Po, - tha ai. - Dhe jo, nuk është nevoja, e gjej vetë. Mos ndoshta shisni ora xhepi?

- Po, në dyqanin e dhuratave. Keni nevojë dhe për një busull? Ndoshta një guidë turistike? - tha ajo dhe anoi kokën.

- Jo, faleminderit. - Ai nuk e ngriti kokën, nuk e kapi vështrimin e saj.

Me vajzën nga pas, Xhuliani bleu një orë në kuti të pahapur. Ajo donte të sigurohej që punonte, po ai tha jo. Ai nuk donte që ajo ta prekte, të linte mbi kohëmatësin e tij të ri shenjat e vetë shpirtit të saj.

- Nuk do të mundesh ta kthesh nëse ka ndonjë problem më vonë, - tha ajo.

- S'ka gjë, - tha ai. - Nuk më bie më rruga këtej.

Çfarëdo që të ndodhte, ai s'kishte për t'u kthyer.

- Sa keq! - Ajo buzëqeshi. - Ku po shkon? - Kur ai nuk u përgjigj, ajo ngriti supet; thjesht një vajzë miqësore që po kalonte kohën. - Hidh një sy rreth e rrotull, - tha ajo. - Me nge.

Xulianit nuk i kishin ngelur shumë para nga pesëdhjetëshja. I fshehu monedhat njëpaundëshe të kusurit në një vazo suvenir së bashku me kartën *Oyster*. A ishte gabim ky, të dyshonte në bastin që po vinte? Jo, vendosi ai. Edhe njerëzve që kërkonin mrekulli u lejohej të tregoheshin të kujdesshëm. Ashtu ishte dhe ai: një njeri i kujdesshëm që po kërkonte një mrekulli. Kishte pak kohë tepër kështu që filloi të ecte për të shtyrë kohën. Ora ishte akoma njëmbëdhjetë. U përpoq të kujtonte të gjitha gjërat që i kishte thënë kuzhinieri, por ishin shumë.

- Në mesditë, dielli do të kalojë nga një vrimëz fiks në mes të xhamit sipër teje, - kishte thënë kuzhinieri. - Një rreze dielli do të bjerë mbi kuarcin në dorën tënde. Do të hapet një hendek blu. Duhet të nxitosh. Pjesa tjetër e jetës sate po të pret.

- Duket e vështirë dhe e komplikuar, - tha Xhuliani. Kuzhinieri bëri një hap pas nga skara dhe e pa poshtë e lart, me një hanxhar në dorë.

- Mendon se *kjo* pjesë është e komplikuar? A e ke idenë se çfarë po përgatitesh të bësh?

Jo. Xhuliani nuk e kishte idenë. Ai e dinte çfarë kishte qenë duke bërë. Kohët e fundit, asgjë. Por më përpara, në të kaluarën, ai bënte gjëra, si për shembull, kalonte kohë me beben e tij, pak para ëndrrave të tij për në Hollywood. Dielli që ndriçonte mbi palmat dhe mbi të dashëruarit, *Volvo*-t e parkuara në cepa të veçuar. Dritare të hapura. Lumturia që futej brenda, si era. Xhuliani nuk ishte skeptik atëherë. E po, si thoshte ai vetë, gjithçka kishte kohën e vet.

- Ku është Meridiani Zero? - pyeti Xhuliani një rojë të vjetër me pamje të ashpër, brenda njërës prej dhomave në pavijon.

- Po qëndron mbi të, shoku, - u përgjigj roja. Kartela me emrin e tij thoshte Suini. Ai tregoi me gisht një teleskop të zi gjigant. - Je në Dhomën e Transitit. Dhe ai aty është Rrethi i Transitit, pikërisht mbi vijën e meridianit.

Mbi nëntë këmbë i gjatë, teleskopi i Airy-t dukej si top luftime që e kishin drejtuar për tek yjet. Nga të dyja anët kishte shkallë të zeza me shkëlqim, të cilat përfundonin në një katror të zhytur pak më ulët se kati kryesor.

Nga dera e hapur vinte drita e zbehtë e diellit. Vija prej tunxhi që shënonte pikën 0.0 ishte fiksuar mbi kalldrëmin e kopshtit. Xhuliani po shikonte turistët që qëndronin mbi vijë, me një rën këmbë në lindje dhe tjetrën në perëndim, mbi supet e njëri-tjetrit, duke nxjerrë fotografi, duke pozuar, duke qeshur. Kontrollloi orën e tij të re.

11:45.

Duart e tij po dridheshin. Për t'i qetësuar, ai kapi gardhin e ulët prej hekuri që qëndronte midis tij dhe teleskopit, me çatinë e palosshme hapur sipër tij dhe qielli i vrenjtur.

Ndihej krejtësisht vetëm.

Një qytet me shi, i huaj, i çuditshëm, i pafund. Londra ishte si një shtet komplet tjetër më vete. Xhuliani hodhi vështrimin drejt rojës. Ky burrë i mbushur ishte ulur mbi një stol, me njërin bërryl mbi tavolinën e drunjtë, indiferent ndaj Xhulianit, si dhe ndaj gjithë universit. Prapa Suinit kishte një dritare nga ku dukeshin pemët e përhimëta pa gjethe tek tundeshin nga era e mprehtë. Frynte shumë erë në Londër ditët e fundit, si një uragan kalimtar.

11:56.

Xhuliani futi dorën brenda jakës së këmishës dhe nxori gurin që varej nga një varëse prej lëkure rreth qafës së tij. Pa e hequr nga kafazi prej argjendi, e shtriu mbi pëllëmbën e tij. Nën dritën ngjyrë gri, kristali nuk xixëlloi, as shkëlqeu. I heshtur dhe i ftohtë, thjesht qëndronte shtrirë mbi pëllëmbën e tij të hapur. Dikur, guri kishte qenë në duart e saj. Atëherë kishte pasur diell, një mjegull xixëlluese prej lumturie si ëndërr. Fillimi, jo fundi; ose të paktën kështu kishte menduar.

A ishte fundi ky?

Apo ishte fillimi?

- Kristali lëkundet një milion herë në sekondë, - i kishte thënë kuzhinieri; një kuzhinier, një magjistar. - Dhe ti lëkundesh bashkë me të. *Ti* je oshilatori. *Ti* je reaksioni zinxhir, katalizatori kimik, voltazhi që përshpejton përmes vetë jetës sate. Shko, Xhulian. Ka ardhur koha të veprësh.

Nuk ka kohë tjetër.

Deri në fund të kohës.

Koha po mbaron.

11:59.

Xhuliani shtrëngoi kristalin. Shikimi iu mjegullua. Kujtimi i dhimbjes është ajo që shkakton frikën ndaj vdekjes. Zemra mpihet. Një ndjesi si marrje fryme. Kur mushkëritë paralizohen, zemra nuk mund të marrë frymë.

Kështu është me kujtimin e dashurisë.

O, shpirti im dhe gjithçka brenda meje, thirri lypësi duke ngritur pëllëmbën e hapur drejt qiellit.

Zonja dhe zotërinj, erdhi momenti i shfaqjes!

Në pikosekondën para se sahati të shënonte mesditë, në hapjembylljen e syve midis të shkuarës dhe të ardhmes, Xhuliani pyeti veten nga se kishte frikë më shumë.

Se gjëja e pashpjegueshme, e cila po i ofrohej ishte e mundshme?

Apo se nuk ishte?

Do të vijë koha përsëri për ty dhe mua.

Nuk do të ketë asnjëherë më kohë për ty dhe mua.

Kur dielli kaloi në mes të xhamit në mesditë, ai e dinte. Ishte i gatshëm të bënte çdo gjë, të sakrifikonte gjithçka që ta shihte atë sërish.

Më ndihmo.

Të lutem.

Duhej të të kisha puthur.

PJESA E PARË

FANTAZMA E ZOTIT DHE E ËNDRRAVE

*Si fantazmë ajo ndriçon mbi mua.
Dhe e gjithë zemra jote hapet para meje.*

Alfred, Lord Tennyson

E adhuroj aktrimin. Është shumë më i vërtetë se jeta.

Oscar Wilde



Nga Redaksia e

Zotit Di Gjithçka

Vëllimi 11, Numër 250



Si të përgatitemi për fatkeqësinë?

Çdo ditë shtiremi.

Shtiremi në çdo gjë. Në miqësi, në moshë madhore, në dashuri.

Qëllimi është të shtiresh aq shpesh derisa t'ia marrësh dorën. Dhe të shpresosh se përfundimisht forma do të ndjekë funksionin.

Nuk mund të përgatitesh më shumë se ç'duhet. Mund të përgatitesh më pak. Ose të mos përgatitesh fare. Këto janë zgjedhjet e tua.

Pranoje, dhe bëj atë që mundesh.

Ndër gjërat që mund të bësh:

**Mbaj me vete një vegël shumëpërdorimshme që të është dhënë nga miku yt më i mirë.*

**Ruaj kokën. Nuk mund të bësh pa të, nuk mund të bësh mirë pa të.*

** Orët janë të padobishme, elektrikët e dorës nuk janë të tillë. Edhe uthulla gjithashtu.*

** Mëso të jetosh pa gjërat me të cilat je mësuar të jetosh, veçanërisht pa fasulet magjike. Për shembull: pa elektricitet, iphone, Klonopin. Pa ëndrrat e tua.*

**Po munde, ndahu prej tyre me një shaka: "Cili është ndryshimi mes Autoritetit Portual dhe një karavidheje të lezetshme? I pari është një stacion autobusi i lënë pas dore, tjetra është gjithnjë një karavidhe, por mjaft e shëndetshme..."*

** Kështu përgatitesh për fatkeqësinë.*

Citati

E urreja çdo minutë të përgatitjes, por thashë "mos u dorëzo. Vuaj tani dhe jetoje pjesën tjetër të jetës si kampion".

- Muhammad Ali

SHPIKJA E DASHURISË

- PRA, KAM VDEKUR. BUKUR. - KËTO ISHIN FJALËT E para që i tha ajo.

Xhuliani dhe Eshtoni morën avionin nga Los Anxhelosi për në Nju-Jork së bashku me të dashurat e tyre Gueni dhe Raili, për të parë përshtatjen teatrale të veprës së Tom Stoppard-it, *Shpikja e Dashurisë*, afër “Broadway”-t. Drama - me Nicole Kidman në rolin kryesor, - rreth jetës dhe vdekjes së poetit britanik A. E. Housman, fillimisht shkruar për burra, ishte riimagjinuar dhe riskenarizuar me të gjitha personazhet gra, përveç rolit të Moses Jackson-it *objekt dashurie* i Hausman-it, rol, që do të luhej nga një aktor i ri, i cili ishte “kërcënues si një fuçi baruti”, kishte shkruar *New York Times*-i.

Fillimisht, kur Gueni kishte hedhur idenë që të shkonin, Xhuliani kishte ngurruar. Dinte nja dy gjëra rreth *Shpikjes së Dashurisë*. Në masterin që s’e kishte përfunduar dhe që i kishte mbetur merak, përfshihej edhe vepra e Stoppard-it.

- Ti mendon se di nja dy gjëra rreth çdo gjëje, Xhuls, - tha Gueni. Ajo gjithmonë e merrte me vete në ngjarje kulturore. - Por, për këtë nuk di gjë. Më beso. Do të jetë fantastike.

- Gueni, nëse do të shkojmë deri në Nju-Jork, pse nuk shohim më mirë *La Traviata*-n në “Qendrën Linkoln”? - tha Xhuliani. Atij nuk i pëlqente edhe aq opera, por Placido Domingo luante rolin e Armandit. Kjo ia vlente për të udhëtuar në cepin tjetër të vendit.

- Nuk më dëgjove që thashë se Nicole Kidman është A. E. Housman-i? Dhe Kyra Sedgwick është ndihmësja e saj.

- Të dëgjova, të dëgjova, - tha Xhuliani. - A do të pranojë Eshtoni?

- Nëse pranon ti do të pranojë dhe ai. Mos mendon se Eshtoni do të pëlqente më shumë Placido-n? Sa për të qeshur. Duhet t'i zgjerojmë horizontin. Dhe me sa duket jo vetëm atij. Eja, Xhuls, mos i var turinjtë, do t'ia kalojmë bukur. Ta premtoj.

Guenit i vajti buza vesh më vesh, sikur t'i kishte premtimet të skalitura mbi dhëmbë.

E organizuan të gjithë fundjavën. Eshtoni vuri te dera e dyqanit tabelën e tij të preferuar: **KAM SHKUAR PËR PESHKIM** (megjithëse nuk peshkonte). Ata të katërt, si muskëtierët, udhëtonin shpesh bashkë, kalonin fundjavat në Cabo ose në Napa. Arritën në aeroportin “JFK” të premtën, shkuan për darkë te *La Bernardin*, ku Eshtoni njihte pronarin (sigurisht që e njihte) dhe hëngrën falas. Më pas u takuan me disa miq nga UCLA, shkuan në “Soho” për pije dhe në “Harlem” për të kërcyer.

Me dhimbje koke dhe hap të ngadalë, të shtunën pasdite shkuan te *MOMA*, duke kaluar para vitrinave të dyqaneve në “Bulevardin e Pestë”. Kur erdhi mbrëmja e së shtunës, Xhuliani ndihej tepër i lodhur për të dalë sërish. Kishte blerë një libërth të mahnitshëm në dyqanin e dhuratave te *MOMA*, *Libri i Orakullit: Përgjigje për Pyetjet e Jetës* dhe do të preferonte të porosiste ushqim në dhomë dhe ta shfletonte, duke kërkuar përgjigjet, siç këshillonte libri. E kishte hapur rastësisht te dy përgjigje provokative, për pyetje të cilat ai nuk po i bënte.

Një: Ke tërhequr shtatën kupë. Kjo është ajo që do vërtet?

Kujt i referohej fjala “ajo” në atë fjali?

Dy: Një eklips i diellit paralajmëron një fund të papritur.

Çfarë fundi po priste ai?

Të veshur bukur, si për mbrëmje - burrat me xhinse të errëta, këmisha pas trupit dhe xhaketa klasike; vajzat me flokë të stiluar dhe me tualet, me taka dhe dekolte - para se të shkonin në teatër shkuan për të ngrënë *sushi* te *Nobu* në “TriBeCa”. Të gjithë, përveç Railit, pasi ishte ditë B dhe Raili në ditët B nuk hante, morën taksì për te teatri “Cherry Lane” në Greenwich Village.

Dhe rastisi që Nicole Kidman-i të kishte dublante.

Në tabelë thuhej: “Sonte roli i A. E. Housman-it do të luhet nga dublantja e znjsh. Kidman, Jozefinë Kollins.

Një zhurmë pasthirrjesh të pakënaqura shpërtheu midis biletëmbajtësve. Ishte mbrëmje e së shtunës! Pse kjo mungesë e papritur e yllit të shfaqjes?

- Mos ka rënë gjë nga shkallët? Mos ka ndonjë sëmundje ngjitëse? - pyeti Gueni.

Asnjëri nuk e dinte. Sportelistja nuk thoshte gjë. Në media heshtje. Duke qenë se i vetmi emër në tabelën e teatrit sipër titullit të veprës ishte ai i Tom Stoppard-it, nuk bëhej fjalë për kthim parash.

Xhuliani pati përshtypjen se e dashura e tij do të shkrinte e tëra e do të rrëzohej në dysheme. Gueni e kishte inatin me gruan e gjorë te sporteli i biletave, sikur e kishte ajo fajin për mungesën e Nicole-s.

- Po pse nuk është këtu? - përsëriste Gueni. - A mund të më thoni pse?

Xhuliani u përpoq t’i përmirësonte gjërat. Duke vënë dorën mbi supin e Guenit në shenjë përzemërsie teksa po uleshin te vendet e tyre, ai tha:

- A nuk je dakord se Jozefinë Kollins është emër i mirë për një aktore?

Gueni i ktheu një vështrim të mprehtë.

- Asnjëherë nuk thua diçka që të më bësh të ndihem më mirë kur jam e mërzitur, - tha ajo. - Sikur nuk të intereson fare.

Xhuliani i hodhi sytë nga Eshtoni në të djathtën e tij. Shoku i tij po fliste me Railin, të dy duke qeshur me një shaka që vetëm ata e dinin, me kokat e tyre bionde të bashkuara.

Ai u përpoq përsëri. - Me të vërtetë që ke bërë një mrekulli, Guen. Këto vende janë të pabesueshme.

Dhe ishin vërtet. Rreshti i tretë, në mes.

- Ah po, janë të përkryera, - tha Gueni. - Ia vlejnjë për të parë dublantën.

Eshtoni ia futi me bërryl.

- Ta them vazhdimisht, Xhuls, në disa situata është më mirë ta qepësh. Kjo është një nga ato situata.

Xhuliani e nguli vështrimin para. Pas një minute të gjatë, perdja e kuqe u ngrit.

Zëvendësuesja qëndronte në mes të skenës, aty ku binin dritat e skenës.

- Pra, paskam vdekur. Bukur, - i tha ajo dhe rrotulloi trupin.

Xhuliani, që ishte gjysmë i shtrirë në ndenjese pasi po i mbylleshin sytë, drejtoi kurrizin.

Shfaqja mund të kishte qenë e bukur. Mund të kishte qenë zhgënjyese. Gueni gjatë gjithë duartrokitjeve dhe pushimit nuk reshtte së foluri keq për dublantën, kështu që Xhuliani e pati të vështirë të formulonte një opinion të mirëfilltë.

Megjithatë e kishte formuar një opinion për dublantën.

Kjo vajzë e rastësishme kishte qëndruar para Xhulianit për dy orë rresht.

Ishte e jashtëzakonshme. Edhe pse në moshë të re e në rolin e një burri të vjetër që rikujtonte jetën e tij, e cila i dukej e zbrazët, ajo sillte melankoli dhe elegancë në skenë, sillte zgjuarsin, dhimbje dhe forcë. I sillte të gjitha këto. Nuk linte asgjë prapa skenës. Gjithçka kishte brenda saj ishte aty para Xhulianit.

Ndoshta nuk ishte e gjatë sa Nicole Kidman-i, por ishte po aq muskuloze, me këmbë e krahë të gjatë, lëkurë të bardhë dhe tipare të çelëta. Ndryshe nga Nicole, ajo kishte sy ngjyrë kafe dhe i dëgjohej frymëmarrja kur fliste si me pëshpërimë. Mund të dëgjohej si zë adoleshenteje, por në fund të çdo fjalie e lëshonte frymëmarrjen si një e rritur. Shpalosja e feminitetit të saj, duke ecur poshtë e lart, duke luajtur një profesor të ashpër, kishte një efekt të fuqishëm mbi Xhulianin. Vargu energjik i Housman-it që vinte nga gryka e saj e ngjirur dhe që mezi dëgjohej, e joshi. Ijët e saj e joshën. *Dashuria është thjesht akull në duar fëmijësh*, pëshpëriti ajo me një theks të përkryer britanik, duke qëndruar mbi bregun e lumit Styx, me krahët e zgjatur drejt tij. Ai i rezistoi tundimit për t'u ngritur nga ndenjësja. "Sa të nesërme do të më japin perënditë?", pyeste vazhdimisht ajo. "Sa kohë më ka mbetur?", thërriste.

Dhe atëherë, duke kaluar nga Housman-i te Çehovi, ajo recitoi këtë pjesë nga *Tri Motrat*:

Ah, ku është, ku ka ikur, e kaluara ime, kur isha e re? Kur ëndërroja dhe mendoja me hir, kur e tashmja dhe e ardhmja ime ishin të ndriçuara me shpresë? Përse ndodh që sapo fillojmë të jetojmë, rritemi dhe bëhemi të mërzitshëm, jointeressantë, përtacë, mospërfillës, të padobishëm, fatkeqë. Të rriturit e rijetojnë monotoninë e ditëve të tyre me thashetheme dhe vodka. Ku janë artistët, dietetarët, shenjtorët, ku janë ata që janë ndryshe nga të tjerët, që frymëzojnë xhelozin, ose pasion? Çfarë do, Xhulian? ÇFARË KËRKON?

Ai mbeti me gojën hapur. Mos e kishte dëgjuar gabim? Libri i Orakullit po i fliste atij me zë të lartë. I hutuar, u përkul përpara. Eshtoni i ra me bërryl, që të rrinte drejt. Vajza e kishte thirrur në emër?



- Ishte e tmerrshme, apo jo? - tha Gueni kur mbaroi shfaqja.
- Sa hundëpërpjetë ishte, apo jo? I dukej vetja sikur kush ishte. Si dreqin e fitoi një rol kaq të ndërlikuar? Me siguri që shkon me producentin, si thua?

- Nga ta di unë? - tha Xhuliani. - Përse më pyet *mua*? Unë nuk e njoh fare.

Ishte, me të vërtetë, britanike? Është e pamundur ta imitojë njeri theksin aq mirë.

- Pse do të justifikohesh? - psherëtiu Gueni, duke e marrë prej dore. - Të kërkoj falje. Kishe të drejtë. Duhej të kishim shkuar të shihnim *La Traviata*-n. Por, po të pyes seriozisht, si t'u duk? E tmerrshme, apo jo?

Por, Xhuliani nuk kishte këtë përshtypje.

Gueni shkoi te dera e skenës për të marrë autografin e Kyra Sedgwick-ut.

- Që mos të na shkojë e gjithë mbrëmja kot. - Ata ishin ngjitur pas kordonit ndarës blu. - Pas kësaj, do të shkojmë drejt e tek

Art Bar, - tha Gueni. - Pijet e para i qeras unë. Do të pimë që të harrojmë.

- I gjithë alkooli në Nju-Jork nuk mjafton, - iu bashkua Raili.
- As mua nuk më pëlqeu ajo, Gueni. Nuk pata përshtypje të mirë, edhe pse nuk jam e sigurt pse.

- Si thua, Xhuls? - tha Eshtoni. - A mjafton i gjithë alkooli në Nju-Jork që ta harrosh?

- S'e besoj.

Eshtoni po e ngacmonte, por nuk po buzëqeshte. Xhuliani e ktheu shikimin nga tabela e posterave të ndriçuara në ngjyrë rozë, pranë derës së skenës.

- Më acaroi, - vazhdoi t'i thoshte Gueni Railit. - Jam dakord t'i japësh rolit diçka të re, por nuk mund ta ndryshosh të gjithin.

- Ishte një grua në rolin e një burri, sa më ndryshe mund të jetë?
- pyeti Xhuliani.

- Nuk ishte mjaft mashkullore. Ia dëgjove zërin?

- Ia dëgjova, - tha Xhuliani.

- Unë me zor e dëgjoja. Plus që nuk ishte mjaft e gjatë. Ishte aq shpërqendruese.

- U shpërqendrove nga gjatësia e saj, vëlla? - tha Eshtoni, duke i rënë me bërryl Xhulianit.

- Jo.

- E po, më fal që shpreha opinionin tim, - tha Gueni.

Xhuliani theksoi se po shprehte një mendim.

- Po, por *unë* po shpreh një argument intelektual ndaj mungesës së cilësisë, - tha Gueni. - *Ti*, si mendon?

Xhuliani nuk vazhdoi më. Ai nuk e dinte si të mendonte.

Ishte një natë verore qershorit në Nju-Jork, e ngrohtë, me erë, një çercëritje në ajër e tre milionë njerëzve në rrugë. Njerëzit shtyheshin, ashtu si ndodhte në Nju-Jork kur njerëzit shpenzonin para për biletat dhe mendonin se kjo u jepte të drejtën e një autografi mbi programin e tyre të shfaqjes. Qëndronin aty, me duart e zgjatura, sikur po u bënë ata nder aktorëve dhe jo e kundërta.

Gueni vazhdonte me komentet zemërgushta ndaj dublantes dhe Xhuliani u acarua. Bëri mënjanë, duke lënë burra të tjerë, së bashku me të dashurat e tyre, të futeshin midis tij dhe të dashurës

së tij. Fjalët e vajzës vazhdonin të jehonin në veshët e tij dhe ta godisnin në kraharor. *Pra, kam vdekur, bukur; dashuri si akull në duar fëmijësh...*

Kyra Sedgwick doli në krah të Kevin Bacon-it, bashkëshortit të saj, aktorit thatanik e me pamje rinore. Dikush në turmë bëri shaka në lidhje me lojën e gjashtë niveleve të idesë së Kevin Bacon-it¹. Kevin Bacon-i buzëqeshi sikur donte ta godiste. Disa minuta më pas, i vetmi aktor mashkull - muskulozi si “fuçi baruti” në rolin e Moses Jackson-it - doli jashtë. Xhuliani nuk ia mbante mend emrin pasi nuk ishte i interesuar. Pak hapa pas z. Univers ishte dublantja. Xhulianit iu mblodh një lëmsh në grykë.

Barrikatat lëvizën nga forca e turmës; thërrisnin, Kyra, Kyra. Kevin, Kevin. Xhulianit i pëlqeu që Kevin Bacon-i nuk ishte fare në shfaqje, por gjithsesi po jepte autografe. Treguesi i famës së vërtetë, mendoi Xhuliani. Këto ishin gjëra superstari.

Edhe z. Universi firmosi disa programe. Dublantja e Xhulianit, jo. Ajo qëndronte anash si vajza e re e fundit e pashitur në një ankand shërbyesesh në Perëndimin e Vjetër. Asnjëri nuk e njohu pa parukën biondë dhe flokët e lagur të kapur topuz.

Filloi të binte shi i imët.

Duke zgjatur dorën me programin e shfaqjes, Xhuliani e tundi për t’i tërhequr vëmendjen. Si të sillesh si zotëri dhe jo si trap, kur tund diçka për të marrë autograf? Por kur ajo e pa, iu afrua me një buzëqeshje mirënjohjeje. Ai zgjati programin drejt saj me dorën që i dridhej paksa, duke vështruar kurorën e flokëve të saj të zinj e të lagur, ndërkohë që ajo firmosi me shkrim të madh, me zbukurime, thujtaje të palexueshëm emrin e saj, Jozefinë Kollins.

Para se Xhuliani të mund t’i thoshte sa mirë kishte luajtur, sa mahnitëse ishte, e thirrën nga larg dhe ajo iku. Kaq ishte.

¹ Six degrees of Kevin Bacon - është një lojë ku lojtarët duhet të zgjedhin një aktor, i cili ka luajtur në një film me Kevin Bacon-in e kështu me radhë. (Shën. i redaksisë).

Pasi kthimit në L. A. Xhuliani pothuajse e harroi.

Dyqani i Eshtonit kishte aq shumë punë sa kurrë më parë: tre nga vëllezërit e Xhulianit kishin ditëlindjen, po afrome *Dita e Babait*, kishin një pagëzim, nëna e tij po organizonte një festë me rastin e përfundimit të vitit shkollor dhe kishte nevojë që Xhuliani ta ndihmonte për të gjetur një luleshitës dhe një furnizues ushqimesh, dhe Gueni hidhte fjalë për pushime romantike në Meksikë me rastin e festës së 4 Korrikut, ndoshta duke shpresuar për një unazë fejese në Cabo.

Herë pas here, Xhulianit i kujtohej fjalia e parë e vajzës. Jo vetëm i kujtohej. E shihte në ëndërr.

Në vizione telesh të akullta, fytyra e saj e zbehtë shfaqej e ndriçuar para sfondit të errët dhe nga mesi i skenës në kraharorin e tij, dëgjohej zëri i saj që e pyeste se çfarë po priste, që i thoshte se shpirti nuk ka kufij.

2

BOOK SOUP

DISA JAVË MË PAS, XHULIANI E HASI TE LIBRARIA *Book Soup*,¹ në bulevardin “Sunset”. Ndoshta *e hasi* është fjala e gabuar. Ai ishte te raftet me poezi, duke shtyrë kohën derisa të takohej me Eshtonin, kur ajo u fut brenda sikur po kërcente vals.

I ngjiti shkallët me hap të shpejtë dhe shkoi drejt rafteve të zeza që ndodheshin pranë dritareve, te seksioni i filmit dhe teatrit. Nga pozicioni i tij i favorshëm, disi i fshehur, me kokën të kthyer nga ajo, Xhuliani e vështroi teksta skanoi me sy shpinat e librave. Me siguri që ishte e njëjta vajzë, apo jo? Çfarë rastësie që e po e shihte këtu.

Në Nju-Jork ajo kishte vënë parukë bionde, ndërsa tani kishte flokë ngjyrë kakao, të kapur në një topuz të çrregullt që gati po i binte. Kishte veshur xhinse të shkurtra, çizme të zeza tip ushtarake dhe një këmishë me kuadrate të hedhur sipër një kanotiereje të kuqe. Këmbët i kishte të holla, të gjata, të panxira nga dielli. Pa dyshim që ajo ishte.

Xhuliani zakonisht nuk u afrohej grave të panjohura në bibliotekë. Përveç kësaj, edhe po vonohej. I hodhi një sy orës, sikur po e mendonte seriozisht të shkonte t’i fliste, ose të gjente ndonjë arsye për të mos e bërë. Takimin me Eshtonin e kishte për tridhjetë minuta.

Shoku i tij i çmendur donte të shkonte për të eksploruar kanione në Utah! Si shok, Xhuliani e kishte për detyrë t’ia ndërronte

¹ Rrjet librarish në Kaliforni. (Shën. përkth.)

mendjen. Kështu që shkoi te *Book Soup* për të blerë autobiografinë e eksploratorit të pafat, që kishte shkuar edhe ai nëpër kanionet e Utah-ut. I shkreti kishte ngecur nën një popël për pesë ditë në kanionin *Blue John* dhe ishte detyruar të priste krahun e vet me një thikë të pamprehur xhepi për të mbijetuar.

Gjatë drekës pikante me tako me gaforre me zhguall të butë, koriandër dhe birra të ftohtë, Xhuliani kishte ndër mend t'i lexonte Eshtonit pasazhet e spikatura ku tregohet si të mbijetosh.

Por, para se të arrinte te pjesa për udhëtimet, Xhuliani u shpërqendrua nga poezitë për Los Anxhelosin të Leonard Cohen-it dhe më pas nga ritmi hipnotizues i refrenit të këngës së Cuco's "Drown" që po dëgjohej nga altoparlantët e vendosur në tavan.

Dhe ajo ishte aty, duke ecur me hap ritmik.

Ishte pothuajse mesditë. Xhuliani kishte kohën e duhur për t'u hedhur me nxitim deri në "Melrose", që të takohej me Eshtonin te *Gracias Madre*. Në drekë, rrugët e Hollivudit Perëndimor ishin të tejmbushura me shoferë të acaruar nga uria. Vajza nuk e vuri re. Nuk ishte nevoja të largohej me stil. Nuk kishte nevojë të bënte asgjë. Ktheje Leonard Cohen-in në raft, dil nga dera në anën perëndimore. Thjesht dil jashtë, hidh një dollar në kavanozin e Xhenit. Xheni ishte varfanjakja e verbër, që rrinte gjithmonë jashtë bibliotekës në kohën e drekës, pranë stendës së gazetave. Edhe të pastrehët kishin nevojë për ushqim. Futu në makinë dhe largohu.

Pa trafik, atij do t'i duheshin shtatë minuta. Xhuliani mburrej se ishte i përpiktë, me orën e tij *Tag Heuer* të programuar sipas orës atomike, ai nuk e duronte aspak vonesën legjendare e aktorëve të Hollivudit, që i dukej fyese.

Xhuliani nuk doli.

Por, bëri të kundërtën. Me një ecje të shkujdesur, përshkoi bibliotekën për nga skaji i ndriçuar nga dielli, pranë dritares, derisa iu afrua dhe qëndroi pas saj, duke mbajtur në dorë librin e këngëve të dashurisë për Los Anxhelosin të Leonard Cohen-it.

Mori frymë.

- Jozefinë?

Ai mendoi se nëse nuk ishte ajo, nuk do ta kthente kokën.

Ajo u kthye, edhe pse jo *menjëherë*. Pati një vonesë në atë lëvizje të sajën. Ishte pa tualet, me lëkurë të pastër, sy ngjyrëkafe dhe e sjellshme. Kishte një fytyrë me tipare të buta, të shëndetshme, të çiltra. Sytë larg njëri-tjetrit, të papenguar nga vijëzimi i vetullave apo rrudhave në kapakë, mollëza të gjera dhe buzë si trëndafil.

Fillimisht nuk reagoi. Pastaj puliti sytë dhe buzëqeshi me mirësjellje. Jo ndonjë ftesë për martesë, thjesht një pohim se po këqyrte një burrë, i cili nuk i dukej i neveritshëm dhe të cilit mund t'i kushtonte një minutë nga jeta e saj, Ke gjashtëdhjetë sekonda, kauboj, thoshte ajo buzëqeshje. Jepi.

Por Xhuliani nuk mundej. I kishte humbur fjalët. *Ishin ngjitur lart*, këtë shprehje përdornin në teatër, kur të gjitha ato që doje të thoshe thjesht zhdukeshin.

Ajo foli e para.

- Nga të njoh? - pyeti ajo, duke picërruar sytë. Nuk kishte asnjë gjurmë theksi britanik në zërin e saj. - Më dukesh i njohur. Prit pak. Sikur erdhe te shfaqja ime në Nju-Jork? Te *Shpikja e Dashurisë*?

- Po, - ia bëri ai duke pastruar fytyrën. - E mbake mend?

Ajo ngriti supet.

- Programi yt ishte i vetmi që firmosa.

Zëri i saj - jo vetëm zëri i skenës, por edhe zëri i saj normal e tingëllues - ishte i ëmbël, zëri i një vajze, por me tonin e një zëri të pastër gruaje. Jo dhe aq e lehtë për t'u arrirë. Mahnitëse.

- Çfarë bën në L. A.?

- Jetoj këtu afër, - tha ai, gati për t'i thënë rrugën dhe numrin.
- Ti?

- Thjesht vizitore. Për audicione.

- Nga Londra?

Ajo qeshi.

- Jo, theksi ishte i rremë. Kam lindur dhe jam rritur në "Brooklyn" si Neil Diamond.

- Nuk ke shfaqje?

Ajo tundi kokën në shenjë mohimi. - Nicole u kthye.

- Pse mungonte atë natë? - Gueni *ende* e përmendte.

- Edhe ti u mërzyte që nuk ishte? Në teatër pati shumë ankesa.

Xhulianit po i merrej goja.

- Jo, unë jo.

- S'ke për ta besuar, por shoferi u fut në rrugën e gabuar dhe përfundoi te tuneli "Lincoln". - Jozefina qeshi. - Sikur i ngeci truri. E çoi makinën në Jersey! Dua të them, Jersey është gjithmonë në rrugën e gabuar, por pastaj në kthim ngecën pas një aksidenti që kishte ndodhur dhe pastaj të tjerat i di vetë.

- Uhhh!

- Eh, ç'të bësh. Kontrata më mbaroi disa ditë më vonë, - tha ajo.

- Nuk ma ripërtërinë.

- Nuk habitem, - tha Xhuliani. - Nicole duhet të ketë pasur frikë mos humbiste punën. Ti ishe fantastike.

- Vërtet? - tha ajo dhe i ndriçoi fytyra.

- Oh, po, - tha ai. - I rrëmbeve shfaqjen. Nuk ta falin këtë në teatër.

Vajza u shkri nga kënaqësia. Ajo tha disa gjëra, një faleminderit dhe e pyeti nëse vërtet mendonte kështu? Xhuliani thujse nuk e dëgjoi, thujse iu zbeh shikimi.

Ajo natë ishte nata e vetme që ajo ishte ngjitur në skenë.

Dhe ai kishte qenë aty.

Duke picërruar sytë, ai u përpoq ta përqendronte vëmendjen tek ajo.

- Gjithashtu, - tha, - nuk mund të gjeje një emër më të mirë arti se Jozefina Kollins.

- Nga e di ti që e kam shpikur? - Sytë e saj xixëllonin. - Po ty si të quajnë?

- Xhulian.

Ajo vuri dorën sipër syve sikur po mbrohej nga dielli edhe pse gjendeshin brenda, dhe e mati me sy nga koka te këmbët.

- Hmm. Ti nuk ngjan si Xhulian.

- Ashtu? E si ngjan një Xhulian? - Ai i rezistoi tundimit për të kontrolluar rrobat e tij, sikur harroi çfarë kishte veshur atë mëngjes.

- Nuk jam Ralph Dibny, - mërmëriti ai, pa dashur ta thoshte me zë, por i shpëtoi. Në botën e librave vizatimorë, Ralph Dibny ishte një burrë i zakonshëm me rroba të zakonshme, i cili pasi pinte një super-ilaç shndërrohej në një burrë që mund të përdridhte trupin në mënyrë të jashtëzakonshme.

Jozefina pohoi me kokë.

- Jam dakord, nuk je Dibny, vetëm nëse je prej gome. Xhulian, po mbiemrin si e ke?

- Xhulian Kruz. Mos the gjë *prej gome*? E di kush është Ralph Dibny?

- Njeriu i Zgjatur? A nuk e njohin të gjithë? - u përgjigj ajo me atë zërin e saj të ëmbël prej sopranoje.

Xhuliani nuk dinte ç'të thoshte.

- Je i sigurt që nuk e ke mbiemrin Dibny? - Jozefina qëndronte me një libër para gjoksit sikur ishin në gjimnaz. - Po përse ngjan si mësues i shkollës së mesme?

- Nuk ngjaj si mësues, - tha Xhuliani, dhe vajza qeshi me përgjigjen e tij të shpejtë, siç kishte shpresuar dhe ai.

- Ashtu? - tha ajo, duke e studiuar me vëmendje.

Përse u ndje papritur kaq i vetëdijshëm Xhuliani? Ajo shqyrtoi fytyrën e tij të mirëtrajtuar, me nofullën katrore, flokët e prerë shkurt, pantallonat ngjyrë kaki të hekurosura, këpucët e rehatshme, këmishën me kuadrate ngjyrë blu, xhaketen pas trupit, thonjtë e pastër që i kishte ngulur mbi kopertinën e librit të Leonard Cohen-it. Ai shpresoi se ajo nuk ia kishte vënë re duart e tij të mëdha e nervoze me noçkat me gunga apo hundën e tij të thyer, apo sytë e tij ngjyrë lajthie që i kishte picërruar për të fshehur interesimin e tij për të.

- Në rregull, në rregull, - tha vajza, dhe fytyra iu ndriçua me një buzëqeshje. - Thjesht doja të thosha që, ashtu si Dibny, mund të kesh edhe ti disa talente të fshehura, - duke e ngacmuar, dhe duke e ftuar edhe atë ta ngacmonte.

Nuk ndodhi asgjë tjetër pas kësaj. Veçse qiejt u hapën dhe yjet filluan të binin si shi.

- Nuk ke pse të jesh Dibny, - shtoi Jozefina. - Thjesht mund të jetosh sipas emrit tënd prej rokstari, Xhulian Kruz.

Xhulian Kruzi, rokstari, kishte harruar si të fliste me një vajzë. Qëndronte aty çuditshëm, pa folur. Pse e bezdiste kaq shumë sot kujdesi që tregonte për veshjen e tij në ngjyrat e tokës? Normalisht ishte krenar për këtë. E fshehu fytyrën e tij prej saj në një joshje yjesh në rënie.

- Dëgjo, - tha Jozefina, - do të më pëlqente shumë të rrija këtu gjithë ditën dhe të flisja me ty për superheronjtë tanë të preferuar, por kam një audicion në orën një.

- Prandaj e mban këtë libër? - ai tregoi me gisht duart e saj. *Monologë për Aktorë nga Komedia Hyjnore.*

- Jo, librin e kam për audicionin e orës 4:30.

Ajo ia nguli sytë, duke u menduar. Pa ditur ç'të thoshte, Xhuliani bëri një hap pas dhe ngriti librin e Leonard Cohen-it sikur donte t'i thoshte *mirupafshim*, Jozefina.

- Shiko si është puna, - tha ajo, duke bërë një hap drejt tij, - kisha ndër mend të merrja taksì, por është kaq e vështirë të gjesh një në këtë orë të drekës, sa po mendoja... a do të kishe mundësi të ndihmoje këtë vajzë dhe ta çoje deri aty ku zhvillohet audicioni? Është në *Paramount*, jo shumë larg.

Në radio, *Big Star*-ët kishin rënë në dashuri me një vajzë, më e bukura nga të gjitha vajzat në botë.

- Pa problem, - tha Xhuliani, duke e hedhur tutje librin e Leonard Cohen-it.

- Nuk dua të të detyroj, - tha ajo. - Në Nju-Jork është shumë më e lehtë, thjesht futem në metro, po këtu pa makinë...

- Nuk e kam problem. - E kush ishte Eshtoni? Prej sa kohësh ishin shokë? - Pra, jeton në Nju-Jork? - e pyeti ai, kur ishin tek arka e po prisnin për të paguar.

- Po. Gjë e mirë apo e keqe?

Ajo picërroi sytë e saj të errët e lozonjarë. Kishte një fytyrë të freskët, që tregonte padurim, dhe sinqeritet, me disa quka dhe me një gropëz në mjekrën e saj të vogël. Kishte diçka mrekullisht të gjallë dhe ftuese fytyra e saj e padjallëzuar, goja e saj ngjyrë rozë.

Makinën e kishte parkuar pranë Dhomës së Nepërkës, një bllok më larg, në bulevardin "Sunset".

- Audicioni është për pijen *Mountain Dew*¹, - tha Jozefina siç po ecnin me nxitim pas Xhenit të verbër, e cila buzëqeshi sikur t'i shihte. - Por audicioni në 4:30 është për diçka që quhet *Parajsa në*

¹ Pije amerikane e llojit kokakola.

Park te teatri “Grek”. E ke dëgjuar? Me sa duket, kanë nevojë për një tregimtar për Danten si edhe për një Beatrice.

- Çfarë të kem dëgjuar? Për *Mountain Dew*? Për Beatricen? Apo për teatrin “Grek”? - Xhuliani i hapi derën e makinës. Ai kishte një makinë tip *Volvo*, të marrë me qira dy vitet e fundit. Nga brenda ishte shumë e pastër.

U duk sikur ajo nuk e vuri re makinën apo sa e pastër ishte, ose e vuri re dhe nuk tha gjë. Tha se po vdiste nga uria, nuk kishte ngrënë gjë që natën e kaluar. Ai i ofroi një mini *Milky Way*, që e kishte në kroskot, pas prerëses së rripit të sigurisë, elektrikut të dorës dhe shumëvegëlshut - sende, të cilat ajo i mënjanoi për të arritur te çokollata.

- Duhet të filloj të nxjerr para, - tha ajo duke kafshuar karamelen e fortë në mënyrë teatrale. - Kjo *Milky Way* duket sikur ka aty që nga Krishtlindjet. Nuk po ankohe, ta dish. Nuk jam nga ato që kam pretendime. - Uli pasqyrën sipër sediljes së pasagjerit, nxori nga çanta prej endacaku një qese të vogël dhe filloi të bënte grimin. - Nuk e dija që Ralph Dibny ngiste një *Volvo*. - Domethënë e kishte vënë re. Ajo bëri ca hije blu mbi sytë e saj dhe disa hije të tjera mbi të. - Sa vjeç je, pesëdhjetë?

- Çfarë? Jo...

- Vetëm burra pesëdhjetëvjeçarë, të martuar dhe me fëmijë ngasin *Volvo*.

- Nuk është e vërtetë, - tha Xhuliani, - pasi nuk jam asnjë nga këta dhe prapë e ngas.

- Hmm, - tha ajo duke i hedhur një vështrim me bisht të syrit. - Nuk je *burrë*?

Xhuliani fiku telefonin. Gjëja e fundit që donte të dëgjonte ishte zëri i ashpër i Eshtonit nga altoparlantët e makinës për të ndërprerë ëndrrën e tij Teknikolor. Thjesht shpresonte që Eshtoni të mos mendonte se ishte përfshirë në ndonjë aksident. Ai nuk do ta priste mirë faktin që nuk shkoi për drekë, por doli shëtitje jashtë studiove të *Warner-it*

E, po, a nuk ishte përfshirë Xhuliani në një lloj aksidenti? Një ditë si gjithë të tjerat, një të martë si të tjerat, ai po bënte gjëra të jashtëzakonshme, jashtë karakterit të tij. E la shokun e tij të priste.

Iu afrua një gruaje të panjohur. I ofroi një shëtitje. Fakti që jeta ishte e hapur drejt të ardhmes e bënte të mundur që në çfarëdo ditë, në çfarëdo momenti, kjo të ishte e mundur. Por, thjesht ngaqë bota e të tjerëve ishte e hapur drejt këtyre mundësive, nuk ishte e thënë që të ishte e mundur për Xhulianin. Ai bënte jetën e tij të rehatshme pa impulse, pra, pa mrekulli. Dhe siç ia kujtonte edhe Eshtoni shpesh, ai as që nuk besonte fort në mrekulli.

Kur, për shkak të trafikut në Santa Monica makina ngeci në vend, Jozefinën nuk e zinte vendi, Xhuliani filloi të lutej, “mos ndrysho, semafor i kuq, mos ndrysho, të lutem”.

- Atëherë, çfarë bën, udhëton vazhdimisht midis L. A-së dhe Nju-Jorkut? - e pyeti ai. - Pse nuk transferohesh këtu?

Si tingëlluan fjalët e tij? Ai shtrëngoi timonin.

- E provova, - tha Josephina. - Nuk e bëja dot. S'them që nuk gjeja dot punë. E kam fjalën që nuk mund të jetoj këtu. A mund të më paralajmërosh kur të hapet semafori dhe të nisesh? Se po vendos penel sysh.

Ajo i tha se i dukej gjithmonë sikur L. A-ja kishte një element ogurzi. Fillimisht Xhuliani mendoi se po bënte shaka. L. A-ja ogurzi? Ndoshta disa lagje. Lagje në të cilat ai nuk shkelte.

- Nuk ndihem e vërtetë kur jam këtu, - tha ajo. - Ndihem sikur jam në një ëndërr që po mbaron. Hej, Xhulian, mban mend që duhet të më paralajmëroje? Mund të kisha nxjerrë syrin.

- Më fal. Ai e uli shpejtësinë, por *tani* nuk ia vlente. - Në ëndërr si një ëndërr që bëhet realitet? - Bravo Xhulian. Bravo.

- Jo, - tha ajo. - Si një rol i vogël në imagjinatën e dikujt tjetër kur ka marrë LSD.

Ai donte të bënte një shaka, por ishte shumë i zënë me lutjet e tij.

Disa minuta para orës një, ai ndaloi para hyrjes së *Paramount*-it në rrugën “Gower”. Roja e njihte.

- Përshëndetje, C. J., - i tha rojës, që i buzëqeshi.

Jozefinës i bëri përshtypje.

- E njeh me emër rojën?

- Përshëndetje, Xhul, - tha C. J., duke hedhur një shikim brenda *Volvos*. - Ku e paskemi Eshtonin sot?

- Kush është Eshtoni? - tha Xhuliani duke shkelur syrin.

Me një buzëqeshje të vetëkënaqur C. J. u bë gati të hapte portën me kangjella, por Jozefina u përkul mbi Xhulianin për të treguar fletëkalimin e audicionit nga dritarja e hapur. Ky i fundit nuhati parfumin me aromë myshku livadhesh, sapunin me mente verbena dhe çokollatën *Milky Way* në frymën e saj. I mbështetur në sediljen e shoferit, ai u gëlltit dhe u mundua të mos trulloset - ose më keq akoma.

- Je në rregull, zonjushë, - tha roja, duke i bërë me dorë të kalonte. - Je bashkë me këtë, vazhdo futu. E di se ku po shkon?

- Me të vërtetë, a e di njeri se ku po shkojmë, C. J.? - tha Josephina me gëzim.

Ata u futën me makinë.

- Kush është Eshtoni?

- Lejekalimi im për në *Paramount*, - iu përgjigj Xhuliani, duke kërkuar studion. - Edhe për në *Warner, ABC, CBS, Universal, Fox*. Në fakt është lejekalimi im për jetën. Vrapo, aty është. Mos vonohesh.

Te dera gri e Studios 8 shkruhej “Audicione”. Kur arriti aty Jozefina tha me ndrojtje:

- Hmm, mendon se mund të më presësh? Nuk vonohem as një minutë. E zëmë pesë. Do të të qeras me një drekë. Për të të falënderuar.

- Nuk ke pse e bën, - tha ai.

- Dua ta bëj. Por, gjithashtu, - ajo u kollit dhe buzëqeshi, - ndoshta pasi të të qeras me një drekë mund të më çosh deri te parku “Griffith”? Ai teatri “Grek” është shumë larg. Dhe pastaj nuk do të të kërkoj më asgjë, ta premtoj.

Pasi ajo u zhduk në studio, Xhuliani i dërgoi një mesazh të shpejtë Eshtonit për t’i kërkuar falje dhe e fiku prapë telefonin para se të merrte një përgjigje të zemëruar.

3

ZEMRA TË VETMUARA

JOZEFINA DOLI PAS NJË ORE E CA, U FUT NË MAKINË dhe i tha:

- O Zot, s'po mbaronte.

- E fitove rolin?

- Kushedi? Ajo nuk ishte entuziaste. - Njëra nga vajzat tha se njihte Matthew McConaughey-in, vetë z. Mountain Dew. E urrej. - I tha pa të keq këto fjalë. - Ajo ka të njohur. Sa ka vajtur ora? Po vdes për të ngrënë, por teatri "Grek" është në anën tjetër të qytetit. Ku mund të hamë diçka shpejt e shpejt?

Ai e çoi përtej "Melrose"-s, te një vend që quhej *Coffee Plus Food*. Po afronte ora që ta mbyllnin, kështu që po u mbaronte kafja dhe ushqimi. Lokali fatmirësisht s'kishte fare njerëz. Ishin vetëm ata të dy dhe arkëtarja, një vajzë australiane që nuk buzëqeshte dhe dukej që ishte e mërzhitur. U ulën te një nga tavolinat rrethore prej hekuri pranë dritareve të larta. Jozefina u bë gati të paguante, por Xhuliani nuk e la. Ajo porositi tre byrekë me salsiçe ("Ta thashë që po vdes për bukë"), një sallatë me avokado, një kafe, dhe kulaçin e fundit që kishte mbetur nga menuja e mëngjesit, pasi ai i tha se s'duhej ta humbiste rastin për të provuar kuleçtë e mëngjesit, sikur të ishin një pjesë e veçantë e Disneyland-it.

- Do të doja të shkoja në Disneyland ndonjë ditë, - tha ajo, duke e kollofitur kulaçin.

Edhe e dashura e Eshtonit, Raili, që hante kryesisht pazi, ia lejonte vetes një kulaç mëngjesi. Ishte krokant dhe i karamelizuar, një kroasant me kanellë dhe sheqer përsipër.

- Është si dashuri në formë kulaçi, - tha Jozefina, e lumturuar, me gojën që i ngjiste nga sheqeri. Ajo tha se duhet të vinte edhe

një herë këtu për të ngrënë një kulaç, para fluturimit të kthimit, dhe Xhuliani u përmbajt dhe nuk e pyeti se kur e kishte planifikuar këtë fluturimin e tmerrshëm.

- Ti çfarë bën, Xhulian? - e pyeti ajo, duke filluar të hante byreqet me salsaçe. - Ku jep mësim?

- Asgjëkund. Pse vazhdon të më pyesësh për këtë?

Ajo puliti sytë.

- Dole në mëngjes nga shtëpia i veshur për të shkuar në shkollë.

Xhuliani donte t'i thoshte se në fakt jepte mësim mbi shkrimin e tregimeve në kursin e natës të kolegjit komunitar, por nuk do t'ia jepte tani këtë kënaqësi. Kursi nuk zhvillohej gjatë verës gjithsesi, kështu që teknikisht nuk ishte mësues.

- Mësuesia është një profesion fisnik, - vazhdoi ajo, me një buzëqeshje lozonjare.

- E di, - tha ai. - Vij nga një familje mësuesish. Thjesht unë nuk jam njëri prej tyre.

- Atëherë, çfarë bën?

- Gjëra të ndryshme. Kam një blog, shkruaj në një buletin të përditshëm...

- Ashtu? Po blogu ç'temë trajton? - tha ajo. - Mësimdhënien?

Tani Xhuliani vërtet që nuk donte t'ia thoshte.

- Më thuaj pra, si quhet blogu? Me gishtat përlyer me gjalpë ajo nxori celularin e saj. - Do ta kërkoj.

Ai donte ta kishte quajtur blogun "Mendime të Thella nga një Lord Viking." Por në fakt e vërteta ishte se quhej "Nga Redaksia e Zotit Di Gjithçka."

- Sikur ta dija! I thua njerëzve si të jetojnë! - Ajo qeshi. - Atë pamje ke.

- Çfarë pamje?

- Atë pamje që thotë "dukem i heshtur, por në fakt di gjithçka". - Ajo ishte e kënaqur. - A mos është si rubrikë *këshillash*? - tha duke buzëqeshur dhe u përkul përpara. - Të mbysin njerëzit duke të folur për vuajtjet e tyre?

Ndonjëherë, po.

- Shumë prej tyre më shkruajnë për të pyetur si të heqin qafe zogjtë që u futen në shtëpi.

- Je i sigurt që nuk të kërkojnë këshilla për dashurinë?

Ai u përpoq të mbante një shprehje fytyre të padepërtueshme.

- Nuk është blog i tillë. Nuk jam zoti Zemrat e Vetmuara.

- Nuk je?

E si mund të *mbash* të pandryshuar shprehjen e fytyrës përballë sulmeve të tilla? Para disa vitesh, ai kishte filluar ta shndërronte blogun e tij në një buletin ditor. Zgjidhte disa pyetje, që i përkisnin një tematike, dhe ofronte disa zgjidhje së bashku me disa shprehje të mjegullta. *Shpirti është një zog në shtëpinë tënde*, kishte shkruar Nathaniel West-i. *Më mirë një zog i gjallë në xhungël sesa dy zogj të balsamosur në një bibliotekë.*

Vajza duartrokiti.

- Mezi *pres* ta ruaj faqen tënde, të bëhem ndjekëse e blogut tënd, - tha ajo. Në zërin e saj edhe këto fjalë tingëllonin erotike. - Ke ndonjë këshillë për aktore të zemëruara?

Ai donte t'i bënte përshtypje me papërshtatshmërinë e tij duke i thënë të mos dilte pa sytjena nëse nuk ishte e domosdoshme për skenarin.

- Vishu para kamerës, - vetëm kaq i tha.

Duke ngritur jakën e këmishës së saj të tejdukshme, ajo kryqëzoi e çkryqëzoi këmbët e zhveshura.

- Në rregull. Më sill ca ëmbëlsira dhe një koktej *Fedora*. Ndonjë gjë tjetër?

Tha gjë ëmbëlsira? *Mon Dieu*.

- Njëherë, - tha Jozefina, - një regjisore më tha të mos përpiqesha aq shumë për të qenë dikush tjetër. Ji vetvetja, më tha, dhe unë thashë me vete, se jam si ti, idiote. Jam në audicion për rolin e Nabby Adams së Re te *John Adams*, e gjithë ideja është të jem dikush tjetër?

Xhuliani qeshi.

- Më japin shumë këshilla, - vazhdoi ajo, - sidomos *pasi* e kam humbur rolin. Mos u dëshpëro, Jozefina. Qetësohu, Jozefina. Bëj pak qejf! Liroi shpatullat! Dhe unë them, ku ishit ju para audicionit? Nëse këto gjëra do të mjaftonin, do të kisha fituar çmimin *Tony* tani.

- Sa kohë ke që e bën këtë?

- Sa vjeç jam? Ah, po - aq kohë kam. Më pëlqen më shumë skena sesa filmi, - deklaroi ajo, sikur të ishte medalje krenarie. - Është më e vërtetë. Dhe ajo që dua të bëj unë është të jetë sa më e vërtetë, sa më reale.

- Atëherë pse vjen në L. A.? - Jo se po ankohej Xhuliani. Por L. A.-ja është qytet përrallash.

- Pse? Për të njëjtën arsye që Bonnie dhe Clyde grabisnin banka. Ai qeshi.

- Sepse këtu janë paratë?

- Po! Nuk është tamam aktrimi që më pëlqen, por skena vetë. Më pëlqen reagimi i menjëhershëm. Më pëlqen kur qeshin. Më pëlqen kur qajnë. - Filloi të luante me një file floku. - Ty, të pëlqejnë veprat teatrale? - e pyeti duke pulitur qepallat. - Përveç *Shpikjes së Dashurisë*.

- Po, ajo është një nga të preferuarat e mia. Oscar Wilde është gjithashtu shumë i mirë. Kur isha në gjimnaz pata luajtur Ernestin.

- Unë kam luajtur Sesiljen dhe Guendolen! - tha Jozefina me entuziazëm, sikur ajo dhe Xhuliani t'i kishin luajtur rolet përballë njëri-tjetrit. Duke kapur duart e tij nga ana tjetër e tavolinës, ajo filloi t'i thoshte me një theks të përkryer britanik. - *Ernest, mund të mos martohemi kurrë dhe kam frikë se kjo do të ndodhë. Por, edhe pse mund të martohem me dikë tjetër dhe të martohem disa herë, asgjë nuk mund të ndryshojë përkushtimin tim të përjetshëm ndaj teje.*

Përmendja e emrit Guendolen e fshiu buzëqeshjen nga fytyra e Xhulianit. Duke lënë mënjanë magjepsjen, i tërhoqi duart me edukatë dhe i vendosi rreth filxhanit të kafesë.

Jozefina, e çuditur nga ky gjest, u kthye në karrige dhe u përqendrua përsëri.

- Më fal, ishe duke më thënë çfarë pune bën dhe të ndërpreva duke folur për veten. Sjellje tipike prej aktoreje, apo jo? Unë, unë, unë. The se ke një blog? Ngjan me një pasion, domethënë ka akoma më pak fitime se aktrimi. Dhe më beso, nuk ka asgjë më pak fitimprurëse sesa aktrimi.

- Mendova se aktorëve nuk u intereson paraja, thjesht u intereson të jenë të besueshëm.

Te teatri “Cherry Lane”, ajo e kishte bërë ta besonte këtë.

- Kjo ndodh në fillim, - tha ajo duke qeshur. - Por s’do të ishte keq të gjeja edhe ndonjë punë me pagesë të mirë.

- E po, blogjet kanë para, - tha Xhuliani. - Paguhem nga reklammat e *Google*-it, dhe dy herë në vit mbledh abonime. Kush do paguan një sasi të vogël dhe merr buletinim tim.

- Sa njerëz abonohen?

- Ndoshta rreth tridhjetë mijë. Dhe faqja ka dy milionë vizitorë. Kjo na ndihmon të rrisim çmimin e reklamave.

Ajo u bë më serioze.

- Dy milionë vizitorë? Qenkam në zanatin e gabuar. Dhe kush është *ne* në atë fjali? Ti dhe i famshmi Eshton?

- Po, Eshtoni i famshëm.

I cili në ato momente do të kishte lëshuar mandat kërkimi për Xhulianin.

- Ai është Zemra tjetër e Vetmuar?

Pse çdo fjalë që dilte nga goja e saj dukej sikur po luante me të? Luante në kuptimin që dukej sikur po e joshte, jo sikur po e trajtonte si lojë, edhe pse kjo e fundit ishte e mundur.

- Ai nuk mund të jetë Zemra tjetër e Vetmuar, - tha Xhuliani, - pasi as unë nuk jam. Por është e vërtetë që jemi partnerë në gjithçka. Eh, mjaft folëm për mua. - Nuk kishte burrë për së mbari që të fliste për veten e tij kur përballë kishte Helenën e Trojës. - *Ku* ke luajtur? Ndonjë gjë që mund ta shoh sonte?

- Vitin e kaluar realizova një reklamë kombëtare të *Colgate-s*. Mund të shohësh atë. - Ajo i tregoi dhëmbët. - Më njeh tani?

Dukej, me të vërtetë, sikur e njilte mirë. Duhet të bënte përpjekje të jashtëzakonshme të dukej i qetë. Ajo i tha se kishte luajtur edhe Marinë të *Testamenti i Marisë*.¹

- Nuk e pe? Për drejt, asnjëri nuk e pa. U pëlqeu kritikëve, madje u nominua dhe për një çmim *Tony*, por zgjati vetëm tri javë. Hajde e merre vesh, apo jo? Vetëm në “Broadway” mund të ndodhë që të kesh sukses të madh dhe dështim të tmerrshëm në të njëjtën

¹ Bëhet fjalë për romanin e shkurtër *The Testament of Mary* të shkrimtarit irlandez Colm Toibin (1955), që është vënë dhe në skenë. (Shën. i red.)

shfaqje, - tha ajo duke qeshur. - Që të shiste sa më shumë bileta për *Marinë*, producenti i tha regjisorit të filmonte një reklamë ku të tregonte audiencën duke qeshur e duke u argëtuar, dhe regjisor i tha “Ki kujdes, Harri, se mos çohet në këmbë audienca e vërtetë duke bërëtitur, pse drejtin po qeshnin ata të tjerët?” - Jozefina qeshi vetë, dhe u skuq në fytyrë.

Ajo fytyrë e skuqur dhe e shkujdesur po bëhej gjëja më e preferuar në botë për Xhulianin.

Kishin mbi një orë në lokal. Xhuliani i kishte duart akoma rreth filxhanit të kafesë së ftohtë. Papritur ajo u ngrit nga karrigia.

- Ua, e pabesueshme, po shkon ora katër! Si e gëlltit kohën kështu. Ikim, shpejt!

- Unë e gëlltis kohën?

Ai u ngrit me ngadalë.

Natyrisht që në rrugën “Gower” kishte shumë trafik dhe makinat kishin ngecur në vend.

- A mund të arrijmë?

- Jo, Jozefina, nuk arrijmë.

- Lëri këto tani, Zoti *Di Gjithçka*. Të thashë, e kam në orën 4:30.

- S’ka shanse. Jemi katër milje larg dhe trafiku është i rënduar.

- Z. Pesimist, - tha ajo, - si iu përgjigj Bette Davis producentit Johnny Carson kur ai e pyeti si shkohet në Hollivud?

- Iu përgjigj “Merr rrugën ‘Fountain’”, - tha Xhuliani.

- Shumë mirë! Domethënë i *di* disa gjëra. Ndiq këshillën e Bette-s, Xhulian. Shko nga rruga “Fountain”. - Ajo hapi librin që kishte blerë. - Shih çfarë bëre. Më mbajte me muhabet kaq shumë saqë harrova të përgatis monologun. Nuk di asnjë varg të Beatrices.

- Fillo me vargjet, *Në mes të kësaj, jetës sonë tokësore, u gjenda në një pyll të zymtë...*

- Si vazhdon?

- Kaq di unë, - tha Zoti *Di Gjithçka*.

- E çfarë të bëj unë me kaq?

- Ndoshta mund ta vazhdos jashtë skenari me ndonjë varg nga eksperiencia që ke në teatër?

- Nga Beatrica? Apo nga *Komedia Hyjnore*?

- E po mirë, bëj audicion për rolin e tregimtarit, - tha Xhuliani.

- Do të ishte një Dante i jashtëzakonshëm.

- Të lutem mos më shih mua, ngit makinën, - tha ajo. - Kjo karakatina që ke është makinë, apo karrocë me kuaj?

- *Volvo-t* janë makinat më të mira dhe të sigurta që qarkullojnë në rrugë, - tha Xhuliani, i ofenduar në emër të automjetit të tij, që tërhiqte mjaft komente keqdashëse.

- Jam shumë e lumtur që je i sigurt, - tha ajo. - A mund të jesh i sigurt dhe në të njëjtën kohë të shkelësh gazin?

- Semafori është i kuq.

- S'kam parë ndonjëherë kaq shumë semaforë të kuq, - tha Jozefina. - Më duket sikur po i kontrollon me mendje. Sikur *do* që të vonohem.

- Pse ta dua këtë? - Fytyra drejt. Zëri i qëndrueshëm.

- Atë po përpiqem të kuptoj, - tha dhe si me shaka, shtoi: - E di që nëse e fitoj këtë rol, do të më duhet të qëndroj në L. A. gjithë verën.

Karakatinës së Xhulianit i mbinë krahë dhe fluturoi drejt parkut "Griffith", duke parkuar pas shtatëmbëdhjetë minutash.

- Eshtoni ka të drejtë, ndodhin plot mrekulli, - tha ai. - S'e kam bërë ndonjëherë këtë rrugë në më pak se gjysmë ore.

- Ashtu, ë? - tha ajo. - Sa shpesh e bën këtë rrugë, Speedy Gonzales, duke çuar gra të panjohura te teatri "Grek"? Duke hapur derën ajo ia bëri me shenjë. - Eja brenda me mua. Më sjell fat.

Teatri ishte thuajse bosh, përveç gjashtë vetëve që ishin ulur në rreshtat e parë. I ndërtuar në shkëmbinjtë e maleve Santa Monica, amfiteatri i hapur ishte paksa turbullues me qetësinë drithëruese që kishte, ndenjëset e kuqe dhe eukaliptet me shkurre që e rrethonin.

Te porta anësore, një vajze me një regjistër në dorë po qëndronte në Pozicionin e Celularit - me kokën poshtë si kali që pi ujë në përrua... dhe po shkruante mesazhe. Jozefina i dha emrin e saj... dhe pastaj emrin e Xhulianit! Ai e tërhoqi nga mënga. Vajza nuk po e gjente emrin e tij në regjistër.

- Do të jetë bërë ndonjë gabim, - tha Jozefina. Ato filluan të diskutonin.

- Duket qartë që dikush ka bërë gabim, - tha Jozefina. - Shko më sill përgjegjës tënd urgjentisht.

Pas tridhjetë sekondash, ata po uleshin në vendet e tyre tek orkestra anësore, dhe ai kishte numrin e tij.

- Ky është një mësim që kam marrë nga jeta në teatër, Xhulian, - tha Jozefina. - Sot, po ta tregoj falas. Asnjëherë mos fol me zë të ulët për të marrë atë që kërkon. Gjithmonë bërtit me zë të lartë. Të lutem.

- Përse e bëre këtë? - pëshpëriti ai.

- Shhh. Ndryshe ajo nuk do të të linte të futeshe. E pe si mbahej nga fuqia e vocërr që ka. Do të aktrosh, apo jo?

- Sigurisht që jo.

Jozefina e pickoi lehtë në krah.

- The që kishe luajtur Ernestin në gjimnaz. Besoj se duhet të dish diçka nga Wilde përmendësh. Unë di.

- Unë, mos jam gjë ti?

- Ajo që je është numri 50. Ke dhjetë minuta. Të sugjeroj të fillosh të përgatitesh.

- Jozefina, nuk do të recitoj.

Ajo nuk po e dëgjonte më. Ata ishin ulur pranë e pranë, me krahët që preknin njëri-tjetrin, dhe këmbët e saj të zhveshura preknin pantallonat e tij ngjyrë kaki. Buzët e saj po lëviznin, ndërkohë që mendja e tij vazhdonte të ishte bosh. Vështronte skenën i stresuar. Ishte i stresuar për të, jo për vete. E dinte që pavarësisht shakave të saj ai nuk do të ngjitej në skenë, por donte që ajo ta fitonte rolin. Një burrë i madh, i djersitur, me flokë të shpupuritur, po recitonte kanton e parë të Dantes. Pas katër rreshtave ndaloi. Pas tij doli një grua e imët. Dy vajza binjake arritën të recitonin shtatë rreshta para se t'i zbonin nga skena.

- Nëse arrin ta mbarosh monologun, - tha Xhuliani me zë të ulët, pasi kishte parë të tjerët, - do të jesh në rregull. Dëgjo një marifet. Po bën prova, jo audicion. Bëj sikur e ke fituar rolin.

- Por nuk e kam fituar akoma. Si dreqin ta bëj këtë marifet?

- Aktro, - tha ai.

I thirrën numrin.

- Numri 49. Jozefina Kollins.

- Më uro fat, - pëshpëriti ajo, duke i hedhur çantën Xhulianit dhe u ngrit.

- Nuk ke nevojë për fat. E ke fituar rolin.

Xhuliani e pa tek lëshoi flokët dhe u shndërrua në një tjetër njeri mbi skenë, në dikë që jehoi pa mikrofon në atë amfiteatër gjashtëmijë vendesh, në dikë që nuk fliste me zë *femme fatale*, në dikë me theks britanik. Qëndronte drejt, sytë lart, mjekrën lart, me trupin në pozë dramatike dhe recitonte me zë të lartë drejt vendeve bosh.

*Çfarë është kjo fuqi, që ngre lart dashurinë
Që më lejon të shoh, por jo të kulloj sytë?
Më e larta hapësirë që dhuron kjo natyrë
Pëlqehen dhe puthen kaq thjesht, kaq mirë.*

Drejtori i audicioneve në rreshtin e parë e ndali.

- Znjsh. Collins, çfarë është kjo që po na reciton?

- Shekspiri, zotëri, nga *Gjithçka që Mbaron Mirë...*

- Ky është audicion për *Parajsën në Park*. Duhet të provosh për rolin e Beatrices ose të Dantes.

- Sigurisht. Po tregoja aftësitë e mia. Po kjo, - ajo uli zërin në nivel basi të thellë, ngriti shikimin, goditi gjoksin, - *nëpërmjet meje kalon drejt qytetit të mjerimit, nëpërmjet meje kalon drejt dhimbjes së përhershme.*

- Faleminderit... Tjetri. Numri 50. Xhulian Kruz. Z. Kruz, po ju, keni përgatitur diçka nga Danteja për ne?

DHURATA E MAGJISTARËVE

KUR ARRITËN TE MAKINA VAZHDUAN TË DISKUTONIN edhe pak. Ajo e quajti frikacak, ngaqë i tha regjisorit se nuk kishte përgatitur asgjë dhe ai e pranoi këtë etiketim për arsyen se nuk donte ta çonte në shtëpi. Ajo kapi flokët dhe hoqi syzet fallco. Dukej përsëri vetvetja, e thjeshtë dhe e përkryer. Pjesa e poshtme e bluzës i valëvitej nga era.

- Do të doja të mos kishte kaluar dita kaq shpejt, - tha ajo, duke vështruar kodrat rreth teatrit. - Mund të kishim ecur deri aty. Të të tregoja diçka.

- Ma trego, gjithsesi, - tha ai. - Prit... deri aty sipër?

- Çfarë, re dakord pa u menduar? S'e kthen dot fjalën mbrapsht tani. Do të më duhet të ta tregoj herë tjetër.

- Dakord. Po kur?

Ajo qeshi. U mbështetën pas *Volvo*-s ngjyrë gri, duke pirë ujë nga e njëjta shishe. Mendimet e Xhulianit nxitonin me shpejtësi rrufe.

- Cili është filmi yt i preferuar?

- Nuk e di. Pse?

- Eja tani, ma thuaj. Cili është? *Titaniku*?

- Eh, jo, nuk më interesojnë gjithë ato vdekje në ujëra të ngri-
ra, nuk dua ta shoh fare, - tha ajo, duke e vështruar me sytë të
shtrënguar. - *Apocalypse Now*.

Xhuliani e pa mirë e mirë.

- *Apocalypse Now* është filmi yt i preferuar?

Shprehja e fytyrës së saj nuk ndryshoi.

- Sigurisht. Çfarë ka për t'u çuditur kaq shumë?

- Asnjë arsye, - bëri sikur u kollit. - Nuk e kam parë.
Tani ishte radha e saj ta shihte mirë e mirë.
- Nuk e ke parë asnjëherë *Apocalypse Now*?
- Jo. Pse çuditësh?
- Se është film tipik për burra, prandaj. Duhet ta shohim ndo-
njëherë.
- Dakord. Kur?
Ajo qeshi. Qëndruan aty edhe pak.
- Dëgjo, unë duhet të kthehem, - tha ajo.
- Mendova se kishe uri, - tha Xhuliani. - Çfarë të hahet? Mund të
shkojmë ku të duash. Qeras unë. Ndoshta nuk di shumë për filmat
e Vietnamit, por e di mirë se ku ka ushqim të mrekullueshëm në L.
A. Të hahen tako? Shkojmë te *Factor*-i me gatime hebraike në Piko?
Për picë? Apo për byrek me arrë kokosi të *Marie Callender*-it.
Ajo dukej sikur po mendonte diçka.
- Mos mendo se jam e çmendur, - tha Jozefina, më në fund, - por
më hahet ushqim mëngjesi për darkë. *Hash browns*?¹
- Di një vend të mirë. *Hash browns*-et më të mira në L. A.
- A jam e veshur mirë për të shkuar aty?
- Për në IHOP? Je e veshur për mrekulli.
Xhuliani hapi derën e pasagjerit.
- E di atë shprehjen, - tha ajo, duke u futur në makinë, - që kur
dikush të hap derën, ose vajza është e re, ose makina është e re.
- Ha-ha, - ia bëri Xhuliani.
Në këtë rast, vajza ishte e re.

∞

- Me kë banon kur vjen në L. A.? - pyeti ai.
Ata ishin ulur përballë njëri-tjetrit, dhe pjata e tyre e dytë me
Hash browns ndodhej gjysmë e ngrënë në mes të tavolinës ngjyrë
blu.
- Me shoqen time Z.

¹ Patate të prera hollë, të skuqura me qepë, që amerikanët dhe britanikët i përdorin shumë për mëngjes. (Shën. i red.)

A guxonte Xhuliani të pyeste nëse Z-ja ishte Zoi apo Zakari? Guxonte.

- Kush është Z?

- Shoqja ime e ngushtë, Zakija.

- Aha, - ia bëri ai duke lëshuar frymën i lehtësuar. - Është edhe ajo në biznes?

- Dikur ishte.

Jozefina po trokiste pirunin mbi tavolinë. IHOP-i në bulevardin "Sunset" ishte bosh, se askush nuk shkonte në IHOP natën.

- Si e ka emrin e plotë?

- Zakija Job. Mbiemri Job si në Bibël, dhe emri Zakija, si paria e shoqërisë.

- Ju të dyja keni emra skenikë të pabesueshëm. Jeni me fat.

- E kush flet, ti, *Xhulian Kruz*, - tha ajo. - Gjithsesi, Z-ja është me fat. Juria ende nuk vendos për mua. Para shtatë vitesh u zhvendosëm në perëndim, siç bëjnë të gjithë. Këtu është parajsë. Gjetëm shtëpi, dhe filluam të shkonim nëpër audicione. Mendova se do të shkonte mirë - unë e bardhë dhe ajo e zezë - por me juri pa paragjykitime racore, agjentët bëheshin copash të punësonin atë dhe jo mua. Ndonjëherë ajo ishte më e mirë. Ndonjëherë isha unë më e mirë. Ishte e vështirë për t'u kuptuar pse ajo e fitonte gjithmonë rolin, dhe kjo u bë problem për ne. - Ajo psherëtiu. - Njëra nga ne duhet të zgjidhte një jetë tjetër që të vazhdonim të mbeteshim shoqe. Kështu që e vendosëm duke hedhur një monedhë.

- Ma merr mendja, - tha Xhuliani, - se fillimisht duhet të hidhni monedhën për të vendosur nëse donit të vazhdonit miqësinë apo jo.

- Jo, jemi rritur bashkë. Z-në e kam si motër.

Xhuliani e dinte si ishte të vendosje diçka me një hedhje të monedhës. Kur u takuan fillimisht me Guenin dhe Railin, ai dhe Eshtoni kishin hedhur monedhën se cili prej tyre do të lidhej me Guenin. Kjo për shkak se Raili, e gjatë, e mrekullueshme, kaliforneze, me flokët biondë të shndritshëm dhe lëkurën që i shkëlqente, të jepte përshtypjen se ishte e një niveli shumë të lartë për një burrë të zakonshëm. Edhe për Eshtonin, pamja e të cilit nuk linte fare për të dëshiruar. Eshtoni kishte thënë se dikush që kishte një paraqitje aq të përsosur në një lokal të rëndomtë lagjeje një

mbrëmje së mërkure gjatë *happy hour*-it, nuk do t'ia bënte jetën të lehtë një burri. Ajo dukej dhe sillej si një yll kinemaje. Dhe Gueni dukej si shoqja e ngushtë e yllit të kinemasë. Kështu që kishin hedhur monedhën për Guenin. Eshtoni kishte humbur. Gjë që ishte e çuditshme, pasi Eshtoni nuk humbiste asgjë.

- Kisha mjaft besim në vetvete, - vazhdoi Jozefina, - pasi nuk humbas asnjëherë në hedhjen e monedhës, dhe as në lojëra të tjera. Por fitoi Z-ja. Unë thashë të luanim deri në pesë pikë. Ajo fitoi përsëri. Thashë, deri në shtatë. E fitoi dhe atë.

- Ky vendim i madh që do ju ndryshonte jetën, a mos ishte i shoqëruar me tekila?

- Një shishe të tërë.

- Ma mori mendja.

- Ajo fitoi në të gjitha herët. Në fund i thashë, në rregull, edhe një herë të fundit, fituesja merr gjithçka, penallti. U bëmë gati me tekilën që kishte mbetur. Dhe si mendon, çfarë ndodhi?

- Fitove ti?

- Pse, - tha ajo duke vënë paksa buzën në gaz me një pamje kapriçoze, - sepse beson në filozofinë e Willi Wonka-s për lotaritë dhe jetën në përgjithësi?

Xhuliani qeshi.

- Në fakt, e besoj. Ke shanse më të mëdha për të fituar nëse dëshiron të fitosh më shumë se tjetri.

Jozefina pohoi me kokë.

- Dhe asnjëri nuk e donte atë fitore më shumë se unë. Por gjithsesi humba. Ndonjëherë, pavarësisht nga sa do të fitosh, prapë humbet. Ajo nuk dukej e mërzitur, thjesht kishte një pamje mendimtare, filozofike. - Pasi volla dhe u qetësova, Z-ja më tha se mund ta merrja fitoren dhe të vazhdoja me aktrimin. Ajo do të bëhej diçka tjetër.

Xhulianit i bëri përshtypje. Pasi kishte fituar ai, nuk ia kishte dhënë Eshtonit të drejtën për të dalë me Guenin.

- Përse e bëri këtë?

- Për faktin se në moshën që mund të recitoja *Tre Minjtë e Verbër* ngrihesha mbi çdo tavolinë, - tha Jozefina. - Improvizoja një skenë kudo që të isha. - Ajo pushoi së foluri, duke ngacmuar

patatet e ftohta që kishin ngelur. - Sigurisht që tani Z-ja ka një jetë të mrekullueshme, ndërkohë që unë akoma po pres të kap një rol të madh.

Zakija ishte terapiste arti në sistemin shkollor shtetëror të Kalifornisë. Udhëtonte në qytete të ndryshme të shtetit dhe stërviste mësues arti të nivelit tetëvjeçar për të aplikuar aftësitë e tyre në programin mësimor të nxënësve me nevoja të veçanta për t'i ndihmuar aty ku terapia tradicionale nuk funksiononte. Xhuliani mendoj se karriera e re e Zakijas ishte një oqean larg asaj mbi skenë. Njëra punë: unë, unë, unë. Tjetra: ti, ti, ti. Si mund të bënte dikush një ndryshim kuantik të tillë?

- Përse e vazhdoj pavarësisht mungesës së suksesit, më pyet?

- Nuk të pyeta. E di pse, - tha Xhuliani. - Pasi teatri është gjithçka.

Iu ngushtua fyti.

- Po! - lëshoi një pasthirmë Jozefina, dhe i shkëlqyen sytë. - Nuk është karriera e mirëfilltë, ngjan më shumë si sëmundje. Duhet ta duash jashtë mase, përndryshe nuk ka arsye të fiksohesh me diçka që shpërblen kaq pak njerëz.

Xhualini ishte dakord.

- Kjo është këshillë e mirë për shumë gjëra, jo vetëm për teatrin, - tha ai. - Por do t'ia dalësh.

Ai donte t'i thoshte se nuk ishte ndier asnjëherë në jetën e tij ashtu siç ishte ndier kur ajo qëndronte para tij mbi skenën e errësuar të teatrit "Cherry Lane". *Ah, ku është, ku ka ikur, e kaluara ime, kur isha e re?*

- E pastaj, nëse është ajo që bën, dhe mund ta bësh, atëherë bëje, - tha Xhuliani dhe shtrëngoi nofullën. - Sepse disa herë, nuk mund ta bësh. Dhe atëherë, nuk ka gjë më të keqe.

Jozefina vështroi fytyrën e tij si në kërkim të ndonjë shenje.

- Dhe ti e njeh këtë ndjesi?

- Po, pak. Ironia qëndron në atë se, - tha Xhuliani duke buzëqeshur me delikatesë, - pas gjithë atyre pijeve dhe hedhjeve të monedhës, ti nuk qëndrove në L. A. dhe shoqja jote qëndroi.

- E vërtetë. Erdhëm këtu së bashku, dhe ajo, që kishte thënë se nuk e duronte dot diellin e përhershëm dhe jetën e rremë të vendasve, vendosi të qëndronte, dhe unë, që më pëlqejnë që të dyja këto, u ktheva pas.

- Pse nuk qëndrove?

- Të thashë, nuk mund të jetoj këtu, - tha Jozefina. - Por sigurisht që nuk e dija këtë kur hodhëm monedhën.

- Ky është paradoksi i ndërrimit të orës. - Xhuliani po përpiqej të gjente diçka për të thënë që ta ngushëllonte. Ajo dukej sikur kishte nevojë. - Paradoksi i dukurisë së të kuptuarit pasi gjëja ka ndodhur. Nuk mund të veprosht në bazë të asaj që nuk di dhe nuk ke mundësi ta dish.

- Jo, nuk isha tërësisht e singertë. E dija, - tha bukuroshja e re, dhe zëri i saj i trishtuar jehoi në restorantin bosh. - E ndieja brenda meje, në shpirt. Mendoja se kjo peshë brenda meje ishte pasojë e tensionit midis meje dhe Z-së. Por pasi ajo iu kthye studimeve dhe unë vazhdova me audicionet dhe prapë kisha këtë stres, e kuptova se problemi nuk qëndronte midis meje dhe Z-së, por midis meje dhe Los Anxhelosit. - Ajo bëri një shenjë me dorë si për të larguar problemin imagjinar në ajër, bla-bla-ba. - Kështu që para gjashtë vitesh u ktheva në kënaqësitë absurde të jetës së skenës së Nju-Jorkut. - Ajo buzëqeshi. - Një herë në disa muaj vij këtu, bëj ca prova sa për të mbajtur anëtarësinë në Guidën e Aktorëve të Ekranit. Shkoj për vizitë te shoqja ime dhe largohem nga teatri për të parë nëse mund të jetoj pa të. Dhe nuk mundem. Vij në L. A., - tha Jozefina, - për të parë kush jam.

BULEVARDI “NORMANDIE”

BULEVARDI “NORMANDIE” KU JETONTE ZAKIJA KISHTE ndriçim të dobët. Nga të dyja anët e tij kishte palma të gjata të holla dhe shtëpi të klasës punëtore. Ishte i gjerë, por i zakonshëm.

- Vetëm këtë është në gjendje të përballojë, - tha Jozefina.

- Nuk thashë gjë. - Pas njëfarë kohe: - A është zonë e sigurt?

- Nuk është aq e sigurt sa *Volvo-ja* jote, por pse pyet?

Për një minute ajo do të largohet nga *Volvo-ja* e tij.

- Unë edhe Z-ja nuk kemi pasur shumë telashe, - vazhdoi, - nëse nuk e quan të tillë atë vrasjen nga makina që ndodhi herën e fundit kur unë isha këtu.

- E kush do të donte ta bënte?

- Ndodhi përballë shtëpisë së Z-së. Policët bllokuan rrugën për orë të tëra. Z-ja ishte në punë, ndërsa mua më thirrën për audicion dhe nuk mund të largohesha derisa të pastronin skenën e krimit. Historia e jetës sime.

- Pse nuk u zhvendoset diku tjetër?

- Sepse unë u ktheva në Nju-Jork. Kur paguanim qiranë të dyja ishte më e thjeshtë.

- Pse nuk gjen dikë tjetër që të ndajë shtëpinë?

- Kush do të donte të jetonte këtu? A e ke parë lagjen? - tha Jozefina duke ngritur supet. - Por ka edhe të mirat e veta. Është lirë, ngjitur me autostradën dhe qiradhënësja Rozi është shumë e mirë. Gjithmonë na gatuan *enchiladas* pasi Z-ja punon deri vonë dhe kur vjen është shumë e lodhur për të gatuar. Edhe pse di të gatujë mirë.

- Po ti? A gatuan?

- Oh, sigurisht që gatuaj, - tha ajo. - Bëj ndonjë tost *turpi*.

- Më pëlqen pa e provuar akoma, - tha Xhuliani.

- Prit derisa ta provosh. Do të çmendesh.

- Dakord... po kur?

Ajo qeshi sikur ai të kish qenë titullar i *Comedy Cellar*.

Zakija jetonte në një shtëpi lyer me të verdhë poshtë një drite ruge verdhacuke. Ai afroi makinën pranë trotuarit dhe filloi të parkonte. Po mendonte a ta fikte apo jo. Xhuliani dëshironte të hynte në shtëpi. Në fakt as vetë nuk e dinte çfarë donte.

- Do të të pëlqente Zakija, - tha Jozefina. - Ajo punon në arsim, njësoj si ti.

- Unë nuk punoj në arsim, Jozefina. Punoj në fushën e argëtimit.

- Ti u mëson njerëzve si të përdorin uthullën. E quan argëtim këtë? *Unë* punoj në fushën e argëtimit.

- Kushdo mund ta bëjë Oscar Wilde të duket argëtues, - tha Xhuliani. - Ai ta ka bërë shumë të thjeshtë. Por të bësh uthullën argëtuese, *kjo* kërkon talent.

- Pra, je një akademik argëtues, - tha ajo.

- Dëgjjo, andej nga jam unë, ky do të konsiderohej si kompliment.

- Edhe andej nga jam unë, - ajo u shtriq dhe krahët e saj prekën tavanin e makinës. - Unë dhe Z-ja jetojmë në katin e dytë. Kemi një ballkon, - ajo drejtoi gishtin drejt shtëpisë dykatëshe, - ku kemi mbjellë lule. A mund t'i shohësh? Azalea të kuqe. Petunia të verdha.

- Je me fat që dikush nuk është ngjitur të t'i vjedhë, - ai hodhi një vështrim lart e poshtë rrugës.

Ajo nuk u ndje e ofenduar.

- Ta përmenda këtë gjë për ballkonin, - tha ajo, - në rast se do të doje ndonjëherë të qëndroje poshtë tij dhe të recitoje ndonjë këshillë për jetën, ndonjë poezi ose çfarëdo tjetër.

Duke u larguar ngadalë nga ajo, ai nuk kishte asnjë gjë për të thënë, asnjë përgjigje të zgjuar.

Me lëvizje të ngadalta, ajo tërhoqi çantën që e kishte mbështetur te këmbët.

- Thjesht po të ngacmoj. Faleminderit për sot. U kënaqa.

- Edhe unë.

Ajo hapi derën dhe u kthye nga ai. Xhuliani ishte gati të villte broçkulla, të hapte gojën dhe para se të largohej të derdhte lumë të gjitha planet e tij, se sa shumë kishte dashur një jetë tjetër dikur, se sa u lëndua që e braktisi atë dëshirë, dhe sa e vështirë ishte të bënte paqe me atë vendim, por dëshira kokë-poshtë që kishte për të, që e bënte të ndihej sikur po zhytej në një pemishte me trëndafil, me ferra dhe petale bashkë, e bënte të pamundur që të merrte frymë apo të fliste.

Dora e saj ishte ende te dera e hapur, këmba e saj e djathtë tashmë ndodhej jashtë.

Duke u përkulur në drejtim të tij, ajo e puthi lehtë në faqe, afër buzëve. Ajo vinte aromë çokollate me qershi, pemë palme dhe zjarri. Një ndjenjë e diçkaje të pafuqishme lindi brenda tij.

Pasi ajo e përshëndeti dhe u largua, ai u ndal para shtëpisë së saj, me sytë të ngulur te ballkoni i verdhë në gjendje të mjeruar, me azaleat e vyshkura, dhe grushtet të mbështetura në gjoksin e tij. Ai hapi xhamin që të dëgjonte zhurmën e lëvizjes së makinave në autostradën “Hollivud”, një bllok apartamentesh më tutje, ku dalloheshin dritat e makinave që fluturonin, duke gëluar si një oqean i trazuar. Një milje në veri, në fund të rrugës së gjatë e të drejtë “Normandie”, ngriheshin malet gjigante të Santa Monica-s, dhe gdhendur në to, tabela HOLLIVUD, që ndriçonte në mes të errësirës. “Normandie” ishte rrugë kryesore dhe makinat shpeshherë kalonin me shpejtësi para se të ngjisnin maloren mbrapa Xhulianit, dhe të zhdukeshin. Përballë shtëpisë së Z-së gjendej një ndërtesë e ulët, me portën e oborrit të kyçur, që ngjante si ndërtesë sociale, si një duplex i lirë, i mënjanuar. Të gjitha dritat ishin të ndezura. Dëgjohej zhurmë. Tela me gjemba vareshin nga dritaret me hekura dhe ballkonet, dhe ngjanin si drita Krishtlindjesh.

Xhuliani u afrua dhe i vështroi me vëmendje. Jo, nuk ishin tela me gjemba. Sa e largët dukej Lufta e Dytë Botërore për të. Ishin tela me teh të mprehtë. Kjo ishte mënyra moderne, mënyra që përdorej në L. A. Kur gjambat nuk janë mjaftueshëm parandalues, tehet me cep të drejtë presin fytyrën tënd, atë të Romeos teksa ngjitet për t’i kënduar një sonet dashurisë sate. Jozefinë, Jozefinë.

Pse ka nevojë një shtëpi për tela me teh në dritaret dhe ballkonet e saj?

Xhuliani nuk donte të mendonte më për ditën e tij. Ai donte vetëm të ndiente. Kur ishte trembëdhjetë vjeç i pëlqente çmendurisht një vajzë në shkollë. Pëlqimi ishte aq i fortë sa e kishte lënë pa fjalë. Sa herë që ishte dhjetë metra pranë saj, ai fillonte të djersitej dhe zemra i rrihte shpejt. Në mes të vitit shkollor ajo bëri një operacion në zemër dhe vdiq në sallën e operacionit. Ishte hera e fundit që Xhuliani ishte ndier në këtë mënyrë. Që atëherë, mendohej ta mbante veten nën kontroll. Asnjë nga gratë që kishte njohur më vonë, edhe pse disa prej tyre kishin qenë mahnitëse dhe frymëzuese, nuk e kishin bërë të ndihej si ai fëmija gjuhëlidhur në orarin e pushimit. Ai mendohej ta shmangte me çdo kusht, ndjesinë e të qenët jashtë kontrollit. Ishte kaq dëshpëruese. Ai donte një jetë dashurie të arsyeshme. Një jetë të arsyeshme.

Dhe deri sot, kështu kishte ndodhur.

6

GUENI

KUR GUENI HAPI DERËN, NË ORËN DHJETË TË NATËS, ajo ia nguli sytë sikur ai po i sillte lajmin se dikush kishte vdekur.

Gueni kishte të drejtë që merakosej. Ata kishin një plan javor, nga i cili devijonin rrallë. Të enjteve dilnin dhe ajo e kalonte natën në shtëpinë e tij. Të shtunave në darkë dilnin zakonisht me Eshtonin dhe Railin. Të dielën hanin *brunch* të katërt. Të mërkurave, ai dhe Gueni përpiqeshin të drekonin së bashku, nëse Xhuliani nuk kishte mbledhje dhe ajo nuk ishte e zënë me punë. Ajo punonte si sekretare në një kompani ligjore argëtimi.

Ajo jetonte në katin përdhes të një pallati, së bashku me dy vajza të tjera. Të tria po shihnin filmin *Shtëpiake të Dëshpëruara*. Dy vajzat e tjera përshëndetën Xhulianin, të bezdisura nga ndërprerja që shkaktoi ardhja e tij.

- Çfarë ka ndodhur? - pyeti Gueni - E kishim lënë për të dalë sot?

- Jo, jo.

- Po pra, e marta nuk është një nga ditët që dalim, - tha ajo duke buzëqeshur.

- A mund të flasim?

Gueni hodhi një vështrim nga divani ku po prisnin shoqet e saj.

- A mund të presësh deri nesër, Xhuls? Se kanë mbetur edhe pesëmbëdhjetë minuta nga seriali që po ndjekim dhe pastaj duhet të shtrihem për të fjetur. Nesër duhet të jem në punë në orën 8:00, për shkak të kontratës problematike që kam me ta. Pra, a mund të presësh deri nesër?

- Jo.

Gueni bëri një grimasë që shprehte mërzë.

Ai nuk donte që të flisnin në kuzhinë dhe Gueni ishte me pizhame. Nuk kishte shanse që ta bindte të shkonin deri te makina e tij dhe të bënin një bisedë serioze.

- Eja shkojmë te dhoma jote.

Ajo me sa duket e keqkuptoi propozimin e tij dhe duke buzëqeshur e kapi nga kyçi i dorës.

- Vajza, vazhdoni ta shihni pa mua.

Kur hynë në dhomën e saj, ajo u shtri në krevat, ndërsa ai u ul në një karrige përballë saj, duke lëvizur duart vazhdimisht i tensionuar.

- Pse rri kaq larg?

- Gueni...

Ajo u ngrit dhe nuk e la ta mbaronte fjalinë. - Jo. Mos fillo asnjë bisedë me *Guenin*. Xhuls, jam shumë e stresuar në punë, asnjëherë nuk punoj aq shpejt sa duhet apo aq gjatë sa duhet. Sot isha aty deri në tetë e gjysmë. Nëse nuk po sillem si gjithmonë, kjo vjen ngaqë jam e mbingarkuar.

- Nuk është kjo.

- Jam kaq e lodhur gjatë gjithë kohës, sa në këto momente nuk mund të merrem me budallallëqe, Xhulian, - tha ajo. - Nuk mund të presësh derisa të kem më shumë energji?

- Nuk mundem. Më fal, Gueni. Nuk di si të ta them. Asnjëherë nuk do të jetë momenti i duhur për të ta thënë këtë.

Ai drejtoi kurrizin, mori frymë thellë. Ajo shtrengoi sytë duke i mbyllur me duar.

- Xhulian... ti... po ndahesh nga unë?

- Po. Më fal. Të lutem mos u mërzit. Mos qaj, - tha ai dhe iu afrua që të ulej pranë saj në krevat duke u munduar që ta prekte. - Ti je një vajzë e mrekullueshme. Nuk do të jesh vetëm asnjë moment. Dhe shpresoj të mbetemi shokë...

- Nuk e ke seriozisht! - bërtiti ajo duke ia larguar krahun me forcë. - Ne nuk mund të ndahemi! Kemi rezervuar për *brunch*¹ tek *NNaka* këtë të diel! Kemi tre muaj që e presim këtë ditë!

¹ Brunch - mëngjesi i vonë. (Shën. i red.)

- Për sa i përket kësaj...

- Dhe muajin që vjen do të shkojmë në Cabo. Ti tashmë ke rezervuar dhe hotelin.

- Për sa i përket kësaj...

- Pse po e bën këtë?

Çfarë mund të thoshte? Çfarë mund t'i thoshte që ta lëndonte sa më pak?

- Duhet të kem bërë ndonjë gabim, - tha Gueni. - Më fal. Gjithmonë kam lëkundje humori. Nuk je ti Xhulian fajtori, fajtorja jam unë. Duhet të marr ndonjë gjë. Psikologu im thotë që më duhet diçka.

Ai i kapi dorën dhe ia mbajti pavarësisht ngurrimeve të saj.

- Nuk ke lëkundje humori. Nuk ke nevojë të marrësh asgjë. Nuk e ke ti fajin. Singërisht. Unë e kam, - tha ai dhe mori frymë thellë. - Njoha dikë, - tha Xhuliani. - Dhe nuk dua të fshihem prej teje apo prej saj. Nuk dua të përfundoj apo të filloj diçka në këtë mënyrë. Më fal. Nuk e prisja, nuk ishte diçka që po kërkoja, nuk ishte diçka që e dëshiroja.

Por a nuk ishte e vërtetë vallë? A nuk ishte diçka që po kërkonte? Teksa vërtitej rrugëve të Los Anxhelosit, qytetit të engjëjve, duke provuar bare të reja, kafene të reja, restorante të reja, kinema të reja, dyqane të reja, teksa kulloste nëpër plazhe dhe bordura, teksa ulej jashtë për të ngrënë dhe për të pirë në fresk, teksa vërtitej qendrave tregtare, varrezave, holleve të hoteleve, çfarë shihte, çfarë kërkonte? Po, po mblidhte material për gazetën e tij: fotografi, lule, vizione jete. Por a ishte vetëm kjo vallë? Për dhjetë vjet i kishte ardhur Los Anxhelosit rreth e rrotull, në një shëtitje jo vetëm të trupit, por edhe të shpirtit. Mos vallë po kërkonte dikë? Duke vështuar në sytë e çdo gruaje që kishte takuar, pyetja prapa syve të tij kish qenë gjithmonë e pranishme. A ishte ajo *e duhura*?

Por një gjë Xhuliani e dinte me siguri... dhe e kishte ditur që në fillim. Gueni nuk ishte e duhura.

- Kemi qenë bashkë për një kohë kaq të gjatë! - tha Gueni. - A nuk meritoj diçka më të mirë se kjo?

- Po, - tha Xhuliani. - Ti meriton më shumë se unë.

- Po pse duhet të humbas tre vjet nga *jeta ime*?

- Ndonjëherë, - tha Xhuliani, - kur je në rrugën e gabuar, duhet të zbresësh, të kthehesh pas dhe të rifillosh sërish.

- Po më quan rrugë të gabuar? E marrtë dreqi e marrtë!

- Jo. *Unë jam* rruga e gabuar.

- Mendoja se mamaja jote të kishte rritur më mirë se kaq, - tha Gueni.

- Çfarë po bëj? - tha Xhuliani. - Po mundohem të bëj gjënë e duhur, gjënë e sinqertë.

- Gjëja e duhur do të ishte të mos ndaheshe nga unë.

- Por nuk do të ishte gjëja e sinqertë.

- Gjëja e duhur do të ishte të mos kishe shkuar me dikë tjetër!

- Nuk kam shkuar me asnjë tjetër. Është diçka krejt e re.

- Por ti e dëshiron.

- Po, - tha Xhuliani, - e dëshiroj.



Nga Redaksia e

Zotit Di Gjithçka

Vëllimi 11, Numër 201



- *Sinonime për mishmashin: përzjerje, potpuri, lëmsh.*
- *Mund të kuptosh shumë gjëra, në mos çdo gjë për një person, nga lloji i këpucëve që vesh.*
- *Muhammad Ali thotë, kur stërvitesh mos i përsërit ushtrimet në numër të caktuar. Bëji derisa të ndiesh dhimbje, dhe pastaj bëji disa herë më shumë derisa të ndiesh dhimbje të vërtetë. Nëse nuk je në agoni, nuk po bën stërvitje.*
- *Dëshiron të shohësh një film me një vajzë? Pyete se cili është filmi i saj i preferuar. Kur ajo të ta thotë, thuajti që nuk e kam parë, edhe nëse e ke parë. Nëse ajo të simpatizon, do të të thotë që ta shihni së bashku.*
- *Kur del jashtë, vishu gjithmonë sikur do të takosh dashurinë e jetës sate.*

Duhet që t'ia nënshtroni veten tuaj elementëve shkatërrimtarë.

Joseph Conrad

ESHTONI DHE RAILI

PASI I ISHTE PËRMBYSUR E GJITHË BOTA, XHULIANI e kaloi pjesën tjetër të natës duke menduar për Jozefinën dhe kjo reflektohej në buletin e tij të mëngjesit, që ishte një mishmash i përshtatur nga një citim i çuditshëm i Joseph Conrad-it (a ekzistonte ndonjë tjetër lloj?).

E kishte ai radhën për të hapur dyqanin dhe Xhuliani mbërriti në rrugën “Magnolia” para orës nëntë. Për habinë e tij Eshtoni ishte brenda. Zakonisht, në ditët kur e kishte radhën Xhuliani për ta hapur dyqanin në mëngjes, Eshtoni flinte gjumë. Dhe në fakt, miku i tij mezi po rrinte në këmbë, dhe dukej sikur me zor ishte veshur. Eshtoni i mbante flokët shumë të shkurtër që të mos merrej me to, por nuk kishte arritur të rruhej dhe mjekra e tij si kashtë e pisët ia errësonte fytyrën.

Raili qëndronte përbri tij. Kjo ishte një surprizë edhe më e madhe. Railit nuk i interesonte dyqani, toleronte çdo gjë që lidhej me të, ashtu si çdo gjë tjetër që kishte të bënte me Eshtonin - dorëhiqej me dëshirë. Por ajo nuk shkonte asnjëherë në dyqan gjatë ditëve të javës kur duhej të ishte në punë. Raili ishte supervizore e produkteve organike të *Whole Foods*. Mëngjeseve ishte gjithmonë shumë e zënë me punë.

Eshtoni dhe Raili po qëndronin te banaku afër kasës, duke vështruar Xhulianin me duart të kryqëzuara para gjoksit. Sigurisht që Eshtoni, i cili nuk merrte asgjë seriozisht, po e vështronte Xhulianin në një mënyre gjoja kritikuese me duar të kryqëzuara po në mënyrë tallëse. Ai po imitonte Railin, për të treguar se ishin në një front, të bashkuar, dhe përpiqej të fshihte prej saj dëshirën e tij të vazhdueshme për gjumë.

- Ç'kemi? - tha Xhuliani dhe tundi çelësat.

- Pse nuk na e thua ti? - tha Raili me fundin e kostumit pa asnjë rrudhë, me flokët e saj biondë ngjyrë mjalti të krehur drejt si xham, me tualet të përkryer, me qëndrim prej balerine. Ajo bënte kontrast të plotë me të dashurin e saj të lodhur, veshur me kanotierë e xhinse të grisura dhe gjysmë të fjetur. - I dhe fund lidhjes me Guenin mbrëmë?

- Oh, - ia bëri Xhuliani, i cili duhej ta kishte marrë me mend që Gueni do t'i telefononte Railit menjëherë.

- Pse e bëre?

- Duhet të të jap shpjegim ty për çdo gjë? - Ai po i jepte shumë gojës. Por Gueni dhe Raili ishin shoqe të ngushta. Ai e dinte shumë mirë që duhej të shpjegohej, por thjesht nuk donte.

- Gueni është shumë e mërzitur, Xhuls, - tha Raili. - Ajo thotë që i shpërdorove kohën, e bëre të besojë në gjëra që nuk ishin të vërteta. Ajo nuk e kupton se çfarë mund të ketë ndodhur. Më tha që ti po planifikojë t'i propozojë për martesë në Cabo muajin e ardhshëm!

Xhuliani tundi kokën. Kjo ishte thjesht një imagjinatë e Guenit.

- Ndarja është mjaft e keqe, - vazhdoi Raili, - por pse e gënjeve?

- Nuk e gënjeva...

- Po, e gënjeve. I the që ke njohur dikë.

Eshtoni gjithashtu po tundte kokën.

- Po *ti* pse po e tund kokën? - pyeti Xhuliani.

- Kë mund të kesh takuar? Bashkë u takuam të hënën në darkë dhe nuk kishe takuar askënd, - tha Eshtoni. - Na paske njohur dikë dje krejt papritur?

- Kështu funksionon, - tha Xhuliani. - Kjo është arsyeja pse quhet *takim me* dikë.

- Dakord, - tha Eshtoni. - Nëse do të gënjeshe, mirë, por të paktën mos gënje kaq keq.

Raili u kthye nga Eshtoni, duke tundur flokët e saj të gjatë gjer në shpatulla.

- Ti mendon se do të ishte më mirë për të që të gënjente?

- Nuk doja të thosha këtë.

- Po atëherë çfarë doje të thoshe?

- Ej! Kjo nuk ka të bëjë me mua. Ai po gënjen dhe po ndahet. Pse po më akuzon mua?

Eshtoni i hodhi Xhulianit një vështrim sikur donte t' i thoshte "ta tregoj kur të flasim bashkë".

Xhuliani iu përgjigj duke fërkuar mjekrën me gishtin e mesit.

- Dëgjo, Xhuls, - tha Raili, - nuk kam kohë të merrem me këtë. Kam folur me Guenin në telefon deri në dy të mëngjesit dhe sot duhet të isha në punë në orën shtatë. Kemi një dërgesë me domate të painspektuara që vjen nga Arkansas-i, dhe megjithatë unë jam këtu, me ty, për shkak të rrëmujës që ke shkaktuar. Në fund të bisedës ramë dakord që Gueni është e gatshme të bëjë disa ndryshime... nëse kjo është ajo për të cilën ke nevojë.

Xhuliani tundi kokën. - Nuk është kjo ajo për të cilën kam nevojë.

- E di çfarë, Xhulian, - këtu Raili përdori zërin e saj të ngadaltë, të mençur dhe autoritar, - nëse mendoje se lidhja juaj kishte nevojë për përmirësim, pse nuk bisedove me të? Ju të dy keni qenë bashkë për një kohë shumë të gjatë. Nuk mendon se ajo e meritonte një bashkëbisedim?

- Ne e bëmë një bisedë, - tha Xhuliani.

- Po nuk kishe pse shpikje gjëra të çuditshme nëse ajo që doje ishte që gjërat të ndryshonin.

- Nuk ishte kjo ajo që doja dhe nuk ishte ajo që bëra.

- Me të vërtetë? - Raili vendosi dorën në ijë duke marrë një pozë si çajnik. - A nuk gënjeve kur i the Guenit se ti dhe Eshtoni hodhët një monedhë... për të!... dhe ti fitove? Pse duhet ta thoshe një gjë të tillë?

- Po, Xhulian, - tha Eshtoni, tashmë duke u tallur me të vërtetë.

- Pse *dreqin* duhet ta thoshe një gjë të tillë?

- A nuk kuptohet përse e bëra? - tha Xhuliani. - Për ta bërë Guenin të ndihet më mirë.

Raili u vërtit drejt Eshtonit. - Është e vërtetë, Eshton Benet? Që unë dhe ti u lidhëm bashkë vetëm, sepse ti humbe në një hedhje monedhe? Dhe se unë isha çmimi juaj i ngushëllimit? Sepse që ta dish, disa herë është *pikërisht kështu* si më trajton.

- Jo, dielli im, *sigurisht* që nuk është e vërtetë, - tha Eshtoni, duke vendosur krahun e tij të gjerë rreth shpatullës së Railit dhe duke e tërhequr drejt vetes. Raili ishte e gjatë, por Eshtoni ishte edhe më i gjatë. - Ti e dëgjove Xhulianin, ai e tha vetëm që ta bënte Guenin të ndihej më mirë. Një shkëlqim verbues u dallua në sytë e akullt ngjyrë blu të Eshtonit. - Apo jo, Xhuls?

Xhuliani mallkoi nëpër dhëmbë. - Eshtoni ka të drejtë, - tha ai. - Unë doja vetëm ta bëja Guenin të ndihej më mirë, - ai shtrengoi grushtin rreth çelësave të tij të mprehtë.

- Xhuliani, ti gjithmonë e ke pasur të vështirë të flasësh për këto gjëra, - Raili po përdorte zërin e saj të qetë, psikoanalitik. - Ti je tip i mbyllur, i mban përbrenda emocionet dhe kjo nuk është gjë e mirë. Ti po vazhdon të sillesh sikur asgjë nuk të shqetëson...

- Asgjë nuk më shqetëson.

- Dhe për më tepër, në vend që të përpiqesh për të rregulluar gjendjen, i thua Guenit që ke njohur dikë.

- Po, - tha Xhuliani, - takova dikë.

- Qepe, - tha Eshtoni. - Boll i bëre gjërat më keq me këto që po thua.

- Ta thashë tashmë, Gueni ka rënë dakord të bëjë disa ndryshime, - tha Raili. - Megjithëse ajo nuk e toleron sjelljen tënde disi pasivo-agresive, është e gatshme të bëjë çfarë është për t'u bërë për të qenë sërish e jotja.

- Më lër ta kuptoj pak drejt këtë, - tha Xhuliani. - Gjykimi im për t'ia thënë Guenit në fytyrë që do të ndahemi qenka pasivo-agresiv, ndërsa vendimi i saj për të dërguar një përfaqësues që të diskutojë për lidhjen tonë, qenka mënyra për t'u përballur me situatën kokë më kokë?

Raili, e papërkulur, vazhdoi; ajo kishte një listë të tërë gjërash për të thënë derisa të vazhdonte me domatet.

- Gueni thotë që është e gatshme të shkojë me ty në një ndeshje boksi në Las Vegas nëse kjo është ajo që ti dëshiron.

- Nuk është kjo ajo që dua.

- Gjithashtu, ajo, - vazhdoi Raili, - nuk do të të bezdisë më në lidhje me të gjeturit e një pune serioze.

- Kjo mund të ishte një këshillë e mirë jo vetëm për Guenin, - tha Eshtoni.

Raili ngriti dorën me thonjtë e lyer me mjeshtëri që ta ndalonte Eshtonin për të folur.

- Të lutem, - tha ajo, - nuk mund të merrem me *ty* tani. Po përpiqem të shpëtoj lidhjen e *tyre*.

Ajo mori frymë e acaruar.

- Edhe Gueni, - vazhdoi Raili më mënyrën e saj profesionale, serioze, - tha se do të ishte e gatshme të bënte atë gjënë tjetër që do të bësh, për të cilën ka kohë që të thotë jo.

- Kjo mund të ishte një këshillë e mirë jo vetëm për Guenin, - tha Eshtoni.

- Eshton Benet, nuk është vendi për shakatë e tua! Xhuls, të të them mendimin tim? - Raili shfryu. - Do të ta përmirësonte gjendjen shpirtërore një banjë me baltë në brigjet e oqeanit gjatë baticës, pasuar nga një apiterapi. Të dyja do të ndihmojnë mrekullisht me problemin tënd të ankthit.

Xhuliani u mundua të mos shkëmbente as shikimin më të vogël me Eshtonin.

- Apiterapi? Do të thotë të më sulmojnë bletët apo të shpohem me gjilpëra?

- Nuk sulmohesh, - tha ajo në pozicion vetëmbrojtjeje, - pickohesh nga bletë në mënyrë të mençur, që të pastrohesh nga papastërtitë, qofshin shpirtërore apo fizike.

- Nuk kam nevojë të pickohem nga bletë, - tha Xhuliani, - unë i kaloj ditët duke kërkuar mënyra se si të parandaloj njerëz të *tjerë* që të mos pickohen nga bletë. Dhe gjithashtu... unë nuk kam probleme ankthi.

Xhulianit i ra telefoni. Ishte ora 9:07 e mëngjesit.

- Ç'kemi? - u dëgjua zëri i Jozefinës. Me zërin e saj të ëmbël ajo mund të joshte murgjit në të gjitha misionet e Kalifornisë.

- Po? - Xhuliani u mundua të mos e jepte veten. Ai ngriti gishtin për t'i thënë "një minutë" Eshtonit dhe Railit - të cilët kishin ngrirë aty pranë banakut - dhe u ktheu kurrizin.

- Kush je ti? - tha Jozefina.

- Kush je *ti*? - përsëriti Xhuliani - Ti po më telefonon.

- E di që po të telefonoj ty, - tha ajo, - por dikush i telefonoi numrit tënd nga celulari im dje në orën 4:49 të pasdites, dhe e di që nuk mund të kem qenë unë pasi isha në skenë. Megjithatë ja tek është. Numri yt në celularin tim.

Çfarë duhej të thoshte Xhuliani?

- Mirëmëngjesi, Jozefinë, - tha ai me qetësi.

- Ç'kemi Xhulian? - pyeti ajo duke qeshur. - Thjesht mund të më kishe pyetur për numrin. Do të ta kisha dhënë. Çfarë po bën tani?

- Sot? - tha ai - Apo në këtë moment?

- Më shpejt akoma. Kam një problem. A mund të vish? Ej, pse po flet me kaq zë të ulët? - ajo uli zërin gjithashtu. - Kush po dëgjon?

Eshtoni u shfaq ngjitur krahut të tij.

- Çfarë dreqin po bën? Nuk kemi mbaruar.

- Do të vij për pak, - Xhuliani mbylli telefonin dhe u kthye nga shoku i tij. Ishin vetëm ata të dy në dyqan. - Ku është Raili?

- Iku, - tha Eshtoni. - Nuk mund të priste të mbaroje me telefonatën. Ajo tha që ky diskutim nuk është mbyllur akoma.

- Oh, - tha Xhuliani, - sigurisht që jo. Ai tundi çelësat. - A mund të rrish ti në dyqan për pak? Më duhet të dal. Do të kthehem shpejt.

- Kur thua shpejt, sa zgjat? Dy ditë? Sot është radha jote për të hapur dyqanin, të kujtohet? Unë supozohet se duhet të jem në krevat. Duke fjetur. Dhe pse i the Guenit për monedhën? Çfarë dreqin po bën, o burrë. Dhe kush ishte në telefon?

- Të them më vonë. Lëviz, - Xhuliani u mundua të kalonte rrotull Eshtonit.

- Ku po shkon?

- Të takoj një burrë për të diskutuar në lidhje me një kalë.

Eshtoni nuk u tund nga vendi. - Kush ishte në telefon?

- Askush. Lëviz.

- Më bëj të lëviz, - Eshtoni e përplasi lehtë Xhulianin me trup.

Xhuliani e shtyu pas, jo fort. - A do që të të bëj të lëvizësh?

Sytë e kaltër të Eshtonit vezulluan. Ai vazhdonte përpjekjet për t'i marrë celularin Xhulianit nga duart.

- Më le vetëm dje në drekë, - tha ai. - Në atë kohë e takove këtë personin, që tani të merr që herët në mëngjes? A ke ndër mend të kthehesh apo të marr Brajsin në telefon?

Brajsi ishte një nga shokët e tyre të universitetit, i cili mendonte se ishte shoku *tjetër* i ngushtë i Eshtonit.

- Mos më kërcëno me atë drej Brajsi, - tha Xhuliani. - Do të kthehem.

- Nga pamja e fytyrës sate tepër të eksituar, nuk mendoj se do të kthehesh.

- Mjaft me këtë melodramaticitet, - tha Xhuliani. - Kemi një takim për gardërobën në *Warner*.

- Po. Në njëmbëdhjetë.

- Ka shumë mundësi që të mos jem kthyer deri atëherë, - tha Xhuliani. - A mund ta shtysh për pasdite? Eshton... të lutem, a ka mundësi..., - ata vazhduan të përplaseshin me njëri-tjetrin, një pantonimë e mirëpërsëritur e një lufte miqësore.

- Xhuls, të lutem më thuaj që dje nuk takove një vajzë dhe pas një pasditeje me të u ndave nga e dashura jote, me të cilën je i lidhur prej kohësh, dhe tani po ikën me vrik sikur të ka thirrur për të fjetur me të.

- Atëherë meqë qenke kaq gjeni, mjaft më mbajte këtu.

- Prit! - tha Eshtoni. - Kam një pyetje shumë të rëndësishme...

Xhuliani priti i paduruar.

- Si duket nga pamja e jashtme? - pyeti Eshtoni me një fytyrë të qeshur dhe, më në fund, e la Xhulianin të kalonte - Ti e di që ajo thjesht po të përdor për trupin tënd.

- Duhet të jem shumë me fat, - ia ktheu Xhuliani dhe nuk ia hodhi sytë Eshtonit, duke dashur që shoku i tij të mos shihte as edhe një reflektim të përshtypjes së thellë që kjo vajzë kishte lënë në zemrën e tij.

BERETA E KUQE, PROVA E PARË

ME TË ARRITUR NË RRUGËN “NORMANDIE”, XHULIANI i ngjiti shkallët dy e nga dy dhe pavarësisht kësaj, arriti të hidhte një vështrim drejt shtëpisë me siguri të lartë që ndodhej përballë rrugës. Edhe ditën me diell nuk dallohej mirë.

- Mirëmëngjesi, Xhulian, - tha Jozefina duke hapur derën.

Sapo kishte dalë nga dushi dhe ishte veshur hollë, me një kanotiere dhe pantallona të shkurtra për gjumë. - A nuk përdorin këtë shprehje në Hollivud, që pavarësisht se ç'orë e ditës është... thonë, mirëmëngjesi?

- Po, - tha ai, - por është, me të vërtetë, mëngjes. - Ata fshehën buzëqeshjet e tyre.

Apartamenti i Zakijas ishte i vogël dhe i pastër - një mjedis i përbashkët, kuzhinë dhe sallon ndenjeje, me tri dyer të brendshme gjysmë të mbyllura - një banjë dhe dy dhoma gjumi. Një tavolinë e vogël rumbullake, me syprinë laminati, një kolltuk i vjetër ngjyrë bezhë e lehtë, disa rafte librash. Një televizor. Një pistë vrapimi, dhe në cep një kitarë. Disa magnete të vogla vendosur te frigoriferi, një tufë me fatura dhe revista mbi banakun e kuzhinës. Apartamenti i një vajze punëtore që nuk ishte kurrë në shtëpi. Ishte qetësi dhe plot me diell, përveç gumëzhitjes së vazhdueshme që vinte nga autostrada.

- Kush i bie kitarës?

- Zakija. Duhet të të kërkoj një nder, - tha Jozefina dhe anoi kokën.

Xhuliani do e kishte bërë pa qenë nevoja të anonte kokën.

- Lajmi i mirë është që, - tha ajo, - mora një telefonatë për Danten. Është shokuese, e di, duke marrë parasysh katastrofën e djeshme shekspiriane.

Por lajmi i keq ishte që, telefonata kishte lidhje me rolin e tregimtarit, atë të një burri të vjetër me syze dhe një parukë me rëndësi historike.

- Ti je eksperte për rolin e burrit të vjetër, - tha Xhuliani. - Thjesht kanalizoj Housman-in tënd të brendshëm.

- Problemi është te paruka. Audicioni është në orën njëmbëdhjetë. Si mund të shndërrohem në një burrë të vjetër e të thinjur për një orë?

Duke vështruar fytyrën e saj të pastër ngjyrë rozë, Xhuliani ra dakord që nuk do të ishte një detyrë e thjeshtë.

Ajo nxori një shishe llaku.

- A mund të m'i ngjyrosësh flokët duke më hedhur pak nga ky llaku?

Ai tundi kokën dhe u zbraps. Nuk i pëlqente të bënte gjëra të panjohura për të.

- Eja, më duhet ndihma jote. Mund të bësh edhe gjëra të tjera përveçse të rrish para një kompjuteri, apo jo?

- Unë bëj plot gjëra të tjera. - Ai dëshironte të mos kishte tingëlluar kaq me nënkuptim siç ndodhi.

- A është ndonjë prej këtyre gjërave lyerja e flokëve të ndonjë vajze? - ajo tundi flokët e saj të errët e të lagësht në mënyrë që t'ia tregonte më mirë. Ato mbanin aromë arre kokosi. - Bëje, bëje, - i tha, - dhe më pas, do të të çoj në majë të malit që të të mahnit.

Trupi i saj mbante aromë të freskët arre kokosi të shkumëzuar, krahët dhe qafa shkëlqenin nga kremi. Xhulianit sikur iu squllën muskujt e këmbëve.

Ai kishte një ide tjetër.

- Pse mos të të gjejmë një parukë? Është shumë më e thjeshtë.

- Audicioni është për një orë.

- Di një vend.

- Nuk kam asnjë qindarkë.

- Është falas. A mund të vishesh për pesë minuta?

- Çfarë do të thuash? E veshur *jam*.

Pa tualet, pantallona të shkurtra, bluzë gri e grisur, pa sytjena (mos mendo për këtë) këmbë të zbathura, me flokë të shpupuritur. Ajo ishte veshur sikur do të gatuante *waffles* pasi kishin bërë seks, e jo për audicion. Ai nuk tha asgjë.

- Mirë, në rregull.

Pas dy minutash u shfaq te dera e njëres prej dhomave me pantallona xhins të shkurtra, çizme dhe një këmishë të bardhë të tejdukshme mbi kanotierën e saj të shkurtër. I dukej gjithë barku.

- Më mirë kështu?

Ai nuk tha asgjë.

Në makinë, teksa po bënte tualetin, ajo i tha Xhulianit se paguanin mirë për interpretimin tek *Komedia Hyjnore* e Dantes. Provat fillonin pas disa ditësh dhe do të zgjasnin një muaj.

- Megjithatë, do të më duhet të mësoj përmendësh nëntëdhjetë e nëntë pjesë. Duket e pamundur.

- Mund ta bësh, - tha ai. - Janë pjesë tepër romantike.

Ajo belbëzoi.

- Mbretëritë e të vdekurve janë romantike?

- Sigurisht, - tha Xhuliani. - Me veshje të rëndë, Dante kërkon Beatricën në ferr dhe parajsë se nuk e gjen dot këtu në tokë. Kjo a nuk është romantike? - tha ai duke qeshur.

- Nuk e di, - tha ajo. - A e gjen ai atë? E sheh, as Zoti Di Gjithçka nuk është i sigurt. Dhe mbjellësit e mosmarrëveshjeve, përgjithmonë të gjymtuar, sigurisht nuk janë të këndshëm. Dua të them që ka shumë vuajtje para se Dante të arrijë te Beatricja. Ferri, Purgatori. Madje pse e quajnë komedi? Sa larg është paruka?

- Pothuajse arritëm.

Bulevardi "Magnolia" ishte në anën tjetër të *Hollywood Hills*.

- "Magnolia"... a nuk janë të gjitha dyqanet me gjëra të vjetra këtu?

Xhuliani zuri një vend afër trotuarit.

- Po. Dhe ja ku mbërritëm.

Ata kishin parkuar përpara një dyqani të madh, në tendën ngjyrë kanellë të të cilit shkruhej: *KUTIA E THESARIT*.

- *Kutia e Thesarit*? - tha ajo - Ç'lloj dyqani është ky?

- Ai lloj dyqani ku mund të gresh atë që kërkon. Është i Eshtonit.

Domethënë, i imi dhe i Eshtonit. Por ai bën pjesën më të madhe të punës. Unë thjesht numëroj lekët.

- A ka parukë?

- Ai ka shumë gjëra, - Xhuliani fiku motorin e makinës.

- Me të vërtetë? Si për shembull?

- Çdo gjë. Gjithçka, - ai e pa teksa ajo vendoste një të kuq të shndritshëm në buzët e saj. - Për sa i përket Eshtonit...

- Duhet të *përgatitem* para se ta takoj? Pse, kaq i lezetshëm është? - ia bëri ajo duke zbardhur dhëmbët.

- Jo, nuk doja të thosha këtë.

Si mund t'ia shpjegonte Eshtonin kësaj të pafajshmeje?

- Atij i pëlqen të ngacmojë. Njësoj si ti. Mbaje mend këtë dhe injoroje.

- Siç më injoron ti mua?

- Po, njësoj.

Eshtoni po fliste në telefon mbrapa kasës. Ai kishte bërë dush, ishte rruar dhe kishte veshur xhinse të ngushta të zeza dhe një bluzë të bardhë të hapur te qafa. Këpucët e tij prej lëkure ishin të lustruara. Zilja e derës tingëlloi teksa po hynin brenda. Eshtoni ngriti kokën. Ai nuk mund ta mbyllte telefonatën kur pa Xhulianin me Jozefinën, por nga shprehja e fytyrës së tij, dukej që do të donte shumë ta bënte.

Edhe Jozefina shtangu nga habia. Edhe ciniku më i moshuar do e kishte të vështirë të mos mahnitej nga grumbullimi i stolive dhe rruazave rrëzëlluese që ishin vendosur në banakun e sheshtë të Eshtonit.

Gëzofë të vërtetë dhe fallco, abazhurë të vjetër, zbukurime të ndryshme, çanta firmato, fustane mbrëmjesh, kostume, lloj-lloj kujtimesh nga filma të ndryshëm ishin të ekspozuar edhe në shitje. Nga *Casablanca* (gotat te bari) te komedia *Back to the Future* (pajisja lëvizëse e Martit), objekte të mahnitshme reale nga shumë vende imagjinare. Tavlla nga filmi *Chinatown*, një kopje (jo në madhësinë e vërtetë) e Starship Enterprise, një e personazhit Han Solo në madhësi të vërtetë i ngrirë në grafit, kostume *Halloween*-i, këpucë dhe kapela, dhe gjithë aksesorët vezullues, duke përfshirë fotografi në kornizë të firmosura nga yjet, ku përfshihej zotërimi

më i çmuar i Eshtonit, një afishe e Bob Marlit të gëzuar e vitit 1981, e firmosur nga ai vetë disa muaj para se të vdiste. Kishte albume, fatura lojërash, shalle të ndryshme, një mur plot me lojëra të vjetra nga PacSun te Donkey Kong, një faqe muri plot me vepra arti origjinale nga artistët lokalë dhe ngjitur tij një tavolinë me furça, bojëra dhe kanavacë të zezë për shitje. Kishte një ekspozim bimësh dhe vitaminash jetësore, si për nder të së apasionuarës pas shëndetit, Railit. Kishte një derë të kuqe larë me dritë të zezë dhe një shenjë prej neoni sipër saj që lexonte, “Shtëpia e Përhumur, këtej”. Po, kishte gjithashtu një Shtëpi të Përhumur që funksiononte gjatë gjithë vitit, dhe gjithë zombie-t dhe monstat brenda saj ishin në shitje. Eshtoni i zëvendësonte me zombie dhe monstra të reja sipas nevojës. *Kutia e Thesarit* ishte një dyqan që askush tjetër përveç Eshtonit, gjurmues thesaresh dhe aventurash, nuk mund ta kishte shpikur apo imagjinuar. Gjithçka që ai ishte dhe gjithçka ai donte ishte në atë dyqan.

- Ky është vendi më i mrekullueshëm që kam parë ndonjëherë! - tha Jozefina dhe psherëtiu e emocionuar - A mund të vijmë përsëri?

- Ndoshta. Më ndiq mua, - i tha Xhuliani duke u futur në një nga dhomat e ngushta anësore dhe u ndje i çliruar kur menjëherë gjeti atë që po kërkonte: një parukë flokëgjatë të shekullit 18-të realizuar me flokë të vërtetë ngjyrë gri.

- E mrekullueshme, - tha ajo. - Kjo është fantastike, oh... por e shtrenjtë.

Xhuliani vendosi gishtin në buzë dhe psherëtiu, duke shprehur që do të mund ta nxirrte jashtë vjedhurazi para se Eshtoni të mbaronte telefonatën. Por nuk pati fat.

Eshtoni bllokoi derën e dhomës së vogël, duke bllokuar dritën e diellit me trupin e tij të gjatë.

- Hej, Xhuls. Çfarë po bën?

- Asgjë, - tha Xhuliani. - E kemi me nxitim.

- Me nxitim? Po ti sapo mbërrite. Dhe kur thua ne, për kë e ke fjalën?

- Oh, më fal. Po ju prezantoj. Eshton, kjo është Jozefina; Jozefina, ky është Eshton.

- Gëzohem që të njoh, Eshton, - tha Jozefina duke buzëqeshur pas supit së Xhulianit.

- Edhe unë, gjithashtu.

- Keni një vend fantastik.

- Faleminderit, - ai e vështroi në sy dhe pastaj Xhulianin, i cili zgurdulloi sytë duke lëvizur gojën për të shqiptuar *mjaft*. Të tre kaluan në zonën kryesore, të larë nga drita e diellit dhe me hapësirë.

- Nga i merr gjithë këto gjëra? - pyeti Jozefina teksa ecte nëpër dyqan, duke prekur fustanet dhe shallët prej mëndafshi.

- Andej, këtej, - tha Eshtoni - Kryesisht nga veprimtari të suksesshme. Para se të mbyllin produksionin e një emisioni apo seriali, Xhuliani dhe unë vërtitemi rreth studiove dhe skenave ku bëhen regjistrimet, shënojmë çfarë duam, dhe kur ata përfundojnë, ne kthehemi me kamionin tim.

- Merrni edhe mobiliet?

- Pse, të duhen mobilje? Ndonjë divan? Një *krevat*?

- Jo, thjesht për kuriozitet, - ia ktheu ajo pa iu dridhur qerpiku.

Eshton, mjaft.

- Gjërat më të mëdha i marrim falas, - tha Eshtoni - sepse ato janë të parat që mblidhen për në plehra. Në thelb, ne shesim plehrat e njerëzve të tjerë.

Xhuliani deshi t'i gjuante shokut të tij në kokë.

- Jozefinë, duhet të ikim.

- Mësues, shkrimtar *dhe* pronar i një biznesi të vogël? - i tha Jozefina Xhulianit - Ti po që vendoske shumë kapela në kokë, Xhuls.

- Oh, nuk e ke idenë, - tha Eshtoni duke lëvizur gojën pa folur për t'i thënë *Xhuls*? Xhulianit.

- Nuk jam mësues, - mërmëriti Xhuliani. - Jo në të vërtetë.

- Dhe njerëzit ju paguajnë edhe për gjërat e mëdha? - pyeti ajo.

- Po, në biznesin tonë plehrat janë sende koleksionimi, - u përgjigj Eshtoni. - Kemi një dhomë të tërë ngjitur Shtëpisë së Përhumur me divane dhe tavolina nga serialet *I Dream of Jeannie*, *Bewitched*, *Mork and Mindy*.

- Sa fantastike! A mund t'i shoh? Pas Shtëpisë së Përhumur, sigurisht. Ajo është e para.

- Një herë tjetër, - tha Xhuliani duke u përpjekur ta merrte me vete e të dilnin jashtë. - Ose do të bëhesh vonë. Ishte si të rrihje ujë në havan. Jozefina po studionte objekte skene sikur nuk i interesonte aspak për audicionin.

- Më fal, - i tha Eshtoni, - por a jemi takuar më parë ne?

- Nuk mendoj.

- Unë betohem që të kam parë diku. Unë kurrë nuk e harroj një fytyrë..., - ai trokiti banakun. - Në Nju-Jork! Disa javë më parë. Te *Shpikja e Dashurisë*. A nuk ishte ti dublantja? - pyeti ai dhe iu afrua.

- Po! Uau! Ishte dhe ti aty?

- Po, - u përgjigj Eshtoni. - Isha *dhe* unë aty. Dhe buzëqeshja e tij u zhduk.

- A e shijove?

- Po. Jo aq shumë sa Xhuliani... sigurisht... por e shijova. Ishte jashtë së zakonshmes.

- Por jo e jashtëzakonshme? - Jozefina buzëqeshi miqësisht sikur të mos i interesonte nëse Eshtonit i kishte pëlqyer apo jo shfaqja.

Në heshtje, Eshtoni ia nguli sytë Xhulianit, i cili po firmoste daljen e parukës dhe refuzonte t'i kthente vështrimin e mprehtë shokut të tij.

- Jemi gati për të ikur, Jozefinë? - tha Xhuliani.

Ajo nuk u përgjigj, sytë i kishte ngulur te diçka që varej në mur prapa Xhulianit.

- Çfarë është kjo? - thirri ajo.

Ishte një beretë në ngjyrë të kuqe e errët prej lëkure qengji. Ajo e tërhoqi nga varësja, e ktheu përmbys një a dy herë dhe e vuri në kokë duke shkelur në qendër të dyqanit dhe duke u buzëqeshur të dy djemve.

- Çfarë mendoni, djema?

Njëri u ngërdhesh, tjetri nuk kishte asnjë hije të ngjashme në fytyrën e tij të zymtë. Xhuliani nuk e kuptonte pse Eshtoni po tregohej kaq jomiqësor. Ai i gjuajti Eshtonit me bërryl, që nuk ia ktheu gjuajtjen.

- Kjo qenka shumë e bukur, - tha Jozefina duke vështruar me aprovim në pasqyrë reflektimin e saj. - A është e shtrenjtë?

- Jo, nuk është e shtrenjtë, - tha Eshtoni. - Është e paçmueshme.

Është *Gucci*, e vjetër, por tepër cilësore. Nga vitet dyzet. Por nuk është në shitje. Është e Xhulianit. Është kapela e tij fatsjellëse.

- Me të vërtetë? - Jozefina vështrroi veten në pasqyrën e pjerrët.
- Xhuls, ku e gjete këtë gjë të mrekullueshme?
- Po, *Xhuls*, - tha Eshtoni. - Ku e gjete? Thuaji vajzës.
- Nuk e mbaj mend, - tha Xhuliani.
- Ja tek e ke, - tha Eshtoni. - Nuk i kujtohet. Atëherë si thua? A mund ta marrë ajo beretën që e gjete diku dhe nuk i je ndarë për një dekadë?

As nuk diskutohej.

Jozefina për pak sa nuk kërceu në vend. Me një buzëqeshje mirënjohëse, kokën e zbukuruar me beretë të anuar, gishtërinjtë të përdredhur, ajo bëri një lëvizje dyhapëshe, sikur po kërcente dans, u rrotullua, lëvizi vithet, dhe këndoi disa rreshta nga refreni i “Who’s Got the Pain” nga *Damn Yankees*.

Eshtoni, me sytë blu të errët, i nguli Xhulianit një vështrim të gjatë e të shqetësuar mbushur me dyshim, parehati dhe për këto arsye, me dëshpërim.

- Eja ikim, - tha Xhuliani, duke i marrë çelësat.

Teksa po bëheshin gati të dilnin jashtë, Jozefina i hodhi një sy Xhulianit, këmishës së tij gri me kuadrate, pantallonave ngjyrë kaki, këpucëve të tij të zeza prej kamoshi, xhaketës sportive ngjyrë gri.

- Xhulian, pas audicionit do të shkojmë në mal.
- Po, e ç’do të thuash me këtë?
- E po, që ke veshur përsëri uniformën tënde prej mësuesi jo veshjen për t’iu ngjitur malit.
- Oh, je shumë e lezetshme Jozefinë, që mendon se kjo është uniformë, - tha Eshtoni duke hyrë mes saj dhe Xhulianit. Ai tundi kokën me forcë për të nënvizuar fjalët e tij. - Nuk është uniformë, vajzë e dashur. Është kostum.

FANTAZMAGORI E DYFISHTË

- AI KE TË REHATSHME KËPUCËT TË PAKTËN? - E PYETI Jozefina pas përfundimit të audicionit, kur ndodheshin te parkingu i teatrit “Grek”. - Klithmat e fatkeqësisë e vranë, - tha ajo, - për shkak të beretës së kuqe.

Xhuliani nuk dinte si t’i përgjigjej. Të gjitha këpucët e tij ishin të rehatshme. Rehatinë e kishte merak.

- Kaq larg është vendi ku po më çon?

- Është lart në mal, - i tha ajo dhe e shtyu me gisht. - Mos do të kthehesh?

- Kush tha? Jo, jam i gatshëm. Ndoshta duhej të kishe pyetur Eshtonin. Atij i pëlqen të bëjë këto gjëra.

Jozefina ra në qetësi teksa dielli luante duke i dhënë shkëlqim bimësisë përreth.

- Nuk mendoj se ai do të kishte thënë “po”. Nuk m’u duk dhe aq miqësor. Mendoj se s’më ka qejf.

- Sigurisht që të ka, - Xhuliani u mundua të shmangte bisedën pasi nuk ishte i sigurt çfarë kishte pësuar Eshtoni. - Nuk ishte në terezi. Kur zgjohet herët në mëngjes nuk është vetvetja.

Ata filluan ngjitjen përmes rërës së shkrifët, ku rriteshin dëllinja dhe bredha dhe ku kishte eukalipte me bollëk.

Jozefina ecte përpara tij. Pemët me lule ngjyrë flakë të kuqe bënë çdo gjë të dukej si zjarr. Jargavanët dhe akaciet me fryte që ngjanin si mëndafsh rozë, shpërndanin përreth një aromë si flokë sheqeri dhe e bënin Xhulianin të ndihej sikur ishte në një kopsht të lulëzuar e të ëmbël, plot me pemë të kuqërremta, shelgje shkretëtire dhe pemë me aromë limoni. Ai donte t’i tregonte asaj

hapësirën e ndritshme dhe të çuditshme që i rrethonte, por nëse përgjigjja e saj ishte, “po, sigurisht është një *kopsht*, por ç’lloj kopshti është Xhulian, *Kopshti i Edenit* apo *Kopshti i Getsemanit* në Jerusalem?”.

Çfarë nuk shkonte me të?! *Kopshti i Getsemanit!*

Teksa po mendonte të thoshte diçka më të zgjuar (sinqerisht, *gjithçka* tjetër do të ishte më pak idiote për t’u thënë), i doli një gur përpara dhe ai u pengua. Ajo ecte shumë shpejt. Ai mezi e arrinte, kurse ajo praktikisht dukej sikur vraponte përmes barishteve. Ishte e vështirë të flirtonte teksa ngjiste një kodër të pjerrët në kushte të pabarabarta. Ai u përpoq (jo dhe aq) të mos i mbante sytë te pjesa e pasme e kofshëve të saj lëkurëbuta, të bardha dhe të holla. Vështirimi i tij vazhdonte të shëtiste drejt pjesës së poshtme të shpinës së saj, belit, që ishte i zhveshur. Ai donte ta habiste me njohurinë e tij mbi gjembaçin e uruar dhe Qethjen e Artë, mbi bimët qumështore indiane dhe aromën e përjetshme të bimëve shumëvjeçare, por nuk mund të bënte dy gjëra njëkohësisht, të merrte frymë dhe ta habiste atë.

Ajo u kthye drejt tij, teksa bënte fresk me beretën e kuqe.

- Xhulian Kruz, - tha Jozefina me një rën dorë të vendosur te vithet, - eja, lëviz më shpejt. Kemi më pak se pesëmbëdhjetë minuta kohë.

- Më shpejt? Nuk e dija që kishim afat.

- Gjithmonë ka një afat. Ti duhet ta dish këtë, profesor i buletinit të përditshëm. E di që je rishtar në ecje...

- Nuk jam rishtar në ecje.

- Kemi kohë deri në mesditë, - tha ajo. - Dhe më pas do të ketë ikur.

- Çfarë do të ketë ikur? Dielli? Malet?

- Mendon se je i mençur, por do e shohësh. Nëse e humbasim, kaq ishte. Nesër ti do të kesh një milion gjëra për të bërë dhe unë kam reklamën e *Mountain Dew*. Po, më telefonuan kur isha te teatri “Grek”. Nëse më marrin dhe te shfaqja e Dantes, do të bëhen dy. Nuk e di çfarë po ndodh, - tha ajo. - Asnjëherë nuk kam marrë dy punë njëherësh, - vazhdoi duke vendosur beretën përsëri në kokë.

- Ndoshta unë jam hajmalia jote fatsjellëse, - tha ai. - Kapelë fatsjellëse, Xhuliani fatsjellës.

- Nuk ka kohë për fjalë e muhabet, z. Hajmali... eja, ec më shpejt. Me çizmet e saj ushtarake, ajo u zhduk përpara dhe u kap pas një plepi.

- Nëse e humbasim, mund të vijmë një ditë tjetër, - tha ai që vinte mbrapa saj. - Nuk po them që do e humbasim...

- Do të vazhdojmë të vijmë ditë pas dite ngaqë ti nuk mund të ecësh më shpejt sot? - e pyeti ajo me zë të lartë. - Çfarë të bën të mendosh që do të jesh në gjendje të ecësh më shpejt nesër?

- Shpejt po eci. Pothuajse po vrapoj në një rrugë malore.

- Ajo që po bën quhet vrapim me ritmin tim, - tha Jozefina. - Është një tjetër shprehë për ecje. Ajo vazhdonte ta përqeshte e të murmuriste. - E kam të lehtë ta dalloj që ti punon nga shtëpia. Njerëzit që punojnë nga shtëpia nuk e kanë absolutisht sensin e urgjencës. Ata asnjëherë nuk duhet të jenë në ndonjë vend. Gjithmonë e kanë me nge.

- Nuk po eci me nge, - shfryu Xhuliani, duke dashur t'i thoshte që jo vetëm punonte nga shtëpia, por edhe stërvitej. Ngiste edhe makinën rreth e qark Los Anxhelosit, duke ngarkuar dhe shkarkuar kamionë plot me gjëra të rënda, dhe jepte mësim. Papritur ai donte t'i thoshte çdo gjë.

Kur arritën në majë Jozefina ishte bërë e kuqe flakë në fytyrë.

- Si po shkon, kauboj? A po mbahesh? - buzëqeshi ajo. E vetmja gjë që ai mund të bënte ishte të gulçonte.

- Ku po më çon?

- Për të të treguar një magji.

Duke kaluar përmes ferrave, ata dolën nga shtegu derisa arritën disa bimë të ulëta kauçuku dhe një fik të vetmuar.

Me gojën të hapur dhe duke gulçuar, ajo dukej e lumtur teksa largonte flokët me onde nga balli i qullët.

- Sot do të jetë një ditë e mrekullueshme, e ndiej, - tha ajo. - Shiko sa diell që ka.

Ai mund të shihte. Kishte aq shumë diell sa të verbonte. Ata u rrotulluan 360 gradë për të shijuar pamjen. Disa kilometra më poshtë, Los Anxhelosi ziente. Ata ishin lart në kodër, duke lundruar në ajrin që dridhej, duke fluturuar mbi hapësirat e gjera ku jetonin njerëzit. Oqeani në anën perëndimore ishte nën mjegull,

dhe qendra e Los Anxhelosit, me kullat e larta si kuti shkrepëseje, dukej si një perde tymi. Të gjitha rrugët ku gjendeshin një milion shtëpi të bardha dhe një milion pemë palmash, të çonin në det. Këtu lart, ajri ishte më i lehtë, oksigjeni më i pakët. Ishte koha që shkaktonte gjak nga hundët, koha e zogjve të parajsës dhe e kambanave pëshpëritëse. Flora verore po lulëzonte; mentja e egër dhe gjethet e arta të rrushit pa fara dukeshin më të gjallëruara nën diellin e mesditës. Një e qeshur në buzët e saj dhe një vetëtimë në zemrën e tij. Ai e dinte që në këto kodra kishte magji. E vetmja gjë që dëshironte të bënte në atë moment, ishte ta puthte.

Ajo mbajti frymën, si një zog parajse në vetvete, si një kabanë pëshpëritëse.

- Po qëndrojmë sipër një gabimi të tokës, të quajtur Kanioni i Benediktit, - tha ajo teksa rrëmonte në çantën e saj ku mbante gjithçka, derisa nxori një gur të tejdukshëm varur në një litar të hollë lëkure të papërpunuar. Një tel argjendi ishte thurur dhe mbështjellë rreth gurit si shportë. Ajo e vendosi në pëllëmbë të dorës. Kishte formën e një pike loti të madh me cepa shumëfaqësh të mprehtë, pjesërisht të tejdukshëm, pjesërisht të fshehur.

- Çfarë është ajo? - pyeti ai duke e studiuar pa shprehur ndonjë kuriozitet të tepruar. Por, guri ngacmoi diçka brenda tij, diçka që i zgjoi interes. I shkaktoi një emocion të papërcaktueshëm. Ai ndjeu një dridhje elektrike t'i përshkonte trupin teksa e vështronte. Dridhja nuk ishte tërësisht e këndshme.

- Një kristal kuarci, - tha Jozefina duke ngritur krahun drejt qiellit. Kristali shndriu nën dritën e diellit.

- Nuk është diamant? - ia ktheu Xhuliani duke buzëqeshur.

- Ha-ha. Jo. E kam çuar për vlerësim, më beso, - ajo largoi flokët që i binin në fytyrë. - Këtë ma ka dhënë gjyshja ime dhe i përkiste një kushërire atje në vendin e origjinës së saj.

- Ku?

- Nuk jam e sigurt. Afër *Blackpool*-it, ndoshta. Ose në Skoci.

A thua se të dyja ishin të këmbyeshme. Ata ecën pak më larg derisa arritën te një pllajë, që ngjante si një vend sekret, rrethuar nga shkëmbinj të ekspozuar në lartësinë e gjoksit, si një rrethim i gurtë.

- Xhuls, ti po qëndron në një shpellë kuarci.

- A dua të qëndroj në një shpellë kuarci?

- Aha, Zoti Di Gjithçka, nuk i di të gjitha. Po, në momente të caktuara të ditës, kuarci vezullon si pluhur diamanti. Nëse je me fat, mund ta gjesh veten brenda një ylberi.

Cili burrë nuk do ta quante veten me fat të qëndronte pranë një bukurie të tillë si e saja, duke folur me kaq entuziazëm mbi pluhurin magjik të diamanteve brenda një ylberi? Ai kishte ngrirë në vend, duke marrë frymë me vështirësi, duke dëgjuar gjithë interes, i çuditur, i hapur ndaj saj dhe ndaj çdo gjëje.

Sytë e tyre rrihnin midis kristalit në dorën e saj dhe njëri-tjetrit, ndërsa kodrat e shkretuara me rërë ndodheshin nën këmbët e tyre. Konturet e Beverly Hills-it dhe të Century City-t shkëlqenin në luginë dhe më larg në perëndim, dallohej gryka e zhurmshe e Paqësorit. Fytyra e saj e kuqe flakë ishte kaq afër tij, sa e vetmja gjë që duhej të bënte Xhuliani ishte të hidhte një gjysmë hapi përpara dhe të puthte buzët e saj të hapura. Koka e tij u anua anash me ngadalë.

- Sa kohë kemi deri në mesditë? - pyeti ajo.

Ai bëri prapa që të kontrollonte orën e tij të dorës të markës *Tag Heuer*. - Një minutë.

- Mrekulli. - Pëllëmba e saj ishte e drejtuar për lart. - Nëse mund të mendosh tekta je në këmbë, mund të shprehësh një dëshirë. Në mesditë, për një moment të shkurtër, yjet dhe toka dhe i gjithë universi do të radhiten në mënyrë kaq perfekte saqë çdo dëshirë e shprehur me besim, mund të plotësohet.

Ishte e qartë që Xhuliani nuk mendonte aq mirë në këmbë, përndryshe tani do të ishte duke e puthur.

- Pse po e mban kristalin ashtu?

- Po mundohem të kap diellin me të.

- Je një kapëse dielli, - tha ai duke e vështruar në sy.

- Jam një kapëse dëshirash, - belbëzoi ajo. - Rreth nesh janë shkëmbinjtë më të vjetër të Santa Monica-s. Dyzet milionë vjeçarë. Ti po qëndron brenda një shkëmbi të vjetër sa koha. Mund të prekësh kohën me duart e tua, - tha ajo dhe mori frymë. - Dëshiron të prekësh kohën me duart e tua, Xhulian?

Dua të të prek ty me duart e mia, mendoi ai. Dëshira e tij duhej të ishte e dukshme në sytë e tij. Ajo u skuq.

- Çfarë i ndodh kristalit kur e rreh dielli? - pyeti ai. - Nxehet?

- Xhulian, të kam sjellë lart në mal, - tha ajo, - dhe nuk është momenti për t'u treguar cinik. Po qëndrojmë brenda një vullkani. Shtretërit e lumenjve poshtë nesh janë tharë, toka që këtej duket e sertë dhe shpeshherë mizore, madje edhe e pamëshirshme ndaj dobësive.

- Këtë gjë e di shumë mirë, - tha ai.

- Njeriu, pavarësisht zjarrit dhe kaosit të tij, mezi i ka prekur këto kodra.

Disi i turpëruar Xhuliani mendoi se mund të kuptosh shumë nga mënyra si kishte zgjedhur të jetonte pa dëshirë në vendin e palmave dhe të verës, duke fluturuar në një dekadë të jetës së tij të qetë, në të cilën ai mezi kishte bërë një ndryshim.

- Kjo është ajo që do të bësh, Xhulian Kruz? - pyeti Jozefina. - Të bartesh i paplotësuar në varr?

Jo më.

- Të gjitha ngjyrat e botës janë gati për t'u zhdukur, - pëshpëriti vajza fluturake.

Një shkrepje e ndritshme ia preu fjalën Xhulianit. Dielli arriti zenitin. Rrezet goditën gurin e kthjellët në duart e saj. Drita ndriçoi dhe u shpërnda përmes prizmit, shkëndija zjarri kërcyen nga kuarci shndritës i shpellës. Një moment më parë, Xhuliani dhe Jozefina gjendeshin midis ngjyrës jeshile dhe të zezë. Tani po kërcenin brenda një kaleidoskopi lejla dhe të verdhë, një fantazmagori ngjyrash, një aurorë elektrike e pandalshme. Kodrat u zhdukën, edhe pemët gjithashtu, edhe lugina poshtë, edhe qielli. Asgjë nuk dëgjohej më. Asgjë *tjetër* nuk dëgjohej më. Xhuliani mezi arriti ta shihte, edhe pse ajo i qëndronte ngjitur. Sa hap e mbyll sytë dukej sikur ajo ishte zhdukur, ishte shpërndarë në një milion copëza lëvizëse të kuqërremta. Në një frymëmarrje, e kuqja verbuese zbardhi bebet e syve të tij dhe ajo nuk ishte më.

Ai kapsiti sytë, ajo nuk dukej më.

Në reflektimin e botës së zhdukur, me flakën që shpërthente në sytë e tij, Xhuliani nuk mund të thoshte se çfarë *kishte parë*, por e

ndiente se diçka e fuqishme e kishte lënë pa frymë. Ndjeu dashuri dhe dhimbje që e bënë të përkulej në mes, ndjeu frikë dërrmuese, mall të dëshpëruar dhe pendim të thellë. Ai ndjeu tmerr. Ndjeu vuajtje të thellë. Ndjeu kaq dhimbje saqë rënkoi.

Duke marrë frymë me vështirësi, ai kapsiti përsëri sytë dhe ajo ishte aty, ishte rikthyer tek ai, me kristalin në duart e saj, dhe rrezet e ndritshme të tij dukej sikur kërcenin rreth saj.

Kur ai arriti të merrte frymë, pesha brenda tij u zhvendos. Nuk u ngrit lart. U zhvendos.

Dielli lëvizi çerek grade. Ngjyrat u zbehën. Bota u rikthye ashtu siç ishte.

Pothuajse.

Presioni në gjoks mbeti aty, si nxehtësi e madhe shkaktuar nga një grusht në zemër.

Nuk mund të fliste. Lentja përmes së cilës shihte botën ishte deformuar, kishte humbur fokusin në qendrën e saj.

Jozefina i kapi dorën. - Të thashë, - tha ajo, duke e shtrënguar dhe liruar.

- Çfarë *ishte* kjo? Ishte sikur zgjoheshe nga një makth. Për një moment nuk e dije se ku ndodheshe. - Xhuliani ende nuk e dinte se ku ndodhej.

- Çfarë dëshire shprehe? - pyeti ajo.

- Nuk bëhet fjalë për dëshirën, bëhet fjalë për çka pashë.

- Çfarë pe?

Xhuliani nuk e dinte. Nuk ishte i sigurt. Diçka që nuk donte të shihte. Ai ia nguli sytë i magjepsur, por i pavendosur.

Jozefina e hodhi gurin në çantë. - Ndonjëherë, - tha ajo me një nuancë melankolie në zërin e saj, - kur vij këtu, nuk di çfarë të kërkoj se nuk di çfarë dua. Dua aq shumë të besoj se çdo gjë është para meje, dhe shpreh një dëshirë për një arritje, ose një rol që vjen njëherë në jetë, për vlerësime, për duartrokitje. Por, ndonjëherë më duket sikur çdo gjë është mbrapa meje.

- Nuk është, - tha Xhuliani i sigurt për një arsye. - Çdo gjë është akoma përpara.

- Shpresoj të kesh të drejtë, - tha ajo. - Dëshira ime më e madhe nuk është realizuar akoma. Dua të jem në Londër, në skenën e “West End”.

- Pse në Londër? - tha ai. - Aty bie shi gjithë kohës. Edhe Nju-Jorku ka teatro të mrekullueshëm.

Ajo buzëqeshi me mall, duke imagjinuar të ardhmen e saj perfekte.

- Ne dëshirojmë atë që nuk kemi, - tha ajo. - Dua të shiten të gjitha biletat e “Savoy”-t legjendar prej meje. - Ajo lëvizi dorën përmes ajrit. - Dua të shoh emrin tim sipër tabelës - Jozefina Kollins sonte në “Savoy”!

- Unë nuk kam qenë kurrë në Londër, - tha ai, - po ti?

- Vetëm në ëndrrat e mia.

Ajo vuri dorën në gjoks.

Zemra po i dhembte ende.

- E di që njeriu që ndërtoi “Savoy”-n, ndërtoi gjithashtu teatrin më të bukur në botë? - tha ajo. - “The Palace” në Cambridge Circus.

- Nuk e dija këtë.

Ajo pohoi me kokë.

- Ai e donte aq shumë gruan e tij, sa i ndërtoi një teatër që ajo të ndiqte operan sa herë që të dëshironte. Imagjinoje pak. Teatri “The Palace” është dashuria e një burri për gruan e tij kthyer në realitet, - vazhdoi ajo duke buzëqeshur.

- Si ka mundësi që i di të gjitha këto?

- Sepse e adhuroj këtë histori, se sa shumë e adhuronte ai burrë gruan e tij, - tha Jozefina. - Si *nuk* i di ti të gjitha këto?

Me gjysmë zemre ata filluan të zbrisnin të tatëpjetën.

- Çfarë dëshire shprehe? - pyeti ai.

- Sot kërkoja të jem në *Paradise in the Park* në mënyrë që të rri në Los Anxhelos, - iu përgjigj ajo. - Po ti?

- Edhe unë, - tha Xhuliani.

KAFENEJA GRIDDLE

- ÇFARË DO TË BËSH TANI?

- Po *ti* çfarë do të bësh tani?

- Po vdes urie.

- Di tamam vendin e duhur.

Disa orë më vonë, ata po rrinin ende ulur përballë njëri-tjetrit në kafënë *Griddle*, që ndodhej në bulevardin “Sunset”, në një tavolinë katrore në trotuar, në mes të vapës, me makinat që kalonin pranë tyre vetëtimthi. Xhuliani u gjallërua sapo hëngri. Ato momente që kaloi me të atje lart në majë të malit kishin diçka si të mjegullt dhe surreale, përzier me emocione tronditëse dhe të pashpjegueshme.

I telefonuan organizatorët e shfaqjes së Dantes dhe i thanë se nëse dëshironte roli i treguesit, ishte i saji. A mund t’ia dërgonin kontratat agjentit të saj? A mund të fillonte provat pasnesër? Gjërat po merrnin rrugën e duhur dhe ajo nuk po e hiqte më beretën.

- Por a e di se çfarë më tha producenti edhe në momentin që po më ofronte punën? - tha Jozefina. - Pse u vonove kaq shumë për të ardhur këtej, zonjusha Kollins? - Ajo trazoi kafën.

- Të dëgjova t’i thoshe që je njëzet e tetë vjeçe.

- Dhe ai tha *saktë* dhe e mbylli.

Xhuliani qeshi dhe filloi t’i tregonte: - Muajin e kaluar Eshtoni po fliste me dikë në telefon në përpjekje për të filluar një punë në rrjetin televiziv CBS dhe producenti e pyeti se sa vjeç ishte. Eshtoni iu përgjigj se ishte tridhjetë e dy, dhe producenti i tha: “A dukesh si tridhjetë e dy?”, Eshtoni i tha: “A duhet të dukem më i ri se tridhjetë e dy për një punë në serialin e një komedie të anuluar?”.

Jozefina tundi kokën. - Të gjithë po kërkojnë rininë e përjetshme. Sidomos në këtë qytet.

- Një diçka të përjetshme ndoshta.

- Pra, a është djalë i mirë shoku yt? - pyeti ajo. - Më thuaj të vërtetën tani. Edhe pse është tip i sertë dhe tridhjetë e dy vjeç, si thua a ta prezantojmë me Zakijan time? Të shohim se çfarë mund të ndodhë?

- Dakord, kukull, qetësohu, - tha Xhuliani - Ai nuk është i sertë, dhe për më tepër është i zënë.

- I zënë, i pazënë. Sa tërheqëse është e dashura e tij?

Xhuliani nxori celularin dhe i tregoi Railin.

Jozefina veproi sikur nuk i bëri përshtypje.

- Ajo ka qenë miss “Brooklyn”! - tha Jozefina.

- Raili është votuar si vajza më e bukur në gjimnaz.

- Nuk më dëgjove kur të thashë që Zakija ka qenë miss “Brooklyn”?

- Eshtoni nuk merret me mbretëresha bukurie.

- *Me sa duket*, - tha Jozefina dhe të dy qeshën. - A ka lidhje Raili me fushën e aktrimit?

- Eshtoni gjithashtu nuk merret me aktore. Është zhgënjyer disa herë dhe tani thotë që nuk mund t’u besosh.

- Me të vërtetë e thotë këtë? - pyeti ajo duke pulitur sytë. - Po *ti* si mendon?

- Nuk e di, - iu përgjigj Xhuliani duke pulitur sytë edhe ai. - Nuk jam lidhur ndonjëherë me një aktore.

Ajo heshti dhe vazhdoi të shihte foton e Railit. - A të pëlqen? - pyeti ajo.

- Më pëlqen shumë, pse? Jemi shokë shumë të mirë, - tha Xhuliani - Ajo është tip i këndshëm dhe urren ta ngacmojnë.

- Dhe kjo të bën ta ngacmosh akoma më shumë?

- Natyrisht, - tha Xhuliani, - Çdo takim me të është një moment kulminant argëtimi. Disa herë, për të më ndihmuar të pastroj shpirtin dhe të radhis çakrat e mia, ajo më thotë të ha letër. Ai nuk mund ta fshihte dashurinë e tij të çiltër për Railin. - Për të pastruar veten e saj nga papastërtitë, ajo ha në mënyrë të alternuar. Në ditët B, pi vetëm ujë me limon, të aromatizuar me shurup panje, dhe më

thotë të shkruaj në buletin tim se shurupi i panjës është ushqimi i përkryer dhe unë i them po, sidomos mbi petulla.

Jozefinës i doli lëngu i luleshtrydheve nga hundët teksa e thithte me pipëz.

Ata mbaruan petullat e tyre *red velvet* me krem djathi të ngrirë dhe me bërrylat të vendosur mbi tavolinë, thithën me pipëz lëngun që u kishte mbetur në gotë. Tavolinat përreth tyre ishin bosh, vetëm ata kishin ngelur aty.

Biseduan për shfaqjet ku ajo kish marrë pjesë (*Danny Shapiro and his Quest for a Mystery Princess*, që ishte e preferuara e Xhulianit). Folën për librat e tyre të preferuar (*The Fight*, libri i tij, *Gone with the Wind*, i saj), lëndët që u pëlqenin në shkollë, ushqimet që i bënë të ndiheshin mirë, për pishinat, dhe më pas filluan të ziheshin për skuadrat e bejsbollit, *Yankees* dhe *Dodgers*. (“Ti jeton këtu, - tha ajo, - kështu që *duhet* të suportosh *Dodgers*, por ti e di thellë-thellë që ata janë kot, apo jo?”). Pas gjysmë ore, diskutimi u qetësua pa u zgjidhur. (“Çfarë, ndihesh i ofenduar?, - tha ajo. - Nuk më surprizon, edhe unë do të isha e inatosur nëse do të isha fanse e *Dodgers*.”)

Ata i treguan njëri-tjetrit edhe historinë e jetës së tyre. Ajo kishte lindur dhe ishte rritur në “Brooklyn”, afër urës “Verrazano”, ishullit Coney dhe gjirit të Ridges, një komunitet i vogël i mbipopulluar i klasës punëtore, aq i mënjanuar nga pjesa tjetër e botës saqë ajo nuk kishte shkelur në Nju-Jork derisa mbushi dhjetë vjeçe. Ajo mendonte se Luna Park në ishullin Coney ishte njësoj si në të gjitha plazhet e tjera, dhe koncepti për Nju-Xhersin ishte i lidhur vetëm me hartën, dhe ishte një vend mitik përtej ishullit Staten.

- *Nju-Xhersi* është vend mitik? - pyeti Xhuliani.

Babai i saj menaxhonte një trupë të quajtur “Sideshow by the Seashore”, që organizonte shfaqje estrade dhe ajo punonte me të derisa ai vdiq dhe biznesi kaloi në duar të tjera. Motra e saj më e vogël vdiq disa vite më vonë prej leucemisë. Për ta bërë motrën e saj të ndihej më mirë, Jozefina këndonte dhe i binte pianos, ndërsa e motra kërcente nën ritmin e këngës. Ajo tha se që atëherë, kjo ishte mënyra se si i shihte të gjithë fëmijët në imazhin e vajzave të dobëta duke kërcyer. Duke vdekur, po duke kërcyer.

Jozefina kishte një marrëdhënie të ngushtë, por kontradiktore me mamanë e saj, dhe vitet e fundit, jo dhe aq të ngushtë, por më kontradiktore. Mamaja e saj punonte në një kolegji privat afër shtëpisë së tyre dhe e mbajti punën për dy dekada në mënyrë që vajza e saj të mund të shkonte në një shkollë private elitare falas. Ajo donte që vajza e saj të studionte në universitetin e “Columbia”-s, të bëhej profesoreshë, doktore shkencash, por Jozefina kishte ide të tjera. U pranua menjëherë në shkollën e arteve skenike dhe u ndje e shfajësuar... për dy sekonda. Më pas, e kuptoi që ishte në një shkollë me pesëqind nxënës po aq të talentuar sa ajo. Gjithmonë ishte dikush tjetër që kërcente më mirë, këndonte më mirë, recitonte me zë më të fortë. Aktrimi ishte një lojë e humbur, sidomos në skenë. Në shkollë të mesme ajo kishte qenë e pamposhtura Molly Brown, ylli i çdo shfaqjeje, por në Fakultetin e Arteve Skenike mezi ia dilte të zinte vendin e dytë. Pas diplomimit, ishte edhe më keq. Ajo nuk u pranua në Konservatorin e Arteve Skenike “Juilliard” të Nju-Jorkut, por tani konkurronte për role me çdokënd që kishte shkuar në “Juilliard”.

Ajo gjeti një vend pune stabël ku ndërtonte sete skenike në teatrin publik, ndërkohë që vazhdonte të shkonte në audicione. Fakti që ajo nuk mori një diplomë universiteti siç donte ajo, ishte zhgënjimi më i madh i jetës së mamasë së saj, dhe Xhuliani që dinte diçka mbi mamatë dhe etërit e zhgënjyer, donte të pyeste, nëse i kushtoi edhe më shumë se vdekja e njëjës prej vajzave të saj, por nuk e bëri.

Xhuliani zbuloi historinë e jetës së tij. Ai ishte rritur në një familje punëtore të shtresës së mesme në periferi të luginës Simi, i katërti nga gjashtë djemtë e dy mësuesve: Brandën Kruz, një meksikan i gjeneratës së tretë dhe Xhoanë Osment, një norvegjeze e gjeneratës së tretë.

Fëmijët: Brandën Jr. dhe Roan, ndjekur nga Harlan, Xhulian, Tristën... lindur çdo dhjetë muaj, dhe më pas Daltoni, lindur dhjetë vite më vonë. Prindërit e tij jetonin akoma në shtëpinë e tyre të parë, të blerë pasi kishin mbaruar universitetin. Mamaja e tij rriti gjashtë fëmijë në atë shtëpi, ndërkohë që drejtonte departamentin e informacionit dhe ankesave të gjimnazit, e pandalshme “si një

vikinge”. Babai i tij kishte qenë drejtori i administratës së shkollave publike dhe tani ishte president i një kolegji vendor. Kur ishte fëmijë, Xhuliani lexonte dhe ndiqte sporte të ndryshme. Ai studioi në Universitetin e “Kalifornisë” në Los Anxhelos, UCLA. Eshtoni ishte personi me të cilin ndante dhomën në vitin e parë. Ata ishin shokë që atëherë.

- Vetëm kaq? - tha ajo.

- Pak a shumë, - tha ai.

- Që nga mbarimi i universitetit e deri sot? E di që nuk je njëzet vjeç. Po për çfarë u diplomove?

Kur ai nuk u përgjigj menjëherë, Jozefina qeshi. - Vë bast që për anglisht.

- Prindërit e mi më paguanin qiranë e dhomës dhe shkollën, çfarë supozohej se duhej të bëja?

- Të diplomoheshe në anglisht dhe të bëheshe mësues sigurisht.

- A jam një mësues?

- Po... në thellësi të zemrës sate, Xhulian, vë bast që je.

- Më beso Jozefina, se në thellësi të zemrës sime, gjëja e fundit që mund të jem, është të jem mësues.

Xhuliani i hodhi një sy vajzës së shkretë me sy të vegjël të rrumbullakët, një imazh me flokë të gjatë që tundeshin, provokuese, me një buzëqeshje të vazhdueshme. Ishte vapë dhe teksa bisedonin dhe ajo rrotullonte pipëzën në fund të gotës, ai mendohej nëse ishte shumë herët për t’i kërkuar që të shkonin në plazhin Zuma. Ishte rrugë e gjatë deri në Malibu, por ia vlente, se dielli do të perëndonte teksa ata notonin. Ishte një breg i veçuar dhe në kulm të baticës, dallgët përplaseshin në mënyrë hipnotizuese në breg. Shumë shpejt?

A ishte shumë shpejt ta ftonte në apartamentin e tij, disa blloqe banimi më larg, dhe të shihnin Marlon Brandon, kur sillte apokalipsin në Vietnam? A ishte shumë shpejt për një shëtitje piktoreske me makinë në rrugën “Mulholland”? Të shihnin një komedi në “Klubin Cellar”? Të hanin një darkë te *Scarpetta*? Të pinin një çaj në divanin e tij? Të bënin një shëtitje në dyqanin e bizhuterive? A ishte shumë shpejt të vendoste buzët e tij në qafën e saj prej alabastri, o Zot, çfarë nuk ishte shumë shpejt.

- Edhe superheronjtë kanë nevojë për ndihmës besnikë dhe të qëndrueshëm, - e dëgjoji ai të thoshte. Fjala *superheronjtë* e ktheu prapa në bulevardin “Sunset” dhe tavolinën e tyre të vogël katrore.

- Sipas këndvështrimit tënd, çfarë jam unë? - pyeti Xhuliani. - Superheroi apo ndihmësi?

- Ndoshta ti je superheroi dhe *unë* jam ndihmësja jote.

- Ose ti je superheroi dhe unë jam ndihmësi yt.

Buza i vajti vesh më vesh. - Vë bast që Eshtoni ka të drejtë për ty. Ti je superheroi që hiqet sikur është ndihmësi në mënyrë që asnjë të mos vërë re fuqitë e tij.

- Kur e tha Eshtoni këtë, dhe çfarë fuqish mund të ishin këto?

- *Ti* më thuaj, Xhulian Osment Kruz.

Ai i nguli sytë te fytyra e saj e gjallëruar, duke u përpjekur të fshihte prej saj jo forcën, por dobësitë e tij. Ajo ishte kaq e freskët dhe zbavitëse, me buzë të kuqe dhe e hirshme. Ai e pëlqente faktin që për ta dëgjuar, për të dëgjuar çdo tingull që buronte nga goja e saj, ai duhej të përkulej pothuajse përtej tryezës. I pëlqente që çdo frymëmarrje e saj e tërhiqte më afër tij. Ai i dashuronte thonjtë e saj të pastër të palyer me manikyr, gishtërinjtë e saj të gjatë të pazbukuar me unaza. Ai donte t’i prekte. Dontë t’i puthte.

Ajo ishte një dëgjuese e mrekullueshme. Kishte një të qeshur të mahnitshme. A ishte e tmerrshme nga ana e tij që donte t’i bënte gjëra të tjera, të cilat e dinte se do ta mrekullonin, t’i bënte përshtypje me disa aftësi të tjera përveç shakave dhe gjetjes së ushqimit të mirë në L. A? Çfarë shtaze që ishte. Duke bërë një vajzë të qeshte teksa fantazonte forma të tjera dashurie. Duke dëshiruar t’i jepte kënaqësi në të gjitha mënyrat, fizike dhe metafizike. Dëshira ishte e fortë dhe nuk mund të bëhej pazar me të. Epshi dhe butësia vërtiteshin rreth enës zjarrduruese të shpirtit të tij, dhe nxehtësia e madhe e saj e la pa gojë. Aty, në kafenenë “Griddle”!

Ai ia nguli sytë për një kohë të gjatë gishtërinjve të saj të hollë, dhe nga hijet e pemëve në bulevardin “Sunset” që binin mbi to, iu duk sikur pa një shenjë të bardhë rrethore në gishtin e saj të katërt. Ai kapsiti sytë. Jo, aty nuk kishte asgjë përveç një hileje drite.

- Kush *je* ti, Jozefinë? - mermëriti ai. - Dua të të njoh. Kam nevojë të di cila je. Unë jam këtu. Do të dish kush jam unë? - Ai u mat të zgjatej e të kapte dorën e saj përtej tavolinës.

Ajo mori frymë... dhe ai donte t'i thoshte se ajo frymëmarrje e saj e joshte, por ajo ishte mënyra e vetme që ajo dinte... dhe e keqkuptoi. Ai donte diçka të vërtetë, ajo i ushqente fantazinë.

- Ndoshta jam mistike? - tha ajo.

I lumtur, ai pohoi. - Po, ti je *mistike*.

- Po, - tha ajo, me një zë jo aq të lumtur. - Unë jam vajza blu dhe trupi im është një ekran jeshil. Unë zhdukem kur kam nevojë dhe rishfaqem si dikush tjetër në një qytet tjetër, jo në këtë, dhe jo në timin.

Xhuliani ishte gati të vazhdonte të fliste për këtë ngjashmëri, por kamerierja e bezdisur hipiste u tha se lokali ishte mbyllur, “para dyzet minutash”, dhe nëse *mund* të paguanin faturën, sepse e kishte mbaruar turnin “para dyzet minutash”. Xhuliani i hodhi një sy orës së dorës. Kishte kaluar nga katra! - Çfarë i bën ti kohës, - pëshpëriti ai duke nxjerrë portofolin.

- Çfarë i bëj *unë* kohës? - tha ajo. - Por nuk është edhe aq herët sa të fillojmë të mendojmë për darkën.

- Ke të drejtë. Jam shumë i uritur.

Ata ndodheshin pranë farmacisë *Rite Aid*. Trafiku në bulevardin “Sunset” ishte i rënduar në atë orë. Përballë tyre, lart në një kodër, ndodhej restoranti legjendar *Chateau Marmont*. Të dy ia ngulën sytë me mall.

- Ku mund të shkojmë? - pyeti ajo. - Për darkë, e kam fjalën.

Ai i hodhi një sy pantallonave të saj të shkurtra, çizmeve të saj.

- Çfarë ke? Mendon se veshja ime nuk është e përshtatshme për të darkuar te *Marmont*? - pyeti ajo dhe i hodhi flokët anash. - Po bëj shaka, nuk dua të ha aty. Xhon Belushi hëngri aty dhe shih çfarë i ndodhi.

- Gjithsesi...

- Nuk është se ndodh gjithmonë, - tha ajo, - por ta mendojmë se ku tjetër mund të shkojmë meqë nuk jam e veshur shumë mirë?

- Shkojmë në plazh? - tha ai. - Restorantet atje janë shumë të thjeshta.

A nuk ishte shumë vonë për një zhytje në det dhe për të shijuar perëndimin në Malibu?

- Mirë më tingëllon ky propozim, - tha ajo me sy të perënduar.
- Po ndonjë vend tjetër?

Ai u mendua. - Mund të shkojmë në Santa Monica. Ta blejmë ushqimin në ndonjë kantinë dhe e hamë në mol.

- Po, mundemi, - tha ajo. - Ose mund të shkojmë të shohim një lojë të *Dodgers*. A do të të pëlqente kjo? - i tha ajo dhe i shkeli syrin.

Ai e mbajti veten. - *Dodgers* nuk luajnë këtu këtë javë.

- Me siguri po rrihen në Nju-Jork, - tha ajo. - Ndonjë vend tjetër?

- Do të shkojmë në kinema?

- Sigurisht, - ajo psherëtiu duke shprehur njëfarë acarimi. - Ose... mund të shkojmë në shtëpinë tënde, Xhulian. A nuk the që jeton diku këtu afër?

- Në shtëpinë time? - përsëriti Xhuliani si me budallallëk. - Por nuk kam asgjë për të ngrënë në shtëpi.

Ajo qeshi. - Dëgjo, - i tha ajo - Shkojmë te *Gelson* dhe blejmë ndonjë biftek. Ke ballkon? Po skarë?

Ai nuk dinte çfarë të thoshte.

I tha, mirë, shkojmë. Ai kishte ballkon, kishte dhe skarë.

- Nuk kam pse vij nëse ti nuk do, - tha ajo.

- Jo, jo. Që të dy e dimë se dua... të vish.

- Nuk e besoj dot që m'u desh të vetëftohesha, - ajo tha me një tundje koke teksa prisnin të ndizej drita jeshile në semaforin e kryqëzimit të bulevardit "Sunset" me "La Cienega"-n.

Ai i kishte kapur bërrylin, që të mos e lejonte ta kalonte rrugën pa u ndezur jeshilja.

- Thjesht nuk e di nëse je gjithmonë kaq xhentil, Xhuls?

Vështrimet e tyre u ndeshën.

- Jo, - tha Xhuliani.

Ata ia ngulën sytë fytyrave të çelura të njëri-tjetrit. Ai rrëshqiti krahun në pjesën e poshtme të kurrizit të saj, duke prekur cohën e tejudkshme të bluzës së bardhë, dhe ndjeu në gishtërinjtë e tij ngrohtësinë e lëkurës. Ai e tërhoqi. Gjijnjtë e saj ishin mbështetur në kraharorin e tij.

Para se semafori të bëhej jeshil, ai e uthi. Tashmë nuk kishte nevojë për plazhin e Zumës apo perëndimin e diellit. I mjaftoi thjesht një dritë e kuqe në kryqëzim, pëllëmba e tij në kurrizin e saj, koka e tij e anuar, krahët e saj të hapur.

- Mos po lëvizim shumë shpejt, - pyeti ajo duke marrë frymë. - Kam frikë se po.

- Absolutisht. Si meteor.

Krahët e saj u mbështollën rreth qafës së tij. - Ndoshta duhet të shkojmë për darkë diku, të shkojmë në ndonjë bar, të pimë diçka, të presim natën...

- Jozefinë, - tha Xhuliani, dhe duart e tij shëtisnin poshtë e lart në kurrizin e saj, buzët e tij këmbëngulëse në qafën e saj pulsuese e të ngrohtë, me aromë pjeshke, - nëse dëshiron pak magji, ke ardhur në qytetin e duhur. Mund të bëjmë çdo gjë që të duket si Hollivud këtu, edhe gjatë ditës. Ne dimë si ta bëjmë Hollivudin shumë mirë. Eja me mua dhe do të të tregoj. Në L. A., e quajmë *ditën për natë*.

Ata ngecën në vend dhe harruan të kalonin rrugën. Semafori ndryshoi ngjyrë, përsëri dhe përsëri.



Nga Redaksia e

Zotit Di Gjithçka

Volumi 11, Numër 215



Duende

Fjala për të cilën nuk ka ekuivalente në gjuhën angleze.

Është një fjalë romantike që do të thotë magjike, apo magjepsëse.

Diçka radikale e papërcaktueshme që ka aftësi të mbinatyrshme për të ngjallur pasion, një dridhje shpirtërore.

Diçka e paarsyeshme dhe e mrekullueshme njëkohësisht, dhe gati e dhimbshme që ju dërgon të dridhura në shtyllën kurrizore, një fuqi flakëdhënëse për të prekur thellësisht një genie tjetër njerëzore.

Pothuajse si feja.

Të gjitha këngët e mëdha duhet të kenë Duende.

- “Something”
- “We Found Love”
- “When a Man Loves a Woman”
- “All of Me”
- “Everything I Do, I Do it for You”
- “Lovin’ You”
- “Crazy Love”
- “Dang”
- “God Only Knows”
- “For Crying Out Loud”
- “I Will Always Love You”
- “Lovesong”
- “I Will”
- “Always”
- “Love”
- “You”

Të gjitha historitë e mëdha të dashurisë duhet të kenë Duende.

DUENDE¹

LOS ANXHELOSI, QYTETI I ENGJËJVE, QYTETI I ËNDRRAVE.

Është e thjeshtë të biesh në dashuri, kur ndodhesh në Kaliforninë e Jugut.

Nëse është kaq e thjeshtë, pëshpërit vajza e mrekullueshme, e zhveshur mrekullisht në krevatin tënd, atëherë ke rënë në dashuri një mijë herë para meje?

Prova e dytë: Është e thjeshtë të biesh në dashuri në Kaliforninë e Jugut me të.

Asaj i pëlqen apartamenti yt. Ti e mban të pastër. E pastrove, pyet ajo, ngaqë mendove se mund të vija? Dhe ti do t'i thuash të vërtetën, që e mban të pastër, sepse është në natyrën tënde, por në atë moment i thua të vërtetën romantike. Po, i thua. Shpresoja që do të vije. Për ty e pastrova.

Ke kaq shumë libra, thotë ajo duke tundur kokën në mënyrë pohuese, teksa qëndron para faqes së murit mbushur me libra dhe thesit të zi e të rëndë, varur te një grep në tavan. Pse e ke këtë thes gjuajtjeje, Xhulian? Është për stërvitje?

Po.

Të lumtë. Për librat, e kam fjalën. John Waters do të ishte krenar për ty. Krenare për mua, më saktë.

Kush?

John Waters. Ajo heq rrobat e saj, ti heq rrobat e tua.

¹ Duende është një term spanjoll për një gjendje të rritur emocioni, shprehjeje dhe autenticiteti, shpesh i lidhur me flamenkon. Duke u mbështetur në përdorimin popullor dhe folklorin spanjoll, Federico García Lorca zhvilloi së pari estetikën e Duende-s në një leksion që mbajti në Buenos Aires në 1933, "Juego y teoría del duende" ("Loja dhe teoria e Duende"-s).

Çfarë thotë John Waters? Sikur të intereson të flasësh për të. Ajo është kaq e bukur. Dora jote shëtiti mbi trupin e saj.

Ai thotë, nëse shkon në shtëpinë e dikujt dhe nuk ka libra, mos fli me të.

Ah. *Tani* të intereson.

Zemra jote reformohet rreth Afërditës në krevatin tënd, bijës së zotit të diellit, e zhveshur lakuriq dhe duke pulsuar, me krahët e saj të hapur, gjithçka të hapur, dhe ajo rënkon e të thërret të vish më afër, më afër.

Ti bie në grykën e një vullkani, brenda një hapësire që nuk ka as brenda as jashtë. Ti fundosesh në botën ngjyrë rozë, të tejngopur, ku nuk ekziston asgjë tjetër përveç teje dhe asaj.

Ti puth kyçet e saj, gojën e saj të etur, mbështetesh mbi lëkurën e butë e të freskët të trupit të saj. Buzët e saj janë si vanilje. Ajo është e ëmbël mjaltë dhe e lehtë kudo si pambuk sheqeri ngjyrë rozë. Dhe je ti ai që ndihesh si sheqer, dhe kur ajo të vendos në gjuhë, ti shkrin.

Ti mbyll perdet për të errësuar dhomën dhe i shtie shampanjë me aromë pjeshke në gotë. Tani ajo ka një pije të vërtetë dhe nuk ekziston më dita, por vetëm nata e pafundme.

Trupi i saj është i bukur, i etur për dashuri, për përkujdesje, për përkëdhelje. Ajo është një akrobate, rrotullohet dhe lakohet si një krijesë e pavdekshme. Ti je kthyer brenda vetes. Ajo mund të shohë zemrën tënde, dallohet nga buzëqeshja e saj. Dhe ti mund të shohësh zemrën e saj, që rreh për ty ndërmjet gjinjve të saj.

Pas kryerjes së aktit seksual atë e zë gjumi dhe më vonë thotë që nuk po flinte, vetëm po ëndërronte.

Jemi të dy brenda të njëjtës ëndërr, dhe ti pëshpërit. Ti e vodhe shfaqjen, Jozefinë. Nuk ta falin këtë në teatër.

Mëngjesin tjetër dhe atë pasardhës, ti shkruan vargje për mjegullën që ngrihet nga çarçafët prej sateni, reciton sonata për të në trotualet e bulevardit “Sunset” teksa mbështet pëllëmbën e saj të ngrohtë te fytyra jote e dashuruar. Në kafenenë *Griddle*, ti i përulan petullat *red velvet* dhe pi çokollatë të shkrirë, dhe i thua asaj që poezitë shkruhen vetë. Trotualet e bulevardit “Sunset” afër

kampeve të të pastrehëve te farmacia *Rite Aid*, janë shndërruar në Fushat e Elizesë.

Nëse sonatat shkruhen vetë, belbëzon ajo, atëherë a ke rënë në dashuri një mijë herë më parë në këtë trotuar kadifekuq?

Jo, vajzë e bukur.

Ti nuk ke rënë në dashuri një mijë herë më parë. Ti ke qenë në kërkim të dashurisë që në vitin e fundit të gjimnazit. Ti ke qenë i lidhur me disa gra. Ti pyet nëse kjo është një gjë e padëshirueshme. A të bën më pak tërheqës?

Jo, thotë ajo. *Më tepër.*

Ti ke një apartament me dy dhoma dhe me ballkon. Dhe një faqe muri mbushur me libra. Rrezatoni që të dy. E keni bërë John Waters-in krenar.

Por ai nuk është një ballkon i mirëfilltë, thotë ajo. Është tepër i vogël.

Është ende një ballkon. Quhet ballkoni Zhulietë.

Pse, pyet ajo.

Në kuptimin e vërtetë të fjalës, për shkak të Zhulietës, përgjigjesh ti.

Ti merr pak dashuri për këtë, për poezinë e gjithë kësaj.

Xhulian, pëshpërit ajo, me duart e saj sipër kokës, duke u mbajtur te ballina e krevatit, a e bëra zemrën tënde të shpërthejë.

Po, Jozefinë, ti shpërtheve në zemrën time.

Pasi bëjnë seks, kur ajo mezi lëviz, ti i thua që ke një tarracë me pamje dhe vaskë me hidromasazh. Ti mezi lëviz për vete. Goja jote e mavijosur me vështirësi mund të shqiptojë ndonjë fjalë. Është kaq qesharake se si dashuria dhe përleshja mund të shkatërrojnë një trup.

Atë natë të freskët në atë vend të shkretë, ju ngjiteni lart të zhveshur lakuriq dhe futeni në vaskën me hidromasazh. Ajo duke pëshpëritur shpreh miratimin e saj në lidhje me vendosjen e vaskës, dritat ngjyra-ngjyra, për shampanjën që vjen bashkë me të, dhe për burrin që vjen bashkë me të, dhe në të. Por nuk shoh të ketë ndonjë pamje, thotë ajo, teksa të vështron mbi filuskat e shkumëzuara.

Po, ka. Nëse shikon majtas, mund të shohësh oborrin e shkollës përtej bulevardit “San Vicente”.

Vë bast që edhe mund të dëgjosh zhurmat e shkollës, thotë ajo, teksa vjen drejt teje e zhytur në ujin që gurgullon. Gjatë pushimit, fëmijët bërtasin. Dhe nëse ti mund t'i shohësh *ata*, a mund të na shohin *ata ne*? Ajo të shtrëngon teksa ngre gjinjtë e lagur pranë gojës sate të lagur.

Ti uron që dikush të mund të të shihte. Ti dëshpërimisht ke nevojë për dikë që të jetë dëshmitar i lumturisë sate.

Ti i jep furçën e dhëmbëve që mban rezervë, një palë nga bokset e tua të brendshme, e ndan me të shampon tënde, sapunin tënd, këmishët e tua. Ajo ndan me ty histori mbi plazhin Brighton dhe flirtimet poshtë urës me djem të bezdisur dhe mbi Zakijan teksa kërkon zotërinë e duhur gjatë gjithë jetës së saj dhe në vend të tij gjen Trevorin e neveritshëm. Ajo të tregon mbi qytetin e shndritshëm dhe vetminë therëse.

Ajo pyet çfarë ngjyre ishin dritat kur e pe për herë të parë.

Të kuqe, përgjigjesh ti.

Ju shihni *Apocalypse Now*, komedinë më romantike të të gjitha kohërave. Ju duhen disa ditë për ta parë deri në fund, pasi e ndërprisni për të bërë dashuri, për të ngrënë ushqim kinez, për lexime dramatike nga *Heart of Darkness*, dhe ajo tallet me ty që ke atë vëllim të mjerë të Conrad-it në raftin tënd të librave. Ti nxjerr komedinë *The Importance of Being Earnest* dhe aktron me zë të lartë në dhomën e ndenjjes, duke qeshur, i zhveshur lakuriq. Ajo e njeh më mirë se ti këtë pjesë, gjë që të mbush me turp. Ti dikur e dije përmendësh, por e ke harruar. Ti thith dy shishe verë teksa rrotullohesh në dysheme dhe rikrijon Cecily dhe Algernon, i squllët në komedi, i lëngshëm në dashuri.

Ti e ke humbur sensin e ditëve, gjurmën e orëve. Ti rri ulur dhe pret atë në *Volvo*-n tënde, duke kapur timonin me duar të dashuruara. Ti bën disa telefonata. Asnjë njeri nuk është i kënaqur me ty. Asnjë përveç asaj. Ajo është e lumtur me ty.

Pse nuk zgjodhe të jetoje në kodrat e Hollivudit? Pyet ajo. Ti mund të marrësh një shtëpi kudo. Pse e more këtu, me pamje nga pjesa e pasme e një hoteli?

Ti nuk zgjodhe ta merrje shtëpinë në kodrat e Hollivudit, i shpjegon nën shkëlqimin e lagësht, teksa avionët gumëzhijnë ulët,

sepse atje lart, një shtëpi sa një kuti kushton pesë herë më shumë dhe zbritja poshtë me makinë zgjat *përgjithmonë*.

Ti nuk zgjodhe të jetoje te kodrat për shkak të *parave*?

Dhe një rrugë e gjatë me makinë, i thua, duke mbrojtur veten, teksa e përkëdhel.

Po *ti* për ku duhet të vraposh? - thotë ajo. Ti punon në shtëpi. Mund të rrish ulur tërë ditën në një vaskë, në një tarracë në “Mulholland” me pamje nga oqeani dhe të thuash gjëra të mençura për uthullën.

Kush po bën si e mençur tani? Më beso, bëra gjënë e *zguar*.

Ajo qesh. Por jo gjënë e *bukur*.

A do të shkojmë me makinë në male, Jozefinë? Ti i ofron asaj kodrat, kanionet, plazhin Zuma, dhe të gjithë muzikën që burra të tjerë kanë bërë nëse ajo do të të dashurojë.

Çdo gjë që ajo dëshiron është trupi yt.

Ndonjëherë sillesh sikur vetëm për këtë ke ardhur, i thua ti me shaka.

Nga e di që nuk është e vetmja gjë për të cilën kam ardhur, thotë ajo.

Me shaka?

Ajo pëshpërit se është e uritur për prekje sensuale. Nuk ka kohë për të humbur.

Ti i kujton vajtimin e Ben Johnson-it mbi jetën e shkurtër njerëzore. “Ah sikur të ishte një motor, që të linte pas të gjitha orët.”

Ajo nuk është dakord. Nuk ka asgjë të shkurtër në lidhje me ty, thotë ajo, teksa qëndron përpara teje e zhveshur, me gjinjtë e kërcyer për të të joshur, buzët e saj për të të lehtësuar, vithet e saj për të të mirëpritur dhe ndoshta një ditë për të të dhënë fëmijë (shakaja e saj, jo e jotja, dhe ti je më pak i tmerruar nga kjo nga sa duhet të jesh). Ajo dëshiron prej teje prekje sensuale? Ti je aq sensual sa natyra jote e egër mund ta lejojë. Ajo do bishën që ekziston brenda teje? Dëshira e saj është urdhër për ty.

Xhulian, unë sapo të njoha dhe prapë më duket sikur kam një jetë që të njoh. Si është e mundur?

Ti nuk ke përgjigje. U verbove që në fillim. Një kometë u përplas në tokë.

Ti harron të shkosh në supermarketin *Whole Foods*, harron shokët e tu, buletinin, tubat e bllokuar që duhen pastruar, kamionët që duhen marrë me qira. Ti harron çdo gjë. Është njësoj sikur e lë pas të kaluarën tënde kur e takove atë.

Ajo ka uri? Ti e ushqen. Ajo ka etje? Ti i jep verë. Ajo dëshiron të dëgjojë muzikë prej teje? Ti i këndon për kafënë e linjës *Alfred* dhe raviolit me misër të ëmbël nga Georgio Baldi. Ti e puth në qafë. I thua se ke dashur ta puthësh prej kohësh. Ajo qesh. Po, Xhuls, këto do të jenë dukur si njëzet e katër orët më të gjata të jetës sate.

Ti i propozon të shkoni për të luajtur videolojëra te *Raven's Cry* apo në kubin e natës *Whisky a Go Go*, por jo para se t'i blesh biftekun burrito më të mirë në Vine, dhe ajo thotë sesi është e mundur që di kaq shumë mbi ushqimin dhe dashurinë, dhe si të bësh një vajzë të lumtur, dhe ti përgjigjesh, jo thjesht një vajzë... por ty. Ju të dy rrini në shtëpi për të bërë dashuri dhe dilni për të ngrënë. Pra, si thua, shkojmë te *Whisky a Go Go*, Jozefinë? Do të dëgjojmë Ninth Plague dhe *Kings of Jade*. Tino and the Tarantulas do e ndezin vendin. Por ajo kërkon prej teje të bëni dashuri, dhe do e donte ta bënte nën ritmin e çmendur të muzikës. A do të më bësh ta ndiej, thërret ajo.

Po. Do ta bësh ta ndiej.

Oh, Xhuls, thotë ajo, me krahët e saj mbështjellë rreth teje, duke të të mbështetur në zemrën e saj. Kini kujdes nga magjistari, themi në shfaqje, ai ndodhet këtu vetëm si një shpërqendrim. Mos e lejoni në rrethin tuaj. Djalë, ti më ke bërë një truk magjik. Ti më tërhoqe me indiferencën tënde të papërmbajtshme, dhe tani je bërë si letër ngjitëse.

Kush është indiferent? - thotë ai. Do e kesh fjalën për ndonjë tjetër Xhulian.

Kur doje të më puthje për herë të parë? - pyet ajo. Ti i thua, atë natë kur t'u shfaq nën dritat e kuqërremta te shfaqja *Shpikja e Dashurisë*. Ti nuk lejove që të kalojë as ditën e parë, orën e parë, momentin e parë që kur e takove. Ti e dije. E dije që në fillim.

Shpirti yt u shtri para asaj, njësoj si rri shtrirë ajo tani krah teje.

Ti po shpik çmenduri dashurore që ajo të mos mërzhitet me ty.
Shanse të pakta për këtë, thërret krijesa hyjnore.

Gëzohu, Jozefinë, pëshpërit ti, me kokën të ulur, ulur në gjunjë midis këmbëve të saj, se emri yt është i shkruar në parajsë.

Dhe për disa arsye, kjo e bën atë të qajë.

Jo, jo, mos ndalo, thotë ajo, duke fshirë lotët. Nuk ka asgjë që nuk shkon. Por eja të dëgjojmë Tom Waits teksa bëjmë dashuri. Ai është i preferuari im. Le ta dëgjojmë të këndojë *time, time, time*, por ti mos u ndal para se të përfundojë kënga, mirë, Xhuls?

Përderisa nuk është versioni original pesëmbëdhjetë minuta, ti nuk e ke problem, thua, gjithmonë me shaka edhe në atë moment.

Në vazhdim, ajo të këndon për ditët e pafundme të kthyer në net. Ndonjëherë tingëllon sikur thotë se *ditët tona të pafundme të kthyer në net janë të numëruara*.

Tek *Whiskey a Go Go*, një budalla i dehur, zvarritet dhe zë stolin tënd pranë banakut që për momentin është i lirë, dhe teksa ti kthehesh nga tualeti, e godet me shpatull duke e rrëzuar në tokë dhe hiqesh sikur ishte aksident. Më fal o burrë, ka kaq shumë njerëz, nuk të pashë, a e ke bezdi, ky është vendi im. Xhulian! - thërret e dashura jote, ti e shtyve nga stoli atë burrin që ra në tokë? Nuk e di ku e ke fjalën, thua ti. Ai u rrëzua.

Më vonë, pasi u kthyet në shtëpi me nxitim se ajo kishte nevojë urgjente për ty, me zërin e saj marramendës, ajo të pëshpërit që i ke tejkalar pritshmëritë e saj. Ti ngurron t'i mburrësh me përlulje. Je i kënaqur që ajo është e kënaqur, thua duke ngritur supet instinktivisht. Ti ke një aftësi për të shitur, por pa shitur. Nuk ke asgjë për të vërtetuar. Fillimisht shet, më pas dorëzon.

Ajo thotë që mendonte se ti mund të ishe *Nightcrawler*-i¹, që ka pamjen e një demoni dhe zemrën e një predikuesi. Por, ti nuk je ky. Ti ke paraqitjen e një predikuesi dhe zemrën e një demoni.

Dhe jo vetëm *zembrën* e një demoni, Xhulian.

Ndonjëherë ajo rri me Z-në. Dhe ndonjëherë ti ngre prapanicën dhe shkruan një letër udhëzimesh me këshilla, edhe pse nuk ke

¹ Nightcrawler - kërcimtar nate. (Shën. i red.)

më zgjuarsi për asnjë, të gjitha thëniet e tua u gëlltitën nga ikona e koshit të plehrave në laptopin tënd. Bëj një listë me të gjitha gjërat që mendon se doje dhe digje - *kjo* është këshilla jote. Sepse aty ku je, nuk ka asgjë përveç lavdisë.

Ajo të bën të dëshirosh për një makinë tjetër: një kabriole, dy vendshe, me parafango të kromuar dhe *suicide doors*¹. Të dy e adhuronin plazhin në Zuma. Largoheni para perëndimit, sepse unazat e ferrit e presin te teatri “Grek”. Por ndonjëherë nëse je me fat, ajo bën dashuri me ty në parkingun e Zumës, dhe rrobat e banjës i ka flakur aty anash. Ajo të shtrëngon në ndenjësën e pasme të *Volvo*-s sate, që në fakt është për burra të moshuar, sikur je gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe sapo ke mësuar t’i japësh makinës.

Sikur sapo mësove të bësh çdo gjë.

Provat për *Paradise in the Park* janë gjatë natës. Në teatrin “Grek”, ti e pret atë në detin e ndenjësëve imagjinare që duken të lagura me gjak dhe e shikon si rrëshqet nëpër skenë teksa dielli perëndon dhe errësira dendësohet. Xhulian, thotë ajo duke marrë frymë, unë mund të flas për Danten, por të ëndërroj ty.

Kudo që shkoni, shëtisni të kapur dorë për dorë. Plazhet Venice dhe Hermosa janë lodhur nga ecjet tuaja, ecjet e dy të dashuruarve. Lulet çelin. Netët janë të ngrohta. Ditët në shkretëtirë janë të gjata.

Kjo është ëndrra më e vërtetë që ke jetuar ndonjëherë.

Grupet *The Scurvy Kids* dhe *Slurry Kids* luajnë muzikë anash pishinës së hotelit aty pranë teksa pastrohen shezlonet që të ftuarit të shtrihen për t’u nxirë në diell. Dëgjohet hip hopi dhe xhazi, rroku alternativ dhe grupet e mëdha, granxhi dhe bluzi elektrik, *Buffalo Springfield* dhe *Wasted Youth* në Loz Feliz dhe në Hollivud. L. A-ja nuk ka shkëlqyer ndonjëherë ashtu si shkëlqen këto net vere kur *Voodoo Kung Fu* dhe *Destroyer Deceivers* shtrydhnin çdo tingull të fundit lumturie pranë “Luna Park”, dhe qyteti nuk është dukur ndonjëherë si një vepër arti më vezulluese e verbuese.

Të dielave në mbrëmje te *Scarpetta*, uleni jashtë, në oborrin e gjelbëruar me pamje nga kopshtet *Canon*, me drita të ndezura

¹ Dyer të varura në pjesën e pasme. (Shën. i përkth.)

si në kohë Krishtlindjesh. Pini kokteje *Fortuna*... Absolut dardhe, *St. Germain* dhe pure pjeshke... dhe i shprehni dëshira yjeve, uroni për këtë dhe për atë. Porosisni biftek tartar, dhe ravioli dhe *foie gras*. A i keni thënë njëri-tjetrit çdo gjë? Nuk duket sikur ka ngelur ndonjë gjë për t'u thënë, dhe prapë ju vazhdoni flisni, bëni shaka, diskutoni, nuk ndaloni asnjëherë. Kaloni kohën deri në tre të mëngjesit në *Laugh Factory* në bulevardin "Sunset", teksa veçoheni nga një komedian i talentuar. "Pa shikoni ju të dy, keni atë dashurinë e njerëzve të bardhë", ju tall komediani me *falseto-n* e tij të lartë. "Oh shpirt, mos po të vras *krahu*?" "Çfarë thua keku im me mjaltë, ti je krahu im!"

Ju flini dhe hani dhe jetoni dhe dashuroni dhe shtriheni të ndërthurur me njëri-tjetrin. Shpirtrat tuaj janë pa kufij, sepse trupat tuaj janë pa kufij.

Apo është e kundërta?

Oh, Xhuls, pëshpërit ajo. Nuk ka asgjë më të mirë se ti.

Në librin që është jeta ime, thua ti, në kapitullin ku të takova për herë të parë, janë shkruar fjalët *dhe kështu jeta ime fillon përsëri*.

Unë dua një libër vetëm për mua, thotë ajo, jo thjesht një kapitull të pavlerë.

Në Kaliforninë e Jugut është e thjeshtë të biesh në dashuri nga Zuma në Agoura.

A e di se çfarë nuk është e thjeshtë për t'u bërë?

Të gjesh vendin ideal për t'i propozuar për martesë.

Sigurisht, ajo është e lumtur të adhurohet nga ti... për momentin... por a e kupton ajo që kjo gjë mes jush nuk është diçka që fillon dhe mbaron.

Vini re, po ju tregoj një mister. Jo të gjithë do të flemë, por të gjithë do të ndryshojmë.

ATA TË KATËRT

XHULIANI VAZHDONTE TË SUGJERONTE QË TË DILNIN të katërt. Ai akoma nuk e kishte takuar Zakijan. Edhe Jozefina e kishte takuar Eshtonin vetëm një herë, nëse nuk merrje parasysht atë herën tjetër (dhe kush donte ta llogariste), në orën dy të mëngjesit, kur Eshtoni i ra derës si agent i KGB-së, dhe kur Xhuliani e hapi... pas tij Jozefina gjysmë e zhveshur... ai tha, “Uf, pra *qenke* gjallë” dhe iku me nxitim nëpër shkallë.

Jozefina i tha pse duhej të dilnin të gjithë bashkë.

Në mënyrë që ndihmësit tanë të njihen.

Pse?

Në mënyrë që të aprovojnë lidhjen tonë.

Pse të intereson nëse e aprovojnë? Po nëse nuk e aprovojnë?

Pse mos ta aprovonin?

Njerëzit janë të çuditshëm, tha ajo. Eshtoni nuk më ka qejf.

Ai thjesht është i zemëruar me mua. Eshtoni do të të pëlqejë shumë.

Nuk jam e shqetësuar për Eshtonin.

Po Z-ja? Unë jam djalë i mirë, tha Xhuliani. Unë rruhem, nuk lavdëroj më tepër seç duhet, jam i sjellshëm, i përgjigjem ftesave. Mund të bëj një shaka, të mirëpres një shaka. Pse mos të më pëlqente Zakija?

Të thashë, Xhuls. Njerëzit janë të çuditshëm.

∞

Një problem ishte orari i punëve të tyre. Gjatë fundjavave Zakija ishte pushim, por në fundjavë kishin shumë punë te *Kutia*

e *Thesareve*, si dhe Jozefinës po i afrohej premiera te *Paradise*, ku do të tregonte aventurat e Dantes dhe Beatrices, gjashtë net në javë dhe gjatë ditës së mërkurë.

Në fund të qershorit, Xhuliani, më në fund, arriti të caktonte një takim për të *ngrënë mëngjes*, një ditë të diel ku do të ishin që të katërt. Ai nuk mundi të bënte një rezervim te *Montage* në Beverly Hills, por ata u takuan diku aty pranë, jashtë, në një prej oborreve të kopshteve *Canon*, ku shiteshin sandviçë të lirë, përballë hotelit me pesë yje.

Zakija erdhi bashkë me Jozefinën. Jozefina kishte veshur fustan plazhi të lirshëm ngjyrë limoni të papjekur dhe rroba banje. Ajo dhe Xhuliani pas takimit do të shkonin në gjirin e Point Dume-s. Nën beretën e kuqe, dukeshin flokët e saj të gjatë, të lëshuar. Ajo kishte bërë pak tualet dhe kishte vendosur pak krem mbrojtës kundra diellit. Pasi e puthi, e prezantoi me Zakijan.

Jozefina kishte të drejtë. Zakija ishte tërheqëse. Por, a po mundohet të mos dukej e tillë? Ajo kishte mbuluar trupin e saj të mirëformuar me një bluzë të ngrirë dhe një fund paksa pa formë dhe tepër të gjatë. Kaçurrelat e saj të zeza e të dendura, të përdredhura si hapëse tapash, mbaheshin si mos më keq mbrapa me një rreth koke, duke lënë që vëmendja të përqendrohet te fytyra e saj zeshkane që shkëlqente, një fytyrë e pastër që nuk kishte nevojë për tualet. Dhe kishte fytyrë aq simetrike, sa dukej si fallco. Në gjithë qenien e saj, ajo ishte një skulpturë me forma ideale femërore, e gdhendur nga një adhurues i zjarrtë i grave: sytë të mëdhenj, vetullat të harkuara, balli i lartë, mollëzat të gjera, buzët e plota, trupi i mbushur, flokët të përdredhur dhe pasionante. Pas prezantimit, Zakija i dhuroi një buzëqeshje formale, me dhëmbët jashtë si të një fitueseje konkursi bukurie.

Por buzëqeshja u shua paksa si shpejt. Xhuliani nuk mund ta kuptonte nëse ishte imagjinata e tij, por ai ndjeu shenja... tensioni? Mosmiratimi? Dukej sikur buzëqeshja e saj ishte ndezur me forcë dhe më pas ishte shuar me shpejtësi. Pasi ishte shuar, e vërteta e qartë nuk mund të mohohet: një fytyrë pa buzëqeshje ishte një fytyrë më pak e bukur, qoftë ajo e Zakijas apo e ndonjë tjetri.

Xhuliani mund ta vendoste këtë këshillë jete në buletinin e ditës së nesërme.

Ata porositën pije me gaz dhe po prisnin Eshtonin duke trajtuar temën e rëndësishme të motit me diell, duke e trajtuar me kaq entuziazëm, sa dikush mund të mendonte që i ngrohti dhe dielli ishin unik vetëm për Kaliforninë e Jugut. Jozefina tha një shaka pa kuptim (çfarë ndodh kur nga një vezë del e verdha? Çahet?). Xhuliani e vështroi i hutuar dhe kjo tërhoqi vëmendjen e Zakijas. Ti *budalla* i shkretë patetik, thoshte shprehja e fytyrës së saj.

- Mos ia vë re asaj, Xhuls, - tha Jozefina, - Z -ja është paksa e thartë në dashuri.

- E tillë jam?

- Kush nuk do të ishte... duke pasur të dashur Trevorin e tmer-rshëm, - tha Jozefina dhe i pickoi krahun Z-së.

- Po, sa keq që Xhuliani nuk mund të klonojë veten.

- Nëse mendon se Xhulsi im është i mirë, - tha Jozefina, - prit sa të takosh shokun e tij, Eshtonin.

- Jozefina! - ky që foli ishte Xhuliani.

- Po pra, Jozefina, - tani ishte Zakija që foli, pa qeshur dhe pa pretendime.

- Po tallem. Ishte shaka. O Zot, ju të dy.

Sa më shumë që Xhuliani vëzhgonte Zakijan, aq më shumë bindej që ajo kurrë nuk do të donte asgjë më *pak* se një karrierë në film apo teatër. Ajo dukej sikur ishte e kundërta e Jozefinës. Pavarësisht aseteve të saj fizike të dukshme, Zakija nuk ishte ngazëlluese, kapriçioze, apo joshëse, nuk i kuptonte shpejt shakatë, dhe as në të shprehur, në veshje, apo në sjellje, nuk e tregonte veten si dikush që kërkonte njëfarë vëmendje, aq më pak si dikush që jetonte për dritat e skenës dhe duartrokitjet, si e dashura e tij. Ishte e çuditshme. A nuk i kishte thënë Jozefina që teatri kishte qenë ëndrra e tyre e përbashkët?

Eshtoni, më në fund, mbërriti. Mbërriti aq vonë sa ishte fyese dhe e pafalshme për të. Ai kishte veshur xhinse të grisura dhe një bluzë ngjyrë blu të errët, të palarë. Nuk ishte rruar. Dhe më e keqja nga të gjitha: ishte i mërziur.

Ky burrë është zakonisht magjepsës, dhe i veshur mirë, veçanërisht kur takon njerëz të rinj, *veçanërisht* kur takon gra. Dhe nuk kërkoi as falje! Ai u tregua i ftohtë ndaj Jozefinës, gjë që nuk ishte surprizuese, por akoma më ftohtë u soll me Zakijan. Ajo shikonte lart, ai shikonte poshtë, ajo bëri gjoja sikur e përshëndeti, ai bëri sikur pohoi me kokë. Karrigia e vetme e lirë ishte ngjitur saj, kështu që ai nuk kishte zgjedhje tjetër përveçse të ulej, por gjuha dhe trupi i tij tregonin që nuk donte. Ai mbante menynë e hapur ndërmjet tij dhe Z-së. Pasi porositi, Eshtoni u kthye nga Xhuliani, dhe kur pa Xhulianin që po gjykonte veshjen e tij në heshtje, përmendi faktin që po hanin sandviç me proshutë.

- Çfarë tjetër mund të veshësh kur bëhet fjalë për të ngrënë sandviç me proshutë? - tha Eshtoni. - Një sandviç me proshutë është diçka që ha me një vajzë, ha në krevat teksa jeni duke parë ritransmetimet e serialit televiziv *Entourage*.

Kjo ishte gjëja më pak ofenduese që do thoshte gjithë pasditen.

Pas më pak se pesë minutash që ishin në tavolinë, Eshtoni, në vend që t'i magjepste vajzat, vendosi të sillej në tjetër mënyrë. Ai u bë aq i padurueshëm sa mundej. Pa këmbyer shikim me asnjërin prej tyre, duke vështruar herë gotën e tij me ujë, herë duke vështruar tërthorazi Zakijan, ai pyeti Z-në me vrazhdësi se çfarë pune bënte dhe e ndërpreu në mes të përgjigjes së saj. Disa minuta më vonë ai iu kthye asaj me një: "Më fal, çfarë po thoshe?". "Nuk ka rëndësi", tha Zakija. Kur Jozefina nxiti Eshtonin që t'i tregonte për aventurat e tij ekstreme në Amerikën Perëndimore, ai e injoroi duke thënë që gjithmonë i kishte urryer ambientet jashtë, gjë që nuk ishte vetëm e kundërta e së vërtetës, por edhe një mënyrë e tmerrshme për të masakruar bisedën.

- Me të vërtetë? - tha Jozefina. - Por Xhuls më tha që ty të pëlqen shumë të shëtisësh dhe të ngjitesh nëpër male.

- *Xhuls* ta tha këtë? Me të vërtetë? - ia ktheu Eshtoni. - Ndoshta është një dëshirë e shprehur nga ana e tij. Atij i pëlqejnë ambientet jashtë.

Jozefina qeshi me mirësjellje. - Çfarë po thua, Xhulianit nuk i pëlqejnë ambientet e jashtme, - tha ajo. - Ai i urren. Përveç plazhit. Përndryshe, ai nuk do të ishte një me natyrën.

Eshtoni piu një gllënjë të madhe nga kokakola, ndoshta duke uruar që të ishte diçka më e fortë.

- *Kjo është ajo që të tha?* - pas një momenti të zgjatur, Eshtoni vazhdoi të fliste pa e kontrolluar vete. - Duke perifrazuar Miltonin, unë vetë i urrej ambientet e jashtme me një urrejtje të palëkundur. Problemi im kryesor, që ta kuptoni, është që nuk më shijojnë asnjë nga gjërat që ndajnë ambientet jashtë me *mua*. Nëse do të shihnit reagimin tim ndaj një merimange tarantule apo një gjarpri, mund t'ju premtoj, që nuk do të isha gjakftohtë dhe nuk do të isha burrëror. Jo, që pas incidentit të vogël që i ndodhi Xhulianit, ambientet jashtë nuk më kanë pëlqyer. Do të preferoja më mirë të qëndroja brenda kantinës *Tequila* dhe të pija gjithë ditën. E pira pa kontroll dhe dehja është në fakt stërviçja e vetme që bëj.

Përpara se Xhuliani të nxitonte për të ndërruar temë, Jozefina pyeti si e shushatur: - Për çfarë incidenti të vogël e kishe fjalën?

- Ti pi? - pyeti Zakija. - Kjo është surprizë.

- Tani po pi, sigurisht, - tha Eshtoni, - por jo si më parë, në universitet. Zot, kush do mundej; apo jo Xhuls?

Ajo i hodhi Eshtonit një vështrim armiqësor dhe Jozefinës një vështrim fyes. Pse më solle këtu, dukej sikur donte të thoshte dhe u ngrit për të shkuar në tualet. Duke kërkuar falje, Jozefina e ndoqi pas.

- Çfarë ke, o burrë? Çfarë nuk shkon me ty? - shfryu Xhuliani sapo vajzat ishin jashtë rrezes së dëgjimit.

- Nuk e di ku e ke fjalën.

- Supozohet që t'i magjepsësh, jo t'i bësh të të urrejnë... edhe *mua* bashkë me ty.

- Po sillem ashtu siç jam në të vërtetë, Xhulian, - tha Eshtoni.

- Me të vërtetë? - iu kthye Xhuliani - Të duket sikur kjo është mënyra si femrat reagojnë zakonisht ndaj teje? Çohen dhe vrapojnë? Po sikur të mos kthehen?

Vështrimi i Eshtonit u drejtua nga qielli, sikur donte të thoshte "O Zot të lutem".

- Duhet të pudrosen. Faji im është ky?

- Çfarë nuk shkon me ty?

- Nuk mund të pëlqehem nga të gjithë, vëlla, - burri biond u përgjigj në mënyrë filozofike. - Nuk është faji im nëse kanë ndonjë problem me mua. Unë jam i njëjti. Nuk jam *unë* ai që ka ndryshuar.

Dy shokët ndenjën në qetësi për një moment. Sapo Xhuliani u bë gati të fliste, Eshtoni tundi kokën në drejtim të vajzave që po ktheheshin.

- Çfarë incidenti pati Xhuliani jashtë? - pyeti Jozefina sapo u ul në vendin e saj.

- Nuk ka rëndësi, - tha Xhuliani, duke dëshiruar të godiste Eshtonin që hapi gojën e tij të madhe.

- Po, Jozefina, mos e vrit mendjen, Xhuls ka të drejtë, *asgjë* nuk ishte, - tha Eshtoni. - Ne po shëtisnim në natyrë dhe ai humbi, kjo është e gjitha. Ne nuk po e gjenim dot për një kohë të gjatë. Ishim të sigurt që kishte vdekur. Por pastaj, - Eshtoni bërtiti me gëzim, - e gjetëm! Ah, po, çdo gjë është mirë kur përfundon mirë, apo nuk je dakord? Nuk ka kuptim të mërzhitsh për këtë tani, kur ai është ngjitur pas teje. Është e mrekullueshme meqë ra fjala, që ju të dy ia keni kaluar kaq mirë. Ndonjëherë këto gjëra shkojnë *kaq* keq.

Një copëz e ushqimit të tij që po përtypte i ra nga goja te bluza. Ai e hodhi poshtë dhe vazhdoi të hante.

Zakija filloi të thoshte diçka, por Eshtoni e ndërpreu.

- Në universitet, njëherë dola me një vajzë që nuk fliste anglisht, - tha ai, me gojën plot me bukë dhe proshutë.

- Kjo ishte para apo pasi kishe pirë? - tha Zakija.

- Teksa pija, - u përgjigj Eshtoni. - A e mban mend atë, Xhuls? Manikin? Një korrigjim... Maniki nuk fliste *mirë* anglisht, dhe kjo është *shumë* më keq sesa të mos flasësh anglisht fare. Gjëja më e keqe që njerëzit mund të bëjnë, është të mendojnë që janë të mirë në një gjë, kur nuk ia thonë fare për të.

- Kjo është me vërtetë gjëja më e keqe që një person mund të ketë, - tha Zakija.

- Absolutisht, - Eshtoni u përtyp. - Ishte një nga takimet më të gjata të jetës sime.

- Pyes veten si mund të të ketë bërë *kjo* të ndihesh, - tha Zakija, dhe Eshtoni i gufuar e ktheu vëmendjen e tij nga Jozefina.

- Si po shkon *Paradise in the Park*? - pyeti ai. Jozefina buzëqeshi, u bë gati t'i thoshte Eshtonit diçka për këtë, por ai e ndërpreu: - E kisha fjalën, sa do të zgjasë shfaqja?

- Një muaj. Mund të të gjej bileta nëse do.

- Po, ndoshta. Veçse nuk e di se për cilën ditë. Xhuls dhe unë supozohet të shkojmë në Cabo për festën e 4 Korrikut. Dhe të jem i singertë, Dante nuk më ngjit shumë. Preferoj më shumë humor idiot.

- Ua çfarë na the, - tha Zakija.

- Mos ki merak, Eshton, Dante nuk është aq për të qeshur, - tha Jozefina, - komedi mund të jetë një term i gabuar.

- Më trego një mace të lidhur në ventilator ose një shaka mediokre pordhash dhe do të qesh derisa të më dalin lot nga sytë, - tha Eshtoni. - Nuk jam krenar për këtë. Thjesht kështu është.

Jozefina i shtrëngoi fort dorën Xhulianit poshtë tavolinës. - Në Cabo? - e pyeti ajo me zë të ulët.

Xhuliani tundi kokën, si për të thënë *mos u shqetëso*. Një tjetër gjë të cilën e kishte harruar totalisht.

- Pra, jeta e vërtetë nuk ka depërtuar ende në festën tënde të vogël të vëllazërisë së universitetit? - pyeti Eshtonin Zakija, duke e kthyer kokën me zor për t'iu drejtuar.

- Falëndero *Krishtin* për këtë, - ai me zor e ktheu kokën kur u përgjigj.

- A e di se çfarë thotë Gandi? - tha Zakija.

Eshtoni ende po përtypej. - Mua po më drejtohesh?

- Po, - tha Zakija, me buzët e saj të shtrënguara plot shkëlqim. - Gandi thotë: mendimet tona bëhen fjalët tona, fjalët tona bëhen veprimet tona, veprimet tona bëhen karakteri ynë, dhe karakteri ynë bëhet fati ynë.

- Hmm, - Eshtoni u gëlltit dhe rrufti kokakolën duke bërë zhurmë. - Snobizmi yt intelektual synon të më poshtërojë? Sepse mendimet *nuk* janë me siguri fati im. Jam i sigurt për këtë. Do të isha në burg për gjërat që mendoj. Por më lër të të them se çfarë thotë *Eshtoni*. Sepse ti dhe Xhuliani nuk jeni të vetmit që mund të nxirrni nga goja thënie thelbësore. Edhe unë kam këshilla për jetën. Doni t'i dëgjoni?

- A kam zgjedhje tjetër?
- Unë e quaj rregulli dyminutësh i Eshtonit.
- Eshton mos! - këtë radhë ishte Xhuliani.

Pa e zgjatur, Eshtoni vazhdoi. - Nëse sheh diçka që duhet bërë dhe mund të bëhet brenda dy minutash, bëje menjëherë, - ai ndaloi për pak. - E quaj gjithashtu Rregulli i Seksit të Eshtonit, - ai hodhi kokën mbrapa dhe qeshi.

Xhuliani i hutuar fërkoj sytë në heshtjen e akullt që pasoi. Çfarë po *ndodhte*?

Kur vajzat refuzuan të reagonin, Eshtoni vazhdoi t'u binte në qafë.

- Problemi i të qenët shokë me Xhulianin, - tha ai, - është që jemi të kundërt në shumë mënyra. A ndodh kjo gjë dhe me ju? Vë bast që po. Për shembull, Xhuliani mendon se është me humor, kurse unë jam më shumë i lezetshëm. Por t'ju them të vërtetën, do të doja shumë të isha edhe me humor *edhe* i lezetshëm.

- Unë u mësoj nxënësve të mi, - tha Zakija, - që është gjithmonë më mirë të jesh realist për të metat e tua.

- Nxënësit e tu të shkretë, - tha Eshtoni.

- Mua, nga ana tjetër, nuk më intereson fare të qenët "i lezetshëm", - tha Xhuliani, duke u ngritur nga tavolina dhe duke bërë gjeste të dukshme që t'i sillnin faturën.

- Sepse Xhulsi mund ta kalojë kështu gjithë ditën, - tha Jozefina me një zë të mbytur. Ajo i kapi kyçin, duke e vështruar nga poshtë.

- Ai nuk ka nevojë të jetë i lezetshëm.

- Dhe kjo, sepse, - tha Eshtoni, - Xhulsi ka humor.

∞

- Pra, ky ishte Eshtoni i famshëm, - tha Zakija, pasi Eshtoni, i cili këmbënguli për të paguar, vendosi mbrapsht kapelën e tij të bejsbollit, rrëzoi një karrige, dhe u largua.

- Ai është në rregull. Askush nuk dëshiron të vihet në qendër të vëmendjes në këtë mënyrë, - tha Xhuliani. - Duhet ta provojmë sërish. Të bëjmë diçka më pak stresuese.

- Më pak stresuese se *sandviçët me proshutë*?

- Duhet të shkojmë në *Disneyland*, - tha Xhuliani. - Të katërt.
Jozefina duartrokiti. - Po, të lutem! Do të ishte fantastike.
- *Kurrë*, - tha Zakija. - Dua të them... jo, faleminderit.
- Ai nuk ishte aq keq, - tha Xhuliani. - Ai po përpiqej më shumë se ç'duhej.
- Ajo ishte *përpykje*?
Xhuliani filloi ta justifikonte. - Shiko, ai nuk është kështu.
- Ne jemi çfarë pretendojmë të jemi, - tha gruaja e re me një ton të ashpër, - kështu që duhet të jemi të kujdesshëm se çfarë pretendojmë të jemi. - Ajo ia nguli sytë Jozefinës, e cila kapi dorën e Xhulianit poshtë tavolinës dhe nuk ia ktheu Zakijas vështrimin qortues.

KUTIA E PANDORËS

MENJËHERË PAS FESTËS SË 4 KORRIKUT, TEKSA Jozefina luftonte për të përballuar *Paradise* me hipokritë dhe hajdutë, Xhuliani u takua me Eshtonin për një birrë te kantina *Tequila*, vendi i tyre i preferuar në bulevardin “Magnolia”. Birra u pasua nga një pjatë me *taquitos* dhe pak muhabet. Domethënë, pak muhabet në lidhje me Cabo-n, ku Xhuliani nuk vajti, dhe ku Eshtoni e Raili kishin shkuar vetëm.

Xhuliani buzëqeshi plot ankth. - Esh dua të të tregoj diçka.

Ai nxori nga xhepi një kuti të zezë prej kadifeje.

Duke u hedhur nga stoli i barit, Eshtoni ngriti duart. - Jo, jo, djalosh.

- A do ta shohësh?

- Thashë jo.

Dora e Xhulianit ishte akoma e zgjatur. Duke psherëtirë thellë, Eshtoni ia mori kutinë, e hapi, vështroi brenda, e mbylli, dhe e futi përsëri në xhepin e Xhulianit.

- Çfarë mendon?

- A do me vërtetë të dish se çfarë mendoj? - tha Eshtoni.

- Nëse do të më thuash “kjo është e mrekullueshme, Xhulian, urime”, po.

Eshtoni heshti.

Xhuliani po priste.

- Fol. Më duhet të iki shpejt, - ai nuk donte që ajo ta priste e vetme në parkingun e teatrit “Grek”. Nuk ishte vend i sigurt.

- Do t’i kërkosh të *martohet* me ty?

- Po. Por po përpiqem të gjej momentin e duhur.

- Pas tri vitesh që nga ky moment, si të duket kjo ide?

- Nuk po më ndihmon, Eshton.

- Çfarë lloj ndihme po kërkon? Do të praktikosh veprimet e tua me mua? Apo do këshillën time?

Xhuliani studioi me kujdes fytyrën e Eshtonit. Ata kishin kaluar kaq shumë vite bashkë, duke jetuar dhe punuar bashkë, duke pirë, udhëtuar, duke takuar gra së bashku, saqë Xhulianit nuk i duhej shumë kohë që të kuptonte se si ndihej Eshtoni për çdo gjë. Dhe pjesën më të madhe të kohës, Eshtoni ishte djali më i qetë e rrëzëllitës, pavarësisht se kishte kaluar një fëmijëri të vështirë, ajo lloj fëmijërie që të bën të dyshosh për kuptimin e vetë ekzistencës. Kështu që, kur Xhuliani vuri re shqetësimin në fytyrën e shokut të tij, tensionin rreth gojës që zakonisht ishte e qetë, rrathët e zinj poshtë syve të tij në ngjyrë të çelët, hijen e gjatë të ankthit në shprehjen e fytyrës së Eshtonit, Xhuliani nuk mund të vazhdonte t'i bënte presion. Atë e prisnin momente të vështira me familjen e tij, pasi ata nuk e kishin takuar akoma Jozefinën dhe mendonin se ai ishte i lidhur ende me Guenin.

- Unë thjesht dua që të jesh i lumtur për mua, Esh.

- E di që kjo është ajo që do, - i tha ai pa shtuar asgjë tjetër.

Duke psherëtirë, Xhuliani kapi gotën e birrës dhe i tha: - Ty nuk të pëlqen ajo.

- Unë nuk e njoh atë. Ky është problemi im.

- Ke të drejtë, Ky është problemi yt.

- Jo thjesht i imi.

- Ndërsa unë e njoh atë, - tha Xhuliani. - Dhe ti do e njohësh. Dhe kur ta njohësh, do ta duash.

- Ashtu është.

- Ti mendon se po nxitohem?

- Midis një mijë gjërave të tjera, po. Dhe nuk e mendoj. Është fakt.

- Çfarë tjetër?

- A je i sigurt që je i dashuruar?

- Më fal?

- A e ke marrë në konsideratë faktin se mund të jetë diçka tjetër? - pyeti Eshtoni. - Diçka po aq e kënaqshme, por më shumë çorientuese.

- Mjaft, - Xhuliani gëlltiti birraën.

- A e bën dot dallimin midis dashurisë dhe seksit?

- *Ti* a e di?

- Nuk jam *unë* ai që jam gati për t'u martuar, apo jo?

- A do ta dish cili është dallimi? - tha Xhuliani. - Askush nuk vdes për seksin.

- Oh, Zot. Është pikërisht kështu, apo jo. Gjithashtu, nuk është e vërtetë. Mashkulli i insektit grabitqar *mantis* vdes për seksin. Kjo është e gjithë jeta e tij. Të vdesë për seksin.

Eshtoni shfaqja shenja bezdisjeje.

- Çfarë mendojnë prindërit e tu? Nuk mund ta imagjinoj që mamaja jote është dakord, - ai u ndal për të pritur përgjigjen e Xhulianit, që t'i tregonte që ai e dinte tashmë që nuk do të kishte një përgjigje. - A e kanë takuar? - Një tjetër pauzë. - O Zot i madh, Xhuls, a e *dinë* ata për të?

Xhuliani refuzoi t'i përgjigjej vështrimit dyshues të Eshtoni.

- Më thuaj, kur e kishe në plan t'i thoshe mamasë sate? - pyeti Eshtoni. - Kur të merrte ftesën e dasmës në postë?

- Nëse *ti* po reagon në këtë mënyrë, si mendon se do të reagojë ajo?

- Çfarë do të thotë kjo për ty?

- Që askush nuk kupton ose askujt nuk i intereson asnjë dreg gjëje.

- Po, - tha Eshtoni, - ky jam unë.

Xhuliani u përqendrua, uli zërin, dhe vazhdoi: - Mirë, po atëherë pse po sillesh kështu?

- Nuk mund ta kuptoj, - tha Eshtoni. - Po Railit i ke thënë?

- Ju të dy sapo jeni kthyer nga Cabo-ja! Dhe e kisha të vështirë t'i thosha asaj para se të të thosha ty. Për më tepër e di se çfarë do të thotë. Ajo do të më thotë të ha më shumë ushqime të verdha si banane dhe ananas që të balancoj zjarrin në jetën time.

- Ndoshta për një herë të vetme duhet ta dëgjosh, - tha Eshtoni. - Pse tërë ky nxitim, Xhuls? Nuk e kuptoj. Mos e ke lënë shtatzënë?

- Mos u bëj qesharak.

- Atëherë pse të mos presësh dhe ca? Nëse është diçka e vërtetë, do t'i rezistojë disa...

- Ti do që unë të kaloj këtë fazë që më duket krejt e paarsyeshme? Dhe të pres për çfarë? Ti the që do t'i rezistojë disa... disa çfarë?

- Disa parsekë¹, - tha Eshtoni. Stresi mbi shpatullat e Eshtonit nuk u lehtësua pavarësisht shakasë. - Çfarë ndodhi me të qenët i frikësuar nga angazhimi?

- Nuk është angazhimi, - tha Xhuliani, - është vajza.

- A nuk i tha dikush kësaj vajze që nëse dëshiron t'ia dalë mbanë në *show business*, nuk duhet të martohet kurrë?

- Shpresoj që jo.

- Ku vajti gjykimi yt i shëndoshë? - pyeti Eshtoni. - Nuk është se e ke pasur gjithnjë, por e ke pasur sipas modës së vjetër. E bleve me jetën tënde, - ai mori frymë. - Ti je i kujdesshëm, i përpiktë me kohën, dikush tek i cili mund të mbështetesh, i besueshëm. Nuk je impulsiv. Ti nuk bën gjëra të tilla. Nuk je ti. Nuk është as vetja jote e viteve të shkuara.

- Eshton, por ajo është e duhura.

E gjithë sa tha shoku i tij ishte, "e duhura".

Xhuliani u mbështet prapë te shpinorja e stolit të banakut. - Domethënë kjo ishte arsyeja pse u tregove kaq i pasjellshëm ditën e kaluar?

- Nuk e di për çfarë e ke fjalën.

- Ajo që nuk kuptoj është se pse u tregove kaq i vrazhdë me shoqen e saj. Po *ajo* çfarë bëri?

- Nuk isha i vrazhdë. Po bëja muhabet. Për çfarë tjetër do të flisnim, për ty?

Ata mbaruan birrat e tyre.

- A keni diskutuar ju zogj të dashuruar se ku do të jetoni? - pyeti Eshtoni. - Do të zhvendoset ajo në L. A? Po karriera e saj? "Teatri është jeta ime", e të tjera si këto? Apo je ti ai që po bën plane të tjera, për t'u zhvendosur le të themi në Nju-Jork, ndoshta?

- Nuk do të shkoj asgjëkund, Esh, - tha Xhuliani. - Të premtoj.

- Një ndjenjë dhembshurie u dallua në zërin e tij. - Për këtë shqetësohesh?

¹ Parsekë: njësi matëse në astronomi, e barabartë me 3.26 vite dritë. (Shën. i red.)

- Nuk po shqetësohem, por pse me kaq nxitim? Për ta mbajtur që të mos kthehet në lindje? Po i skadon viza? Ti e di besoj që edhe Nju - Jorku ndodhet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, apo jo? - tha Eshtoni. - Mund të udhëtosh lirisht nga njëri breg në tjetrin.

Xhuliani vështroi me kujdes fytyrën e shokut të tij. - Çfarë po ndodh me ty, or burrë?

Eshtoni ia nguli sytë gotës së boshatisur të birrës. - Nuk e di. Kam një parandjenjë të keqe, kjo është e gjitha, - tha ai. - Edhe kur e pashë të performonte në teatrin "Cherry Lane", kishte diçka tek ajo, që nuk shkonte. Dhe nuk jam i vetmi që mendoj kështu. E pe dhe reagimin e Guenit dhe Railit për të. Reagimin e të gjithëve, përveç tëndit, sinqerisht. Nuk mund ta shpjegoj. Diçka nuk shkon. Ndoshta ajo vajzë nuk është ajo që mendon ti. Ndoshta ajo që ke gjetur është versioni hollivudian i asaj që mendon se do. Mendon se ke gjetur ditën, por ajo që ke gjetur në të vërtetë është nata.

- E ke gabim, - tha Xhuliani. - Ajo është vajza më e çiltër dhe e sinqertë që kam njohur ndonjëherë. Ajo e jeton jetën e saj zhurmshëm.

- Mirë, dakord.

- Ajo, është sikur je ti në versionin femër. Po më thua që nuk je ai djalë që unë mendoj se je?

Eshtoni nuk u përgjigj. - Ajo do të të krijojë telashe, - tha ai. - Nuk kam ç'të bëj. Kjo është ajo që ndiej.

- E ke gabim.

- Për të mirën tënde, shpresoj që po.

Burrat ranë në qetësi, duke u fokusuar te bisedat e klientëve të tjerë, me këngën *Burn it Blue* që po luhej në gramafonin me monedhë.

- Unë e di si je ti, - tha Eshtoni. - I qetë, por i pamëshirshëm. E di që nuk mund të ta mbush mendjen kundra asnjë gjëje, nëse ti nuk dëshiron të të mbushet mendja. Kur po planifikon t'i propozosh?

- Së shpejti. Po pres momentin e duhur, - tha Xhuliani.

- Ah, *kjo* është gjë e mençur.

- Nuk kam shumë prej kësaj, ama.

- Mençuri?

- Kohë, - Xhuliani u përkul më pranë tij. - *Brentwood Country Club* ka prenotime për katër javë nga e premtdja.

Në fillim Eshtoni nuk reagoi. - Katër javë nga cila e premte?

- Mos bëj kështu, - tha Xhuliani dhe u tund në ndenjësën e tij.

- Ti do të martohesh me një vajzë që e njohe para pesë minutash, katër javë nga kjo e premte? - shushatja e Eshtonit nuk kishte të paguar.

- Nuk jam i çmendur, Eshton.

- Sigurisht. Pse do të mendoja që një martesë me dikë që e ke njohur për më pak se dy muaj, është çmenduri?

- Ti mendon se martesë pasi e ke njohur dikë për tri vite është çmenduri.

- E kam gabim?

- Ne gatuajmë bashkë! Më ke parë ndonjëherë të gatuaj me një vajzë?

- Aha! E po, nëse gatuani bashkë, - Eshtoni i ra me pëllëmbë banakut, - pse nuk e the këtë që në fillim? O Perëndi. Mario! Dy nga birrat më të mira që keni, *por favor*. Xhulsi ynë po gatuan me një vajzë. Ka harruar këshillën më të mirë që na ka dhënë ndonjëherë Oscar Wilde. Mario, a po më dëgjon? Se me siguri që Xhulsi nuk po dëgjon. Një burrë mund të jetë i lumtur me çdo grua, - tha Eshtoni, - për sa kohë që ai nuk e dashuron.

∞

Si fillim, ata pinë nga një teke vodkë me portokall. Kur ishin paksa të dehur, Jozefina e pyeti a kishte tigan për të skuqur. Ajo do të tentonte t'i gatuante darkën.

Te ushqimorja *Pavilions* në Santa Monica (ku ata u gjendën rastësisht) ajo u habit nga çmimet e larta dhe mollët e shndritshme. Ata blenë biftek, patate të skuqura në një qese, dhe një përzierje për sallatë.

Harruan të blejnë: salcë për sallatën, gjalpë, vaj.

Edhe një gjë tjetër: kripë.

- Nuk ke fare kripë? - pyeti Jozefina duke rrëmuar te raftet e kuzhinës së tij.

- Na duhet?

- Pa kripë, nuk ka jetë, - tha ajo. - Si ka mundësi që Zoti Di Gjithçka nuk e di këtë? Si i ha kokoshkat ti netëve?

- Shkoj te kinemaja “Arclight” në bulevardin “Sunset” dhe blej kokoshka. Dhe përdor trazuesin e tyre të kripës.

- Çdo natë?

- Unë nuk ha kokoshka çdo natë.

Kur ai u kthye nga dyqani për të blerë kripë, pa të cilën nuk mund të jetonin, apartamenti mbante erë vezë e prishur. Ajo e kishte lënë gazin hapur dhe kishte harruar të ndizte vatrën e sobës së gatimit. Xhuliani hapi dyert dhe dritaret.

- Nuk e ndjeve erën?

- Çfarë ere?

- Ata e injektojnë atë erën e tmerrshme te gazi me qëllim, - tha Xhuliani, - që të të paralajmërojnë që do të vdesësh.

- A është kjo një nga këshillat e tua të jetës? - Asaj nuk i bënte aspak përshtypje që e kishte lënë gazin ndezur.

- Mund t'i ndodhë kujt do, duhet të jesh e përgatitur. Nuk ta ka mësuar këtë mamaja jote?

- Jo. Tingëllon si ironike, duke qenë se ajo është mësuese, - tha Jozefina, - mendon që do të më mësonte si të qëndroja gjallë.

- Po, është një nga parimet e para. - Xhuliani gjeti një temë për buletin e tij të mëngjesit të nesërmen. “Parimet e Para”. Pa dyshim që asgjë nuk ishte aq e njohur sa të ishte njohuri e zakonshme. - Mamaja jote nuk gatuan?

- Mamaja ime është kuzhinieri fantastike, - u përgjigj Jozefina. - Ajo kultivon perime në oborrin mbrapa shtëpisë sonë, e gatuan vetë bukën, ka erëza të freskëta, madje mund të shkruante një libër kuzhine, kaq e mirë është.

- Nuk të mësoi kurrë asnjë gjë për aromën e vdekjes?

- Jo, sepse nuk më linte asnjëherë pranë vatrave të gazit. Mamaja ime, - tha Jozefina, - kujdesej për gjithçka. Unë kërceja mambo derisa ndieja dhimbje dhe haja ushqimin e saj. Do një teke tjetër? - Ajo i dha gotën para se ai të përgjigjej.

Xhuliani rrinte si teveqel pranë sobës së ftohtë. Jozefina ishte gjysmë e zhveshur. Ajo kishte veshur tanga dhe një nga kanotierat

e tij. Flokët i kishte të shpupuritur, sikur sapo ishte ngritur nga krevati. Ku ishte kutia e vogël e zezë? Ai zgjati dorën dhe e preku në xhep.

- Ata duhet të vënë aromën e vdekjes në vetë vdekjen, - tha Jozefina dhe trokitën gotat, - për ta dalluar më lehtë.

Në vend që të fshinte gojën e saj, ajo e la të puthte vodkën portokalli të errët nga buzët e saj. - Të jetë e integruar, si një sulm vdekjeprurës, - tha ajo dhe qeshi nën hundë. - Në këtë mënyrë të gjithë do ta dinin në moment se çfarë i priste.

- Ti do e doje këtë?

- Të dija se kur do të vdisja? Sigurisht, - tha ajo. - Kush nuk do të donte?

- Përveç kësaj, - tha Xhuliani duke u ulur në njërin gju, - ata injektojnë një aromatik në gaz përpara se ai të kalojë nëpër tuba. Vezët janë aroma jote e vdekjes.

- Dhe kjo nuk është shaka. Çfarë po bën?

Ai i mori dorën. - Jozefina, dua të të them diçka, - tha ai, - dua të të them për herën e parë që u takuam. Ti po qëndroje te muri si një siluetë, ndriçuar nga dritat rozë. Kishte filluar të binte shi, dhe burri me të cilin ishe nuk po shqetësohej për të të gjetur një çadër. Kështu ti qëndrove nën shi e vetme. Ti ishe një e panjohur për mua, por gjithçka që doja në atë moment ishte të kisha të drejtën të thërrisja emrin tënd dhe të të ofroja çadrën time. Unë jam një djalë i zakonshëm dhe mendoja se djemtë e zakonshëm nuk bien në dashuri duke qenë gjithë kohës me dorën në gjoks e të rënë në gjunjë. Asnjëherë nuk u zbraza plotësisht, por gjithashtu asnjëherë nuk u tejmbusha, - Xhuliani bëri një pauzë. *Sepse e vetmja gjë që më mbushte u largua prej meje, dhe asnjë gjë tjetër nuk mjaftonte, as dashuria.* - Por në atë moment, - vazhdoi ai, - kur mbete vetëm te muri, i kërkova Zotit që të kisha mundësi një herë në jetë të dija se çfarë do të thoshte, çfarë do të thoshte, me të vërtetë, të doje dikë tjetër.

- Kjo është ajo që kërkoi edhe unë, - tha ajo. Dora e saj e shtrënguar brenda dorës së tij.

- Jozefina, *të dua.* - Ai hapi kutinë e zezë. - A do të martohesh me mua?

Heshti e shushatur, me sytë plot shkëlqim. - Ti dëshiron të martohesh me mua? - tha ajo. - Pse? Unë nuk kam takuar as mamanë tënde. Ajo do të më urrejë. Ti nuk ke takuar mamanë time. Ajo me siguri do të të urrejë ty.

- Nuk ka të bëjë me ato, por me ne. Me ty dhe mua.

Ajo qau. Përgjigjja e saj ishte, po. Dora e saj vazhdonte ta shtrëngonte dorën e tij.

Xhuliani pa diellin gjatë ditës së tij që e mori për natë, dhe të gjitha kometat teksa flakëronin për poshtë, sytë e planetëve si flakë, e gjithë botë në flakë, jo e ëmbël, as nostalgjike apo e butë, por një oqean, i tërbuar nga dallgët e një zemre njerëzore teksa përplasej me një tjetër.



Nga Redaksia e

Zotit Di Gjithçka

Vëllimi 11, Numër 225



Parimet e para

*Së pari, një pyetje rreth gravitetit. Nëse graviteti vërteton se universi është krijuar mbi parime shkencore, atëherë kush e krijoi Gravitetin? Para se të kishte çështje, duhej të kishte një ligj që rregullonte çështjen.
Pse?*

Era e vezëve të prishura në shtëpinë tënde është një paralajmërim. Kontrolllo sobën me gaz, kontrolllo furrën tënde.

Kur veza bie në dysheme dhe thyhet, kjo ndodhi, nuk mund ta kthesh mbrapsht, nuk mund ta zhbësh. Kështu është e gjithë bota. Dikur një vezë, tani një rrëmujë në dysheme.

Pa vezë, nuk do të kishim shumë gjëra që piqen, por çfarë është një vezë përveçse një pulë e palindur? Kështu që ajo që është pulë në biskotat e tua.

- *Hile për shpenzimet: Nëse nuk mund të përballosh dy prej tyre, nuk mund të përballosh njëren prej tyre.*

- *Hile për vodkën: Vodka shërben për shumë gjëra, përveçse për ta pirë. Ilaç kundër insekteve. Forcues për lëkurën e kokës. Qetësues kundër dhimbjeve. Por më së shumti është e mirë për t'u dehur.*

- *Hile për gramatikën: Koha e tashme përdoret për të përshkruar fakte të përjetshme, akte të përjetshme.*

- *Hile për jetën: Kur dëgjon thundrat, mendo se janë kuaj, jo zebra.*

- *Hile themelore: Ligji i anasjelltë i rëndesës do të thotë se shtrirja e tërheqjes gravitacionale është e pafundme.*

TOSTI I TURPIT

ATA ISHIN NË APARTAMENTIN E ZAKIJAS. ISHTE KOHË dreke.

- Ndonjëherë, kur jam duke ngordhur për bukë, - tha Jozefina, - unë bëj një gjë mahnitëse. Të kam thënë për të. Dhe e quaj *tosti i turpit* i Jozefinës.

- A i bën të gjitha tostet e tjera “t’iu vijë turp”? - Ai zbardhi dhëmbët.

- Bën çdo gjë tjetër në botë t’i vijë turp. Është një përzierje e guximshme karbohidratesh dhe dhjami. Mos u shqetëso. Nuk ka nevojë për gaz, - tha ajo dhe e puthi. - Po mos i thuaj Z-së për këtë. Ajo mendon se është një ushqim i neveritshëm.

- Oh, do t’ia thosha menjëherë nëse do e shihja sërish, - tha Xhuliani. - Ajo *do të vijë* në dasmën tonë, apo jo?

- Ti të bën për të qeshur, - tha Jozefina dhe i shkeli syrin. Ajo mori pak bukë nga frigoriferi dhe pak gjalpë nga rafti i kuzhinës.

- Mendoj se i ke ngatërruar vendet e këtyre dy ushqimeve, - tha Xhuliani, duke u shtrirë mbi tavolinë dhe duke e vështuar.

- Jo. Gjalpi duhet të jetë i butë, dhe buka nuk duhet të jetë jeshile, me myk. Prandaj e bëj këtë. Por e sheh sa të holla janë fetat e bukës? Është shumë e rëndësishme që të jenë të holla.

- Sigurisht, - tha ai. - Në Hollivud duhet të bëjmë gjithmonë kujdes kur vjen puna te beli.

- Pikërisht. Në rregull, ti thek bukën, madje dy herë nëse është e nevojshme, derisa të bëhet shumë krokante. - Ata pritën derisa u thek buka. - Vendosi shumë gjalpë, deri te koret, - tha dhe nxori nga frigoriferi një kuti plastike me sallatë patatesh.

- Për sa kohë ka qenë *ajo* aty?

Ajo i mori erë. - Patate është. Ç' do të pësojë?

- Nuk ka vetëm patate, - tha Xhuliani, - ka dhe *majonezë*.

- Ti shqetësohesh shumë. Në rregull është. Përhape mbi bukë sallatën me patate...

- Ka ca pikla brenda në të. - Ai iu afrua nga mbrapa, duke e parë me kujdes pas supeve të saj teksa punonte.

- Është piper, - mendoj. - *Shpresoj*. Gjithsesi, e përhap sallatën mbi fetën e bukës, pastaj nxjerr djathin çedar, sa më i fortë aq më mirë dhe ia grin sipër, në këtë mënyrë, i hedh pak më shumë piper dhe më pas i vendos fetën tjetër sipër dhe e shtyp me pëllëmbën e dorës, kështu, dhe në vijim, ma merr mendja e pret përgjysmë nëse jeni dy veta, ndërsa po të ishte vetëm, thjesht do e merrje, do e fusje në gojë dhe...

Ai e pa teksa ajo, me sytë të mbyllur, gllabëroi gjysmën e saj të tostit *të turpit*.

- A do ta hash gjysmën tënde apo thjesht do të rrish aty? - pyeti ajo.

- A do ti që unë të ha gjysmën time?

- Nëse dëshiron. Është e vetmja gjë që gruaja jote e ardhshme di të bëjë, kështu që bën mirë të provosh qumështin para se të blesh lopën, mendoj.

Duke qëndruar pranë lavamanit, ai e hëngri teksa ajo e shihte me zili.

- Jo keq, - tha ai dhe fshiu gojën.

- Por veçse jemi ende të uritur, - tha ajo, - dhe nuk ka mjaftueshëm sallatë patatesh për një tjetër. As djathë. As bukë.

Ai e drejtoi për tek dhoma e gjumit. - Shko bëj një dush shpejt e shpejt dhe do të të çoj te *Factor's Deli*, ku mund t'u kërkojmë ta bëjnë si sandviç me porosi. Ku i dihet, ndoshta do të bëhet kaq i njohur sa do e vendosin në tabelën e specialiteteve të ditës. *Tosti i Turpit i Jozefinës*. Ngjitur me atë të Steve Martin. Por nxito. Se duhet të shkojmë edhe te *Country Club* për të provuar tortën e dasmës para orës që duhet të jesh në punë. Dhe unaza jote, më në fund, është gati. - Unaza që ai i kishte blerë ishte katër masa më e madhe. Nga ta dinte që kishte duar kaq delikate. Nga frika se mos e humbiste, ajo nuk e vinte kurrë.

Ata kishin shumë gjëra për të bërë atë pasdite përpara se *Paradise* të fillonte. Ata duhet të zgjidhnin unazat e martesës, dhe të gjenin një bandë muzikore që shkonte nëpër dasma. Kishin një takim për të provuar tortën, duhet të merrnin një kostum me qira, oh... dhe ajo ende nuk kishte një fustan. Kishte bërë plane të shkonte për pazar me Zakijan javën e kaluar, por nuk shkoi. Supozohej që sot ata do të mbaronin disa punë nga lista e gjatë e Xhulianit, por kur arriti te shtëpia që ta merrte, ajo ende flinte. E zemëroi pak fakti që ajo nuk ishte bërë gati, derisa ia bëri me shenjë që të shtrihej në shtrat me të. Tashmë kishin kaluar dy orë, dhe kishin kohë vetëm për të bërë një *tost turpi* dhe të provonin tortën e dasmës.

Teksa ajo bënte dush, Xhuliani u ul në karrigen pranë dritares me pamja nga rruga dhe i hodhi një sy listës së gjërave që duhet të bënte. Çdo ditë lista bëhej më e gjatë, teksa koha bëhej më e shkurtër. Duheshin përzgjedhur lulet, duhej shkuar në bashki për të aplikuar për certifikatë martesë. Duhej të zgjidhnin një listë dasme, me preferencat e dhuratave të miqve të tyre. Të vendosnin ku do të shkonin për muaj mjalti. (Ai: Hawaii? Ajo: Londër?) Të blinte këpucë të përshtatshme që ajo të mund të kërcente.

Rruga “Normandie”, teksa shkon për në qendër, ka një malore të shkurtër pasi kalon rrugën “Clinton”, por përveç kësaj është e drejtë dhe e sheshtë si pistë. Në anën veriore të nxjerr në *Hollivud Hills*. Palma të gjata ngjyrë kafe vijëzojnë trotuaret si shtylla telefoni.

Është plot diell.

“Normadia” është rrugë kryesore. Një milion makina kalojnë gjatë gjithë ditës dhe natës. Fundjavat janë veçanërisht të zhurmshme. Ditët e javës janë më të qeta. Sot është ditë jave.

Latinët lajnë makinat e tyre shkatarrake, ujisin petuniat e verdha dhe azaleat e kuqe, fshijnë rrugën.

Prapa shtëpisë së Zakijas, me ballkonin me petunia të verdha dhe azalea të kuqe, zhurma e autostradës nuk ndalet kurrë. Dhe në anën tjetër të rrugës ndodhet shtëpia e rrethuar me tela me gjemba. Edhe kur Xhuliani nuk e ka mendjen te bota, por te vajza, ai e sheh me bisht të syrit. Edhe tani, kur po numëron minutat e mbetura dhe

punët që ka për të mbaruar, pesha periferike e asaj shtëpie arrin t'i shkaktojë njëfarë ankthi në stomak, ku gjen strehë dhe gërvisht.

Teksa merr bllokun e shënimeve për ta vendosur në prehër, Xhuliani ia nguli sytë shtëpisë ndërtuar me tulla. Rrethohet nga një gardh telash me gjemba; ka një portë nga mund të hyjnë vizitorët, hekura te dritaret, te dyert, pra hekura përmbi hekura. Dhe tela me gjemba.

Gjatë ditës, ndërtesa dykatëshe duket si... fortesë. Sikur kishin grumbulluar aty të gjitha shufrat e arit që nuk i nxinin dollapët e pisët në korridoret e Fort Knox, ose gjysmën e furnizimeve të kokainës nga Medelini për Kaliforninë e Jugut.

Sikur çfarëdo që të ketë aty brenda, askush nuk do të donte të zvarritej sipër gardheve dhe ballkoneve për ta marrë.

Çfarë ka aty?

Kush jeton aty?

Teksa Xhuliani po mendohej për këtë, një tip i çuditshëm, me prejardhje racash të përziera, doli nga shtëpia e "gangsterëve". Me atlete me qafë, xhinse që vareshin, dhe një bluzë të gjërë të *Lakers*, djali mbylli derën pas tij, futi pistoletën gjysmë-automatike mbrapa, te rripi i pantallonave, kaloi në anën tjetër të rrugës dhe ngjiti shkallët e Zakijas.

Xhuliani mbylli bllokun e shënimeve.

U dëgjua një trokitje në derë.

Ai u ngrit. Uji i dushit vazhdonte të rridhte.

Trokitja u përsërit, këtë radhë më këmbëngulëse.

Kur hapi derën, Xhuliani u ndesh me një djalosh zeshkan me trup mesatar, rreth të njëzetave, me sy të mëdhenj, gërshet të trashë të çrregullt, tatuazhe, vathë dhe bizhuteri të shndritshme. Rripi që mbante xhinset e tij *Levi's*, si dhe pistoletën e tij, ishte i markës *Gucci*. Lidhëset e atleteve të tij me qafë, ishin ngjyrë e kuqe e ndezur.

- Përsëritet, - mërmëriti. - Ç'bëhet?

- Përsëritet, - tha Xhuliani me dorën e djathtë të shtrënguar, dhe ktheu trupin majtas, ndërsa dora e majtë shtrëngonte dorezën e derës. Asnjë nga këto nuk kaloi pa u vënë re nga z. Gërshet.

- Jemi në rregull? - pyeti ai.

- Ti më thuaj, - tha Xhuliani.

- A është JoJo këtu?

- Do të thuash Jozefina?

- Po. Saktë. Jozefina.

Uji në dush vazhdonte të rridhte. Xhuliani nuk donte t'i thoshte këtij gangsteri me shikim të vrazhdë, më fal, ajo nuk mund të vijë tani te dera se është lakuriq.

- Ajo është e zënë tani. Do t'i them që erdhe.

Djali e pa Xhulianin nga koka te këmbët, vlerësoi qëndrimin e tij luftarak, vështrimin e tij të ftohtë.

- Unë jam Popa W., - tha djali i ri dhe e pyeti: - Kush je ti?

- Xhuliani.

- Në rregull, Xhulian. Shihemi më vonë. Mos harro t'i thuash që erdha.

- A e di ajo se për çfarë bëhet fjalë?

- Po, po, ajo e di se për çfarë bëhet fjalë.

Xhuliani e pa Popa W. t'i zbriste shkallët duke i kapërcyer dhe të kalonte përtej rrugës, ku u fut në veturën e tij të bollshme ngjyrë ari me dy marmita të mëdha, ngriti volumin e magnetofonit të tij të fuqishëm në maksimum, dhe me këngën e Dr. Dre *Nothing but a G Thang* që dëgjohej nga altoparlantët e makinës me volum të lartë, i dha gaz dhe u zhduk.

Gjatë jetës mund të ndodhin gjëra që nuk i ke parashikuar. Një fundjavë mund të shkosh për kamping me një shok, ashtu si ke shkuar njëqind herë të tjera, vetëm se këtë herë nga qielli bien gurë dhe ndryshojnë rrjedhën e jetës sate. A e dije që kampingu ishte një përpjekje kaq e rrezikshme? Në një moment ke planet e tua në kokë, dhe momentin tjetër mezi merr frymë.

Ajo doli nga dhoma e gjumit mbështjellë me një peshqir, duke buzëqeshur dhe duke kënduar nën zë, aspak gati.

- Jozefinë, kam dashur të të pyes, kush jeton aty? - Xhuliani drejtoi gishtin përtej rrugës. Ai e përmbajti veten të mos e thërriste gruan me të cilën ishte gati të martohej me nofkën e një burri tjetër.

- Pse duhet ta di ? - Ajo po thante flokët. Pak më vonë, pyeti: - Pse?

- Sepse një djalë i quajtur Popa W. sapo doli që andej, trokiti në derën tënde dhe pyeti për ty.

Jozefina bëri një pyetje të pajustificueshme. - Cilën derë?

A po mendohej t'i jepte vetes kohë?

- Nuk e di si t'i përgjigjem kësaj pyetjeje. Derën e përparme të apartamentit tënd.

- Nuk është apartamenti im.

- I Zakijas atëherë. Për cilën derë mendove se e kisha fjalën? - tha Xhuliani vetullngrysur. Madje dhe zemra e tij u ngrys. - Mendove se e kisha fjalën për derën e dushit?

- Jo, - ajo ndaloi së thari flokët. - Çfarë kërkonte ai?

- Nuk tha gjë. Ai thjesht kërkoi JoJo-në.

Ajo kapsiti sytë. - Kështu më thërret ndonjëherë. Çfarë i the ti?

- I thashë që ishe e padisponueshme.

- Pse e the këtë?

- Sepse nuk ishe e disponueshme. A ishe? Dhe sepse nuk doja t'i thosha që ishe në dush. Nuk kam pse të shpjegoj se pse nuk doja t'ia thosha këtë, apo jo?

- Uf, Xhulian.

Uf, Xhulian?

- Çfarë *duhet* të kisha thënë?

- Nuk e di. Ti je Zoti Di Gjithçka, - ajo nuk po e shihte në sy. - Ai është shoku i Z-së, në rregull?

- Në rregull, - Xhuliani pohoi me kokë. - Vetëm se ti the që nuk njihje dikë përtej rrugës.

- Kur e thashë këtë?

- Me kuptimin e plotë të fjalës, sapo.

- Është e vërtetë, unë nuk njoh njeri. Z. njeh disa persona. Trevori shoqërohet me Popën. Unë e njoh nëpërmjet Z-së. I kam borxh disa dollarë.

- Ti i ke para borxh atij djali?

Ajo mblodhi supet. - Nuk ka gjë, ai është një shok.

- Ti sapo the që nuk e njihje.

- Xhuls, lëri këto tani. Mendoja se do të dilnim. Mendoja se kishim shumë gjëra për të bërë.

- Ke të drejtë, - tha ai ngadalë. - Kemi. Por ti ende nuk je veshur.

- Nuk mund të vishem kur ti je duke më marrë në pyetje.

- Nuk po të marr në pyetje, - tha ai. - Kjo nuk është marrje në pyetje. Ky është shqetësim i arsyeshëm. Kuriozitet normal. Por gjithashtu... - Xhuliani u mundua ta mbante tonin e zërit sa më normal... - Dua që të jesh e sinqertë me mua. Nëse e njeh, e njeh. Nëse i ke para borxh, i ke para borxh. Por kur fillon duke më thënë që nuk njeh askënd përtej rrugës dhe rezulton se një tip që nuk e njeh të thërret JoJo, më bën të dyshoj për gjërat që më thua për të.

- Është thjesht një nofkë idiote, - tha ajo. - Unë nuk të gënjeva. Nuk e dija për kë shtëpi e kishe fjalën. Ka shumë shtëpi përballë rrugës. Ti nuk ma specifikove.

- Po, është e rëndësishme të jesh specifik, - Xhuliani mori frymë. - A të kam thënë ndonjëherë që nuk më pëlqejnë armët? Asnjëherë nuk më kanë pëlqyer. Është njësoj si të mbash vdekjen në duart e tua.

- Ndoshta është vdekja ajo që nuk të pëlqen, - tha ajo, pa buzëqeshur.

- Kjo është arsyeja pse të pyeta kush jeton matanë rrugës, - tha ai. - Një gur që bie nga qielli teksa je duke shëtitur në mal nuk është një rrezik i parashikueshëm. Por, të shtënat e pistoletës, janë. - Ai bëri një pauzë. - Sidomos kur jeton në një zonë ku grumbullimi, zemërimi, hakmarrja dhe gjakderdhja është monedha me të cilën bandat shkëmbejnë jetët e tyre.

- Unë nuk jetoj këtu, - tha ajo, - dhe po e bën qimen tra. Të ra ndonjë gur në kokë ty kur po shëtisje?

Xhuliani nuk iu përgjigj.

- Ai erdhi të të shihte teksa mbante një pistoletë gjysmë automatike të futur në rrip dhe të kërkoi me emër.

- Edhe? Ai është shoku i Z-së. Ndonjëherë rrimë bashkë, tymosim pak mariohanë. I thashë që do i jepja para për mariohanën dhe harrova. Dhe ai mban pistoletë me vete kudo që shkon. Vetë sapo the që nuk është i sigurt.

- Unë nuk thashë që ai nuk është i sigurt. Nuk më bëhet vonë për të.

- Nuk është ndonjë gjë. Më beso... është më pak se asgjë. A mund të shkoj të bëhem gati?

- Po, JoJo. Shko bëhu gati.

Ajo ditë ishte dita e parë që ata nuk ishin në gjendje aq perfekte, më pak se çfarë supozohej të ishin dhe çfarë duhej të ishin. Xhuliani vazhdonte të mendohej të rikrijonte në mendjen e tij momentin magjik, natën më të ngrohtë ndezur nga yjet më të shndritshme, vendin ideal për t'u ulur nën jargavanët më të çelur në restorantin më romantik. Ata nuk kishin shkuar më në kodrat e Santa Monica-s, nuk kishin ngjitur shpatet e pjerrëta, kristali në formë loti nuk ishte nxjerrë më kurrë nga çanta e saj, nuk kishte pushuar më kurrë në pëllëmbën e dorës së saj. Ai e nxori një herë gurin kur ajo po flinte dhe u ndje shumë i shqetësuar. Kur e preku e bëri të ndihej i rënduar nga brenda, jo mirë. Një ngarkesë elektrike gumëzhiti nëpër trupin e tij përsëri, një shok i nivelit të ulët.

Ata u bënë shumë vonë për të shkuar të provonin tortat, apo për të zgjedhur një fustan nusërie. Ata nuk mundën të provonin unazën prej diamanti që ajo nuk e kishte vënë ende, një unazë që ai e kishte mbajtur në xhep që javën e parë që e kishte njohur. Ata u pajtuan, por asgjë nuk mund të ishte perfekte në një ditë kur Popa W. priste që ajo të zvarritej poshtë telit të tij me gjemba dhe të trokiste në derën e tij.

Gjatë momenteve të tyre pasionante, ndonjëherë Xhuliani ishte kaq i mbingarkuar saqë i dukej sikur virtyti i saj mund ta lëndonte, por tani ai pyeste veten nëse po përdorte fjalën e gabuar për atë gjë që mund ta lëndonte.

Në krahët dhe këmbët e saj të bardha, ai kishte gjetur llojlloj premtimesh, të gjitha premtime të mira. Kur dora e tij ishte poshtë kokës së saj, ajo ishte më shumë se Kalifornia, më shumë se Amerika, më shumë se deti. Ajo ishte thjesht më shumë. Ajo ishte gjithçka, ishte më shumë se ç'donte ai. Ai nuk kishte ndër mend të largohej nga ajo. Pavarësisht çdo gjëje, pavarësisht sa herë Popa W do të trokiste në derën e saj. Ata do të putheshin pa mllef dhe do të martoheshin pa bërë asnjë skandal. Ajo nuk kishte nevojë që i dashuri i saj t'i binte harpës për ta nxjerrë atë nga ferri. Zëri i saj i ëmbël dhe joshës mund të magjepste vetë Hadesin, perëndinë e vdekjes në mitologjinë greke, që ta linte të lirë pa ndonjë ndihmë nga Xhuliani.

Jozefina. Çdo orë që kishte tingëlluar ndonjëherë mbarte emrin e saj. Ajo ishte zilja që binte në çdo kullë. Ajo ishte dita e shtatë e pushimit në çdo javë.

Xhuliani nuk ishte në vete, por nuk donte t'ia pranonte asaj, apo kujtdo. Duke buzëqeshur, ai e la veten e tij të fshehur, duke pritur që ajo ta bënte të ndihej më mirë, që të ndreqte gjërat. Por ajo nuk e bëri asnjëherë. Në fund, kjo e bëri Xhulianin të ndihej më mirë. Nuk ka asgjë që ajo duhet të rregullojë, tha ai për të ngushëlluar veten dhe vazhdoi, duke pritur që ajo të konsumohej nga detajet e këpucëve dhe bizhuterive, e vellove dhe luleve, nga ngjyra e pecetave dhe radhitja e këngëve. Ajo kohë nuk mund të vinte më shpejt, ndonëse dasma po afrohej shumë shpejt. Ajo ndaloi së kënduari me kënaqësi nën zë sa herë që ai i jepte dashuri, dhe ai ndaloi së trokituri me gëzim kur ishte në timon teksa largohej nga ajo për t'u marrë me gjithë gjërat për të cilat ajo ishte shumë e zënë.

Xhuliani filloi të vinte re gjithë të metat e tij, dhe sa here e pyeste nëse kishte diçka që nuk shkonte, ajo thoshte jo, dhe ai nuk kishte fuqi për t'u zënë, për shembjen e një jete më se intensive dhe flakëruese.

Jargavanët lulëzonin jashtë teksa ai numëronte minutat derisa ajo do të bëhej, më në fund, gruaja e tij, por gjendja e vështirë në të cilën ndodheshin nuk po venitej apo mbaronte. Një ditë ai e pyeti a donte që të shkonin me makinë në Palm Springs dhe ajo u zemërua me të. A je i çmendur, tha ajo, po gjithë gjërat që duhet të bëj; vaska ka zënë myk, dy audicione për të kaluar, mesha ku më duhet të shkoj patjetër, për t'u lutur për arritjen time të madhe, dhe Z do të bëjë një tatuazh, kush do ta ndihmojë, ti? Duke mos dashur të dëgjojë “të thashë” dhe duke mos pasur dikë për të folur, Xhuliani i konsideroi si nerva ankthi para dasme dhe e mbajti veten të zënë me detajet, duke hedhur hapat ngadalë, duke numëruar minutat, duke kryer punët sipas rendit, duke besuar me gjithë zemër që ai dhe ajo ishin më shumë se lodra Zotësh, duke besuar që ato që ajo mbante në duar ishin unaza martese, jo kunjja granate.



Nga Redaksia e

Zotit Di Gjithçka

Volumi 11, Numër 246



Ditë e bukur për një martesë të bardhë

*Organizimi është pika kyç.
Nuk ia vlen të zihesh për asgjë.
Lëre vajzën në rrugën e saj.
Ajo kërkon të shkojë në një lokal
me ëmbëlsira vjeneze? Bukur.
Thuaji se si shkëmbim
do t'ia vësh ti emrin fëmijëve tuaj.
Mos harroni të bëni gati valixhet
për muajin e mjaltit para natës
së dasmës, ose t'i përgatitni ditën
e dasmës. Nuk e kam fjalën
në mënyrë metaforike.*

*Dhe njëra është kaq e thjeshtë
sa nuk besoj se duhet ta them,
por:*

*Mos bëj asgjë në festen tënde
të beqarisë, se ajo do të kërkojë
divorc. Të gjithë e dini se ç'është.
Mos e bëj.*

*Mos përdorni lule delphinium
si lulen e dasmës suaj. Të gjitha
pjesët e kësaj bime janë helmuese
për njerëzit, veçanërisht farat.*

*Fërkoni me letër smerili shollat
e këpucëve që të mos rrëshqisni dhe bini.*

*Raporti i festës me fotografitë duhet të
jetë 90 me 10. Nuk mund ta jetosh dhe ta
regjistroh njëkohësisht.*

*Mësoni disa lëvizje të thjeshta vals.
Ose më mirë akoma, mësojini
ato së bashku. Do të dukeni shkëlqyeshëm
në video.*

*Fusni një pako shami hundësh
në xhepin e kostumit tuaj. Dikush
është i detyruar të qajë, dhe ju do të dukeni
si një kalorës.*

*Blije, mos e merr me qira fustanin
e martesës. Ose do të pendohesh
për të gjithë jetën.*

*Vendoseni në frigorifer një pjesë nga torta
e dasmës suaj, në mënyrë që të keni
një copë në përvjetorin tuaj të parë.
Rimel të padepërtueshëm nga uji.*

*“Libri i jetës fillon me një burrë
dhe një grua në një kopsht”.
Oscar Wilde.*

ÇARLI VDIQ

ISHTE MËNGJES HERËT DHE ESHTONI PO PUNONTE, duke ndihmuar një grua të ngazëllyer dhe burrin e saj kokëfortë, të ngarkonin një komplet tavoline ngrënieje të serisë *Bonanza*, në makinën tip *Escalade* të çiftit, kur një *Hyundai* e pluhurosur ngjyrë jeshile parkoi dhe nga dera e makinës doli Zakija Job, me pamje zyrtare si ndonjë drejtoreshë. Madje dhe flokët e saj të çrregullt i kishte lidhur topuz. Eshtoni e injoroi duke vazhduar punën, për ta siguruar mirë tavolinën që të mos lëvizte, por kur mbaroi ajo ishte akoma aty, duke qëndruar si statujë ngjitur makinës së saj.

Mos vallë duhet të shkonte ai tek ajo? Ai donte të ecte me hapa të mëdhenj dhe të rikthehej në dyqanin e tij e ta linte atë të merrte drejtimin. Ajo vetë kishte ardhur buzë trotuarit të tij me makinën e saj të vjetër. Pa bërë asnjë përpjekje për të përmbajtur psherëtimën e tij të bezdisur, Eshtoni filloi të ecte drejt saj, por u pendua menjëherë kur pa nga afër shprehjen e saj mosmiratuese. Me siguri një shtrëngim i neveritshëm duarsh do të pasonte. Ai kishte veshur bluzën e tij të preferuar me mëngë të shkurtra, ku në pjesën e përparme ishte stampuar shprehja LËPIRJE FALAS.

- Përshëndetje! - tha ajo në mënyrë formale.

- Përshëndetje... - Eshtoni tundi dorën duke e rrotulluar dhe duke u shtirur sikur kishte harruar emrin e saj. - Kazijah? - Ajo kishte veshur një kostum ngjyrë blu të errët dhe këpucë me takë të ulët. Bluza e saj e bardhë me pala i vinte deri te qafa. Nuk kishte bërë tualet, vetëm një të kuq në buzë dhe rimel të zi.

- Nuk e kam emrin Kazijah, - tha ajo, tashmë e zemëruar, - Zakija.

- Ashtu e thashë. Ç'kemi?

- Kam nevojë të flas me ty. Shokët tanë janë në telashe. Duhet t'i ndihmojmë. Nuk e di sa interesohesh ti për shokun *tënd*, por unë interesohem për *timen*.

Ajo që nuk i *interesonte* Eshtonit, ishte mënyra se si u shpreh ajo. Duke mbuluar fytyrën nga dielli i mëngjesit që ndriçonte përgjatë bulevardit "Magnolia", ai ankohej për mungesën e syzeve të diellit, duke uruar që njëri nga prindërit e tij jo të mirë t'i kishte mësuar si të fshihte padurimin.

- Çfarë ka ndodhur?

E skuqur dhe e djersitur nga vapa e madhe, Zakija bënte fresk me një hartë udhëzuese të *Disneyland* dhe nuk u përgjigj.

- Do të vish brenda... *për një sekondë*? - Ishte premtuese të ishte një tjetër i përvëlur nga dielli.

- Mirë, - tha ajo. - Por vetëm për një sekondë, jam rrugës për në punë.

- Unë jam aktualisht *në punë*, - tha Eshtoni.

Mbyllja e ngadaltë e syve të saj ngjasonte me një të gërhitur. *Pff*, dukej sikur tha. Ti e quan punë këtë? Duke luajtur me lodrat e tua? Ajo eci përpara tij. Kur hyri brenda në dyqanin e tij mahnitës, ajo nuk tha asgjë. Dukej sikur po qëndronte brenda dyqanit të veshjeve *GAP*.

Teksa u mbështet në banakun prej xhami (për ta inkurajuar?) dhe u kthye nga ai, Eshtoni e dinte që tashmë ishte shumë vonë për një bisedë produktive. Ai ishte shumë i nevrikosur. Ai i gjykonte të gjitha krijesat njerëzore nga mënyra se si reagonin kur ndodheshin brenda dyqanit të tij, mjetit të tij të jetesës, sepse kur futeshin brenda, futeshin brenda Eshtonit, brenda shpirtit të tij thesargjurmues. Dhe kur trajtonin pasuritë e tij sikur të ishin një hiç... posterit i firmosur nga Bob Marley i famshëm, ku shkruheshin fjalët e tij të fundit ("Paratë nuk mund të blejnë jetën") ... ata po trajtonin Eshtonin sikur të ishte një hiç. Dhe askush nuk reagonte mirë ndaj kësaj, më së paku nga të gjithë ai, më i dashuri nga meshkujt, por me një krenari luani.

- A do të më thuash apo duhet ta marr me mend? - pyeti ai.

- Mos u sill kështu.

- Mos më thuaj çfarë të bëj.

Zakija ngriti dorën për ta ndaluar, gjë që e irritoi akoma më shumë. Ai ngriti dorën e tij drejt saj. Ajo e uli të vetën.

- Ke ndër mend të dëgjosh apo të nxelesh? - pyeti ajo.

- Pse duhet të zgjedh? - Për të vendosur pak distancë ndërmjet tyre, Eshtoni shkoi pas banakut, nxori celularin dhe filloi të kontrollonte *email*-in e tij.

- A e dije që po planifikojnë të *martohen*? - dëgjoi Zakijan të fliste me një zë të lëkundur.

Toni i zërit të saj e zbuti pak. Ajo ndihej njësoj si ishte ndier ai kur e kishte dëgjuar këtë për herë të parë. Njësoj si ai ndihej ende, për të qenë të sinqertë. Por Eshtoni nuk do ia pranonte këtë asaj. Ai nuk i ngriti sytë nga celulari. - Sigurisht që e di. Unë jam shoqëruesi kryesor i dhëndrit. Pse po sillesh sikur e more vesh?

- Sepse dje e mora vesh.

- Ou! - Eshtoni lëshoi një si gërhimë. - Dasma është pas tri ditësh dhe ti *sapo* e more vesh?

- Ti nuk po kupton, - ngriti zërin Zakija. - Ajo nuk më tha! Unë jam shoqja e saj e ngushtë dhe ajo nuk më tha asgjë. Mendon se kjo është normale?

Duke shprehur mirëkuptim në heshtje, Eshtoni uli poshtë celularin e tij. - Dëgjo, do e pranoj, edhe unë isha i mërzitur në fillim, - tha ai. - Por Xhuliani nuk është fëmijë dhe nuk është fëmija *im*. Është punë e tyre se çfarë bëjnë. Puna ime është të qëndroj krahi tij. Ti çfarë do të bësh?

- Në asnjë mënyrë, - tha Zakija. - Unë duhet t'i ndaloj ata.

- Paç fat në lidhje me këtë. Por unë nuk mund të ta mbaj anën në lidhje me këtë.

- Pse po të kërkoj të më mbash anën?

- Nuk e di çfarë po kërkon, - tha Eshtoni. - Por duhet të shkoj në një takim, kështu që...

- Nëse do të doje t'i qëndroje me të vërtetë në krahi, - tha Zakija, - do të duhej t'i thoshe që nuk mund të martohet me të. Ky do të ishte veprimi i duhur nga ana jote.

Eshtoni e vëzhgoi me kujdes. Sytë e saj të mëdhenj ngjyrë kafe ishin gati të përmbyteshin nga lotët. Buzët e saj të kuqe po

dridheshin. Ai i urrente gratë që qanin, edhe gra që nuk i njihte. Gjithçka që bënte mamaja e tij dy vjet para se të vdiste, ishte të qante. Ai mbështeti pëllëmbët e duarve të tij mbi banak. - A mund të të them një shaka?

- Nuk mendoj se *mundesh*, jo.

- Çarli vdiq, - tha Eshtoni.

- Çfarë?

- Nuk e ke dëgjuar kurrë këtë?

- Dhe nuk dua.

- Është momenti perfekt që ta dëgjosh. Do e shohësh. Një burrë futet në një bar..

Zakija psherëtiu thellë.

- Një burrë futet në një bar, - Eshtoni vazhdoi përpos kundërshtimit të saj, - dhe i thotë një burri tjetër “Çarli vdiq”. Burri tjetër fillon të vajtojë. “Oh Zot, jo Çarl! Ne ishim në shkollë bashkë, luanim *stickball* bashkë, ai ishte shoqëruesi im kryesor në dasmën time, shoku im i ngushtë, çfarë do të bëj tani?” Një ditë më pas, një femër mahnitëse me gjoks të madh futet në një bar dhe i thotë të njëjtit burrë, “Çarli vdiq”. Dhe burri i thotë, “Kush është Çarli?”.

Pasi mbeti për pak si e shastisur, Zakija hapi duart. - Ti e quan këtë një *shaka*?

- Po. Një shaka mbi ne. *Ne jemi Çarli. Ti dhe unë.* - Ai u zmbrops teksa e tha. - Sa më shpejt ta kuptosh, aq më shpejt do të mund ta pranosh.

- Kjo është sinqerisht më e pakta e asaj që po mundohem të të them, - tha ajo.

- E di se çfarë po më thua. Ti mendon se ai nuk është i duhuri për të.

- Jo, - tha Zakija. - Mendoj se *ajo* nuk është e duhura për të.

Eshtoni u surprizua. Megjithatë, ai vazhdoi. - Ajo ka rënë në dashuri, dhe ti nuk je pjesë e kësaj. Martesa e saj e afërt është e vetmja gjë me rëndësi për të. Gjërat po ndryshojnë. Gjithmonë ndryshojnë. Duhet t’i përballosh vetë problemet e tua. Askush nuk mund të të ndihmojë.

Zakija kryqëzoi duart. - Je i sigurt që e ke fjalën për mua, o gjeni?

- Absolutisht, - tha Eshtoni dhe kryqëzoi krahët e tij. - Nuk jam unë ai që kam ardhur në kopshtin *tënd* të fëmijëve për të të bezdisur me ndjenjat e mia, apo jo?

- Këto nuk janë ndjenjat e mia, janë fakte!

- Për çfarë po më bërtet mua?

- Sepse ti po refuzon ta kuptosh.

- Po të kuptoj shumë mirë.

- Nuk po më dëgjon. Dëgjo se çfarë po përpiqem të të them...

- Mos vazhdo më me sqarimet e tua, - tha Eshtoni. - Ti po ulërin.

Unë nuk jam shoku yt.

- Kjo gjë nuk ka të bëjë me mua, apo ty... nëse mund të besosh që ndonjë gjë në këtë botë mund të *mos* ketë të bëjë me ty, - tha Zakija. - Ka të bëjë me ata. Ka të bëjë me të. Jozefina nuk është...

- Atëherë shko thuaji, - tha Eshtoni duke e ndërprerë. - Për çfarë të duhem unë, për të të dhënë lejë?

- Unë fola me të!

- Mjaft bërtite.

Zakija uli zërin. - Ti mendon se nuk provova t'i flisja përpara se të vija këtu? Më beso, provova gjithçka përpara se të vija këtu. Ajo refuzoi të më dëgjonte. Prandaj kam nevojë që ti të flasësh me Xhulianin.

- Jo.

- Thuaji që...

- Jo, - ia bëri Eshtoni me aq forcë sa kishte, tundi kokën, dhe ngriti duart për ta ndaluar. - Ti nuk ke asnjë të drejtë të më thuash asgjë. Sekretet e saj nuk më takojnë mua. Nuk është detyra jote të m'i thuash mua, dhe nuk është detyra ime t'i dëgjoj. Ti po mundohesh të më vësh në një pozicion të sikletshëm dhe nuk do të të lejoj.

- Por...

- Ti je gati të më thuash diçka që unë nuk duhet ta di dhe nuk dua ta di, - tha Eshtoni. - Dhe pastaj, ose do të më duhet të mos them gjë, që si shoku i Xhulianit, nuk mund ta bëj, ose do më duhet t'ia them atij këtë bisedë fjalë për fjalë. Diçka për Jozefinën që po ma përcjell mua që t'ia përcjell atij. A nuk e kupton sa e gabuar është kjo?

- Por...

- Nëse ka diçka që ajo duhet ta bisedojë me të, duhet t'ia thotë *ajo* vetë. Kështu që boll më shpërdorove kohën.

- Ajo nuk do të dëgjojë arsyen!

- Përsëri, nuk është problemi im, - tha Eshtoni. - Është problem i tyre. Mua mos më përfshi. Nëse do e dije çfarë është më e mira për ty, as ti nuk do të përfshiheshe.

- Nuk mundem, - tha Zakija dhe mbuloi fytyrën me duar. - Ata nuk *mund* të martohen. Të përgjërohem, thjesht foli atij. Ajo është...

- Jo! - bërtiti Eshtoni. Eshtoni, i cili nuk kishte bërtitur qëkur ishte dymbëdhjetë vjeç, i cili nuk e kishte ngritur zërin asnjëherë gjatë tri viteve që ishte i lidhur me Railin, po i bërtiste një të huaje.

- Të thashë *jo*, - tha ai, më qetë, - dhe e kisha me tërë mend.

- Uau, - tha Zakija. - Thjesht uau.

- Mos vazhdo më, zonjushë, - Eshtoni i ra qark banakut. Ai ishte shumë më i gjatë se ajo, dhe nuk donte t'i afrohej më shumë se ç' duhej dhe nuk donte që ajo të mendonte se ai po mundohej ta frikësonte... Edhe pse këtë po bënte, paksa. Ai po mundohej ta frikësonte. - Mos më ofendo, thjesht ik.

- A mund të ofendosh, me të vërtetë, një burrë që ka veshur një bluzë ku shkruhet "Lëpirje Falas"? - tha Zakija, duke e vështruar, pa u sprapsur. - A ka ndonjë gjë që mund t'i thuash një burri të tillë që ta degradosh akoma më shumë?

- Ooh, a je gati të, siç thonë në fushën tënde, *përplas-derë-ik*?

- tha Eshtoni. - Mezi pres. Por a je e sigurt që ke veshjen e duhur për këtë?

Teksa ajo doli me vrull, Zakija e përplasi derën e përparme kaq fort, saqë shishja *Jeannie* nga seriali televiziv *I Dream of Jeannie*, dhe kondensatori i energjisë i personazhit Marty McFly nga filmi *Back to the Future* ranë përtokë nga vitrina.

- Fundi i aktit! - bërtiti Eshtoni mbrapa saj.

FUSHAT ME ZAMBAKË LIRI

- NUK DO TA BESOSH SE KUSH ERDHI TË MË TAKOJË sot në mëngjes, - i tha Eshtoni Xhulianit më vonë atë ditë kur u takuan jashtë *Brentwood Country Club*, teksa po vendosnin se cilat lule do të blinin për zbukurimin e ambientit të dasmës. Xhuliani kishte pak njohuri nga flora e zonës përreth dhe nuk donte të lejonte askënd tjetër t'ia zgjidhte lulet, as luleshitësin Zotin fals Di-Gjithçka, i cili po mundohej t'i shiste Xhulianit zambakë të verdhë, sikur i kishte marrë me ulje në fund të sezonit ose sikur nuk ishte marrë me ndonjë dasmë më parë dhe nuk e dinte që zambakët e verdhë simbolizonin falsitet. - Shoqja e Jozefinës.

- Zakija? - Pasi Xhuliani kishte refuzuar zambakët e verdhë, dëgjoi një fjalim të komplikuar nga koordinatori i dasmës për krizantemat e verdha. - Jo *të verdha*, - tha Xhuliani teksa e kishte humbur durimin.

- Lule pranvere jo, margarita jo, trëndafila të verdhë jo, tulipanë jo, asgjë. Atëherë po sikur të përzgjedhim lulëkuqe, zotëri? - tha burri. - I kam me ulje...

Zoti pastë mëshirë.

Xhuliani dhe Eshtoni shëtitën përmes shtretërve me lule në kopshtin ngjitur me lokalin ku do të zhvillohej dasma. Ata kaluan nëpër korridoret mbushur me bimë të quajtura delfinë, teksa Xhuliani përpiqej të gjente se ku mund të shkonte që të porosiste sa më shpejt zgjedhjen e tij të parë për dasmën: zambakë liri, zambakun e përjetshëm që rritej në Fushat e Elizesë¹. Zambaku

¹ Në mitologjinë klasike Fushat e Elizesë ishin një vend i bukur ku preheshin shpirtrat pas vdekjes. (Shën. i red.)

i lirit ishte lulja e përjetshme. Dhe ky tipi acarues nuk e kishte. Me shumë gjasa askush nuk e kishte, se është lule e rrallë dhe e shtrenjtë. Por ia vlente një përpjekje.

Xhuliani në të njëjtën kohë dëgjonte edhe Eshtonin, edhe shqyrtonte lulet e diellit me kërcell të shkurtër (për adhurim, ai mendoi me ëmbëlsi).

Ai vendosi të kërkonte në internet për luleshitës në “Brentwood” dhe pranë Santa Monica-s. - Ua, shiko, - tha ai, - qenka një dyqan që quhet *Flowers with Love*. Prit, çfarë the? - Ai vështroi Eshtonin, - Zakija erdhi të të takonte? Ku, në dyqan? Çfarë donte?

- Të më bërtiste.

Xhuliani buzëqeshi. - Çfarë bëre? Më saktë, çfarë bëre këtë herë? - Ai hapi hartën në celularin e tij dhe vendosi emrin e luleshitësit. Ndodhej vetëm një milje larg. Perfekt.

- Unë jam një engjëll, - tha Eshtoni, - është problemi i saj nëse ajo nuk mund ta shohë.

- Prit një sekondë, engjëll, - tha Xhuliani. - Më duhet të bëj një telefonatë.

Eshtoni priti. As te *Flowers with Love* nuk kishin zambakë liri. Xhuliani vazhdoi të kërkonte luleshitës të tjerë në celularin e tij, dhe mezi e ngrinte kokën për të parë shokun e tij. - Eshton, - tha ai dhe mendjen e kishte diku tjetër, - duhet të sillësh mirë. Do të të duhet të kërcesh me Zakijan në dasmë. Të trokisni gotat, të mbani fjalim urimi bashkë. Nuk mund të kesh shoqëruese dasmath që të bërtasin gjithë ditës. Do të mërzisësh nusen time.

- Po shpresoj që ajo vajzë e nxori gjithë të bërtiturën që kishte përbrenda te dyqani im, por...

- Prit, Esh, një sekondë.

As te lule *Rococo* nuk kishin zambakë liri. Po ashtu dhe te *Fleur* në Santa Monica. - Është pothuajse e pamundur për t'i gjetur, - i tha shitësja Xhulianit. - E di, - i tha Xhuliani. Ajo dinte një vend në Long Beach, afër hotelit *Ritz Carlton* pranë limanit që ndonjëherë kishte lule të tilla. Ai nuk donte të udhëtonte aq larg. Por çfarë tjetër mund të bënte? Të merrte tulipanë të mërzitshëm? Apo jaseminë, që çdo çift tjetër i kishte në dasmat e tyre? Trëndafila, për atë Zot?

Trëndafila! - Esh, do të ishte i gatshëm për të shkuar me makinë në Loong Beach?

- Po të ishte në dorën time, jo, - tha Eshtoni. - Pse?

- Aty mund të gjej lulen që dua. Prit pak, do t'i telefonoj. Çfarë tha Zakija... prit...

As aty nuk kishin zambakë liri. Xhuliani mallkoi teksa mbylli telefonatën.

Eshtoni kapi një lule shumëngjyrëshe nga një buqetë e ekspozuar. - Pse nuk të pëlqen kjo? Duket bukur.

Xhuliani e mori nga duart e Eshtonit dhe e lëshoi përsëri në kovën e lagur. - Kumak, Eshton? Të lutem. Krizantemat përdoren për raste fatkeqësish. Le të ecim më tej, të shohim orkidetë. Çfarë kërkonte Z-ja?

- Ajo erdhi të më thoshte që ti dhe Jozefina nuk mund të martoheni.

- Shpresoj t'ia kesh treguar vendin, - Xhuliani tundi kokën, teksa shqyrtonte një buqetë me azalea. - Dhe t'ia kesh thënë të futet në radhë pas teje, prindërve të mi, vëllezërve të mi, kunatave të mia, shoqeve të saj nga "Brooklyn"...

- Patjetër që i thashë, - tha Eshtoni. - Prandaj bërtisnim.

Të dy burrat qeshën. Xhuliani uli azaleat dhe mori trëndafilat e kuq. Ai po ndihej i mposhtur nga sasia e kufizuar e zgjedhjeve të tij.

- Një gjë ishte e çuditshme ama, - tha Eshtoni.

- Ashtu?

- Ajo tha që nuk dinte gjë për dasmën deri dje.

- Me të vërtetë?

- Me të vërtetë.

- Jo, nuk ka mundësi, - tha Xhuliani. - Do e kesh keqkuptuar. - Ai e mbante buqetën me trëndafila si një nuse. - Sepse kjo do të ishte e çuditshme.

- Po.

- Dhe e pamundur.

- Po.

- Duke qenë se Zakija është shoqëruesja kryesore dhe çdo gjë tjetër.

- Po.

- Ajo, me të vërtetë, duhet të vijë në vete dhe shpejt, - tha Xhuliani teksa inspektonte petalet se mos ishin vyshkur. - Shoqërueset e nuses supozohen t'i bëjnë gjërat më të lehta, jo më të vështira. Me të drejtë nusja ime është e stresuar. Atëherë, si e menaxhove situatën?

- I thashë - tha Eshtoni - Prandaj bërtiti.

Eshtoni ndaloi për pak. - I thashë që Çarli vdiq.

- Kush është Çarli? - tha Xhuliani... dhe qeshi. - Oh, po. Ai Çarli. E fortë, Esh. E po, ashtu si them unë, gjithmonë mbylle me një shaka. Si e mori ajo?

- Përplas-derë-ik.

- Sigurisht. Domethënë e bëre të të urrejë akoma më shumë.

- Kjo do të ishte shumë e vështirë, - tha Eshtoni duke picërruar sytë ngaqë i binte dielli. Ai nxori syzet e diellit.

- Për dy ditë ti duhet të ecësh me të drejtë altarit, krah më krah. Cili është plani yt? Si ke menduar t'i përmirësosh gjërat?

Eshtoni lëvizti syzet që t'i mbulonin komplet sytë. - Do të mendoj ndonjë gjë.

- Dakord. Zambaku i lirit, lulja e përjetshme. Do të marr trëndafilat, - i tha Xhuliani koordinatorit të dasmës, i cili ecte pas tyre duke bërë gjeste me duar dhe duke treguar një bimë apo një tjetër me gjakftohtësi.

- Ndoshta ti duhet të flasësh me të dashurën tënde, Xhuls, - tha Eshtoni. - Të sigurohesh që çdo gjë është në rregull.

- Të flas me të për çfarë? Që Z-ja nuk do që ne të martohemi?

- Shih si është puna, - tha Eshtoni pas një momenti qetësie. - Zakija dukej sikur kishte hyrë në telashe.

Xhuliani buzëqeshi. - E po, siç thua gjithmonë, vajzat janë telash.

- Po, e them këtë, por nuk është kjo ajo që po them sot. - Pas syzeve të tij të diellit, Eshtoni nuk po buzëqeshte. - Ajo dukej sikur ishte në telashe.



Nga Redaksia e

Zotit Di Gjithçka

Volumi 11, Numër 248



Një trëndafil me një emër tjetër çfarëdo

*Lulëkuqet janë për ngushëllim
dhe ju nuk keni nevojë
për këtë.*

*Mos përdorni rododendro
si lulen e dasmës suaj,
do të thotë rrezik.*

*Si e dini nëse është dashuri,
apo diçka pothuajse po aq e këndshme,
por më mashtruese?*

• *Nëse je grua, pyet veten:*

*Nëse do t'i tregoje atij lajmin
më të papritur, një lajm jo plotësisht të
mirëpritur, si do të reagonte ai?
Ke gjetur punë në një qytet tjetër.
Nëna jote është e sëmurë dhe duhet
të vijë të jetojë me ju. Ti je shtatzënë.
Kthehet, vrapon, apo i prishet humori?*

• *Burra, ajo të thotë atë që ti
nuk do ta dëgjosh. Një ditë më vonë,
a do të jesh akoma atje?*

• *Pyesni veten: A jeni në gjendje
të duroni, apo do të thyheni?*

*“Libri i jetës fillon me një burrë
dhe një grua në një kopsht. Përfundon
me Zbulimin.”*

Oscar Wilde

NJË TRËNDAFIL ME NDONJË EMËR TJETËR

ZYMTËSIA FAMËKEQE E QERSHORIT KISHTE IKUR bashkë me të, dhe tani, dhe këtë fillimgusht, mjegulla e dendur kishte mbuluar gjithë Los Anxhelosin. Pas kohës që humbi te luleshitësi, atë mëngjes Xhuliani harxhoi orë të tëra për të publikuar buletin për trëndafilat. Iu deshën orë për të shkruar njëqind fjalë. Po agon një ditë e re, ne zgjohemi si të lodhur, dhe shohim që jashtë ka mjegull. Dakord, por e dimë që për tri orë nuk do të ketë gjë tjetër në qiell, deri në perëndim të diellit. Pse nuk mundej të gjallërohej? Sepse moti i këndshëm i përkiste së ardhmes. Në të tashmen, kishte shqetësim në ajrin e ndotur, një qetësi si përpara stuhive të frikshme të qytetit të Santa Anës, një paralajmërim i një zjarri të tërbuar që të bënte të hidheshe në det për të shpëtuar. Moti i zyrtë ndikonte shumë te Xhuliani, i ngadalësonte funksionimin e trurit dhe të trupit.

Ai ishte vonë. Harroi çelësat e makinës, iu desh të kthehej për ta, dhe një herë tjetër për pulovrin që ajo kish lënë në shtëpinë e tij. Këtë pasdite ishte performanca e fundit e Jozefinës te *Paradise in the Park*. Ai duhet ta merrte me makinë nga shtëpia e Z-së dhe ta çonte te teatri “Grek” përpara mesditës. Xhuliani do të kishte dashur të ishte i pranishëm në shfaqjen e saj të fundit, por ai kishte shumë gjëra për të bërë. Ishte e mërkurë dhe dasma ishte të premtën. Ai duhet të merrte unazat prej platini te dyqani *Tiffany’s*, dhe të paguante për unazën e rubinit, që e kishte porositur për të si dhuratë martese (në masën e duhur). Më pas ai do të takonte Eshtonin dhe Railin te lokali ku do të bëhej dasma që të vendosnin për menunë. Xhuliani nuk mendonte se Raili ishte njeriu i përshtatshëm për këtë, përderisa ajo nuk ha ushqim... dhe, po sikur dasma të rastiste në një ditë B dhe ajo mund të rekomandonte vetëm lëng gruri... por

rezultoi të ishte një këshilltare mjaft e aftë. Ajo e kuptoi, të paktën intelektualisht, që ka njerëz të tjerë të cilët e shijojnë ushqimin. Ku ishte lista e gatimeve që kishte përzgjedhur Jozefina? Xhuliani e kishte futur diku. Nuk kishte kohë ta kërkonte tani, ai ishte vonë.

Ai i theu të gjitha rregullat e shpejtësisë: katër ndalim kalimi, domethënë semaforë të kuq në rrugën “Fountain”, dhe dy semaforë të verdhë në “Melrose”, dhe që u shndërruan në të kuqe mbi kokën e tij. Ai arriti në shtëpi në rrugën “Normandie” në orën 11:50 dhe i ngjiti shkallët dy e nga dy.

Ai trokiti. Goditi më saktë.

- Jozefinë?

Qetësi.

Dëgjoheshin tinguj këpucësh mbi linoleum.

Një derë që po hapej.

Përballë tij qëndronte një grua imcake, me trup të drejtë e të lidhur, në formë drejtkëndëshi dhe një kokë në formë sferë, me flokë të shkurtër të zinj si helmetë. Dora e saj nuk e lëshoi dorezën e derës teksa qëndronte te pragu i saj. Për një sekondë Xhuliani mendoi se kishte trokitur në derën e gabuar. - A është këtu Jozefina?

- Nuk e di kush është kjo, - gruaja u përgjigj disi e irrituar me theksin e një personi të lindur në “Brooklyn”, me origjinë irlandeze apo lituaneze. Apo skoceze?

- Jozefina, vajza që jeton këtu me... Po Zakija është këtu?

- Nëse do të dije *ndonjë gjë* për Zakijan, do ta dije që është në *punë*, - gruaja i theksonte të gjitha fjalitë me ton pyetës, pavarësisht nëse ishin pyetje ose jo. Të hutonte. E bënte të vështirë që Xhuliani ta kuptonte. Po, se *kjo* ishte që ia bënte të vështirë për ta kuptuar.

Gruaja nuk pyeti se kush ishte ai. Ajo thjesht po rrinte te dera.

- Ajo e ka orarin në mesditë, - tha Xhuliani duke iu marrë fryma.

- Je pak vonë për orarin, *apo jo?* - tha gruaja. - Ajo iku para njëfarë *kohe*. Që të arrinte në *kohë*.

Xhuliani ngrysi vetullat. - Më falni, ju lutem, por kush jeni ju?

- Më fal, të lutem, - tha gruaja, - por *ti* kush je?

Këtë ai e kuptoi. Fort dhe qartë. I njëjti ton që ai kishte përdorur me Popa W. Kush drejtin je ti, plako, dhe pse po troket në derën e të dashurës sime?

- Unë jam Xhulian Kruz.

Ajo e vëzhgonte sikur po e gjykonte. - Pra *ti* je Xhulian Kruz.

Ajo kishte dëgjuar për të. Kjo donte të thoshte diçka. - A je mamaja e saj?

- Mamaja e kujt, Xhulian? - tha gruaja. - Mamaja e kujt jam unë?

- Uf... e Jozefinës? - Kjo ishte e dhimbshme.

- Jo, - u përgjigj gruaja. - Unë pa dyshim nuk jam mamaja e *Jozefinës*. Emri im është *Ava Mekenzi*. Unë jam mamaja e *Mia Mekenzit*.

Për një sekondë, Xhuliani u ndje i çliruar. Ajo ishte mamaja e *Mia Mekenzit*! Lavdi Zotit! - Nuk e di kush është kjo, - tha ai.

- Oh, jam e sigurt për *këtë*.

- Unë po kërkoj Jozefinë Kollins, - ai hodhi një sy sipër kokës si helmetë të gruas.

- Askush me këtë emër nuk jeton *këtu*, - tha Ava. - Po kërkon një vajzë të bardhë, të hollë e të gjatë me flokë ngjyrë kafe? Që i pëlqen të pretendojë që është tërë ato gjëra që nuk është? Si një aktore e *punësuar*? Një bijë e *mirë*? Një shoqe e *mirë*? Dikush që quhet *Jozefina*? Unë kam vetëm një vajzë, z. *Kruz*. Emri i saj është *Mia Mekenzi*.

Ja tek iu largua ajo ndjenjë momentale lehtësimi. - Ava... Dua të them, znj. *Mekenzi*, - ai e korrigjoi veten kur pa vështrimin e saj. - Nuk e di çfarë po ndodh, por... *Jozefina*, nuk ishte emri i saj i vërtetë?

- Ti nuk e di çfarë po ndodh, - tha Ava.

- A mund t'i flas asaj? A është *këtu*?

- Ti e the vetë që duhet të ishte në punë në *mesditë*, - tha mamaja.

- Sa është ora? Është *mesditë*? Jo. Ka kaluar me *kohë*. Pra, i je përgjigjur vetë pyetjes sate.

Xhuliani qëndronte në sheshpushim, pranë vazos me dhé të tharë dhe me azaleat e vyshkura. Ava bllokoi hyrjen, duke mbajtur dorën te doreza.

- Ajo duhet ta ketë ndryshuar dhe nuk të ka thënë, - tha Xhuliani më në fund. Toni i zërit të tij ishte i ulët dhe i njëtrajtshëm. - Emrin e saj e kam fjalën. Më fal, shpresoj të mos të të kem mërzitur.

Ava qeshi si me zor. Kishte këmbë të shkurtra dhe të shëndosha, dhe qafë që mezi e lëvizte. Ajo nuk dukej si mamaja e nuses së tij. Nusja e tij ishte e dobët dhe e hijshme, një balerinë e buzëqeshur, jo një qenie kaq brutale njerëzore. - Djalë i *dashur*, ti mendon se jam *unë* ajo së cilës nuk i ka thënë gjëra? - tha Ava..

Xhuliani rrinte në këmbë, duke shtrënguar çelësat e makinës në duar, dhe pulovrin e kuq të Jozefinës.

Ava u zgjat të merrte pulovrin. - Ky është i saji. Do ia jap kur të *kthehet*.

A ishte kjo një pyetje? Domethënë, kishte ndonjë mundësi që ajo të mos *kthehej*?

Xhuliani e tërhoqi. - Nuk ka problem. Do ia jap *unë*.

- Në rregull, - tha Ava, - jepja *ti*. - Ajo u bë gati të mbyllte derën, por ai shtyu dorën e tij për ta ndaluar. Dorën me të cilën mbante pulovrin.

- Prisni, znj. Mekenzi. Ju lutem, a mund të hyj?

Ajo psherëtiu e bezdisur. - Nëse duhet, patjetër hyr, por vetëm për një *minutë*. Sapo kam mbërritur, dhe jam shumë e lodhur. Rruga pesorëshe me taksì nga aeroporti ishte mjaft piktoreske, - tha ajo teksa u futën brenda. - Sa milje larg është aeroporti i Los Anxhelesit nga këtu, *dhjetë*? Fluturova tre mijë milje në më pak kohë.

Ajo kishte mbathur atlete praktike me bazë të trashë, si infermiere, e jo si një mësuese. Te dera e kuzhinës ndodhej një çantë e madhe katrore ngjyrë kafe, që ngjante si valixhja e gruas që qëndronte përballë tij.

- Ti e dije kush isha, - tha Xhuliani. - Ajo të ka thënë për mua?

- Asnjë *fjalë*, - tha Ava. - Asnjë rrokje. E di kush më tha për *ty*? Zakija.

Xhuliani përsëri s'po kuptonte. A nuk e siguroi Jozefina se i kishte thënë mamasë së saj që do të martoheshin, dhe mamaja e saj e kishte aprovuar?

Aprovuar.

Për t'i thënë këtë kishte shkuar Zakija tek Eshtoni? Që mamaja do të vinte? Por pse Jozefina nuk i dërgoi një mesazh? Pse nuk e paralajmëroi, nuk e përgatiti, nuk i shpjegoi, çfarëdo? Ata mund

të kishin shkuar bashkë në aeroport për të pritur vjehrrën e tij të ardhshme.

Në vend të këtyre, Jozefina i tha që mamaja e saj ishte jashtë vendit, për të vizituar disa të afërm që jetonin në Gjirin Morecambe, dhe nuk do të kthehej në kohë për të marrë pjesë në dasmën e tyre. Jozefina i kishte thënë se nuk e kishte problem që mamaja e saj nuk do të vinte në dasmë. Pas muajit të mjaltit, gjatë verës indiane të Nju-Jorkut, në një periudhë ku moti mund të jetë i ngrohtë midis datës 11 dhe 20 nëntor, ajo dhe Xhuliani kishin planifikuar të organizonin një pritje në “Brooklyn” për të gjithë shoqërinë e Jozefinës që gjithashtu nuk mund të vinin. Mamaja e saj mund të vinte e të merrte pjesë në atë pritje.

Pse Jozefina nuk i kishte dërguar mesazh për ta lajmëruar që mamaja e saj ishte kthyer nga Morecambe? Do e konsideroja si lajm, pjesëmarrjen e mamasë sate në dasmë. Dhe gjithashtu... të më shkruante, mos e vrit mendjen për të më çuar në orar te teatri “Grek”, Xhulian. Do e gjej mënyrën për të shkuar.

Diçka po e gërvishte Xhulianin në pjesën e prapme të fytit, që ia bënte të vështirë gëlltitjen. Diçka që kishte të bënte me emrin Jozefina.

Emri i saj, emri saj, emri i saj, emri i saj, emri i saj, emri i saj, emri i saj.

Ai u ul (u zhyt?) te tavolina e kuzhinës. Ndihej i pafuqishëm, mezi e mbanin këmbët.

Ava nuk u ul. Fytyrëngrysur, me krahët të kryqëzuar, ajo qëndronte pranë lavamanit ku jo shumë kohë më parë Jozefina i kishte ofruar Xhulianit *tost turpi* me këmbëngulje.

- Pra, Xhulian Kruz, a është e vërtetë çfarë më ka thënë Zakija?
- tha Ava. - Që ti po planifikon të martohesh me *vajzën time*? - Zëri i Avas ishte i akullt, mosbesues, paksa i hidhëruar. Por kishte edhe diçka tjetër, njëfarë përqeshjeje poshtëruese, të papërcaktuar, por njëkohësisht të pamohueshme. Njësoj sikur nipi yt katërvjeçar të të informojë që ka në plan të udhëtojë nga Simi Valley në *Disneyland* krejt i vetëm. Dhe ti pretendon sikur po e merr seriozisht derisa motra jote e thërret poshtë për të ngrenë kofshë pule. Përveç ngjashmërisë që Xhuliani ishte katërvjeçari me ëndrrat e pamundura.

Ai i kishte kërkuar Jozefinës me javë të tëra që të shkonte në zyrën e bashkisë në Beverli Hills dhe të aplikonte për certifikatë martesë, në mënyrë që dokumenti zyrtar të vinte në kohën e duhur. Ishte gjithmonë një nga ato gjërat që duhet të bënin dhe kishin ndër mend të bënin dhe nuk arritën ta bënin. Ajo një ditë ishte sëmurë, ditën tjetër kishte audicion, një ditë tjetër donte të shkonte sërish në *Disneyland* (ky *Disneyland* prapë!), dhe më pas ra kaq shumë shi sa shkëmbinjtë ranë në ujë.

Më në fund shkuan, vetëm dy ditë më parë, një të hënë. Ata treguan dokumentet e tyre të identifikimit, firmosën dëshminë duke u betuar përpara noterit. Jozefina firmosi pas tij. Xhuliani nuk pa se me çfarë emri nusja e tij kishte firmosur në *certifikatën e tyre të martesës*. Ai nuk mendoi se kishte arsye për të parë.

Kjo ndodhi pardje.

Dhe jo më larg se dje ishte dita kur Zakija i tha Eshtonit që sapo e kishte marrë vesh për martesën. Xhuliani qeshi. Ishte kaq absurde. Esh ishte keqkuptuar. Z. ishte keqkuptuar. Nuk mund të ishte ndryshe.

Dhe prapë...

A ishte e mundur që Jozefina, me të vërtetë, nuk i kishte thënë mamasë së saj apo Zakijas që do të martohej, dhe e vetnija arsye pse Zakija e mori vesh ishte, sepse pa një kopje të aplikimit për certifikatë martesë, të vendosur pa mendje mbi komodinën e dhomës së gjumit?

A ishte kjo arsyeja pse Jozefina nuk e kishte vënë në gisht unazën e fejesës? Diamanti i madh në gishtin e bardhë është i vështirë për t'u fshehur nga shoqja jote më e vjetër.

Xhuliani i shushatur nuk dinte çfarë t'i thoshte gruas pranë banakut që ishte gati për t'u bërë vjehrra e tij, në një të ardhme që për një arsye filloi t'i dukej aq e largët sa dielli.

- A e di se çfarë duhet të më pyesësh *mua*, Xhulian? - tha Ava.

- Jo.

- Ti duhet të pyesësh pse vajza ime nuk më telefonoi vetë për të më thënë për ty. Pse duhej ta bënte Zakija? Nuk është përgjegjësi e Zakijas, apo jo? Ajo nuk donte të më telefononte, por Mia e detyroi.

Ajo donte që Mia ta merrte përsipër, por kjo është një gjë mbi vajzën time, të cilën ti nuk ke pasur shansin ta zbulosh akoma. Gjithë jetën e saj ka qenë Mia e para, Mia e fundit, *vetëm* Mia. Atë që Mia do, Mia e bën dhe asgjë tjetër nuk ka rëndësi. Zakija e gjorë. Ajo është një vajzë e dashur. Ajo u ndje spiune dhe tradhtare. Ajo vajzë është një engjëll. Gjithmonë përpiqet të bëjë gjënë e duhur. Në ndryshim nga ime bijë, - tha Ava, - e cila vazhdimisht bën gjëra që njerëzit për së mbari thjesht nuk i bëjnë. Është *fëmija* im dhe më beso, kam shpikur lloj-lloj *justifikimesh* për të, por jo këtë *herë*. Ajo e ka vënë Z-në në një pozitë të tmerrshme. Z-ja tha që ishte këshilluar prej saj të mos *thoshte gjë*, por unë i thashë absolutisht *jo*. Shoqet duhet të kujdesen për njëra-tjetrën. Përndryshe si guxon ta quash veten *shoqe*? Nëse ka një të vërtetë aty jashtë që duhet ditur, atëherë shoqëria duhet të të ndihmojë, dhe mbi të gjitha mamaja jote duhet të të ndihmojë, a nuk je *dakord*?

- Nuk e di, - tha Xhuliani. - Nuk di asnjë gjë për këtë.

- Po, ti nuk di shumë gjëra, - tha Ava. - Dhe me sa shoh nga fytyra jote, ti *nuk do të dish*. - Ajo tundi kokën. - Sa *keq*. Por është ashtu siç unë them gjithmonë... pasioni për të vërtetën është më i vakti nga të gjitha pasionet njerëzore.

Zot i Madh. Xhuliani u përpoq të ngrihej në këmbë. Ai kishte nevojë për Eshtonin. Eshtoni do të dinte çfarë të bënte.

- Kush je *ti*, që mendon se mund të martohesh me *vajzën time*? - tha Ava.

- Ne jemi destinuar për të qenë bashkë, - arriti të mermëriste Xhuliani.

Ava qeshi. - Ti je destinuar për *mjerim*, djali im, mjerim, të cilin nuk e ke imagjinuar *kurrë*. Më dëgjo mua dhe largohu sa je ende në kohë. Unë *di* shumë gjëra. A nuk e di që toka sundohet nga *nëna*? Me pak fat, një ditë Mia do të bëhet mama... por jo nga *ti*. Sepse ajo është e fejuar me një djalë në Nju-Jork. Ata kanë katër vjet që janë bashkë. Dasma është planifikuar për t'u bërë muajin maj të vitit që vjen. *Ftesat* janë dërguar muaj *më parë*. Çfarë, nuk të erdhi *e-mail-i*? I fejuari i saj po fluturon drejt aeroportit të Los Anxhelosit për ta marrë dhe të kthehemi së bashku në Nju-Jork. Mjaft me këto *marrëzira*. Çfarë ngatërrese ka bërë, ashtu si *gjithnjë*.

Xhuliani nuk po dëgjonte më. Ai po rrëzohej nga shkallët.

FRUTA E PASIONIT

SI ARRITI TE TEATRI “GREK”, AS VETË NUK E DINTE.

Teksa priste në parking që ajo të mbaronte, ai nguli sytë te përzgjedhja e menysë që ajo kishte shkruar me dorë në një letër dhe e kishte futur të palosur në portofolin e tij. Ata e kishin kaluar muajin e fundit duke planifikuar dasmën që do të ishte të pasnesërmen.

Fatkeqësisht sot ishte një ditë përpara asaj dite.

Ullinj italianë të mbushur me djathë.

Oktapod spanjoll.

Vezë të ziera me kërpudha të egra.

Sallatë kineze me pulë.

Karkaleca të mëdhenj havaianë.

Burrata plot qumësht.

Sallatë me *Ahi Tuna Sashimi*.

Karpaçio viçi nga Maui.

Karavidhe në avull me barlimoni dhe xhinxher.

Mango dhe tartë luleshtrydheje.

Biskotë me arrë *Macadamia*.

Dhe një tortë dasme të papjekur, përgatitur me çokollatë, arrë kokosi dhe frutë pasioni. Në Havai, frutën e pasionit e quanin *lilikoi*.

Në anën e prapme të menysë, ajo kishte shkruar një shprehje që donte ta përdorte në betimin e saj.

As demonët poshtë, apo engjëjt sipër, nuk mund të ndajnë shpirtin tim nga shpirti yt.

Ai parkoi te vendi i parkimit poshtë maleve që u ishin ngjitur dikur, ktheu kurrizin nga skena ku ajo aktualisht ndodhej, dhe i

ra përsëri dhe përsëri me zemërim numrit të telefonit të Eshtonit. Xhuliani duhet t'i kishte telefonuar njëqind herë.

- Ku je? - tha Eshtoni kur, më në fund, i telefonoi. Nuk i tha, humbe një tjetër mundësi për të kontrolluar një skenë xhirimi ku mund të zgjidhje sende për dyqanin. As nuk e hape dyqanin kur duhet ta hapje. As ti nuk më dëgjon kurrë. Por e pyeti ku je.

Mund të kishin kaluar dhjetë minuta ose një orë kur Eshtoni erdhi me shpejtësi ngjitur *Volvo*-s së Xhulianit me *BMW-në* e tij ngjyrë blu. - Xhuls, jo. Ky është një gabim, - ishte gjëja e parë që tha kur u fut në makinën e tij. - Kondicioneri yt nuk punon. Do të piqemi këtu.

- Makina është mbinxehur, - tha Xhuliani. - Në djall vafshin *Volvo*-t. S'janë të mira për asgjë.

- Pse nuk i telefonove Shoqatës së Automjeteve?

Sikur ata të shoqatës të mund të vinin dhe të rregullonin gjërat.

- Eja futemi te makina ime, - tha Eshtoni.

- Si mund të jetë më mirë në makinën tënde përderisa e ke tavanin të hapur?

- Po, dhe kjo është e vështirë të kapërcehet. Eja, Xhuls.

Xhuliani po djersiste. Rrobat i ishin lagur nga djersa, edhe fytyra. Celulari i tij ishte mbinxehur njësoj si *Volvo*-ja. Kishte nevojë për ajër të ftohtë përpara se të mund të funksiononte sërish. Për momentin, mund të përdorej vetëm si një peshë për të mbajtur letrat në vend.

Pasi tavani i kabriolesë u ngrit dhe kondicioneri u ndez në maksimum, Xhuliani i tregoi Eshtonit për Mian. Teksa Eshtoni dëgjonte, mblodhi supet dhe i tha:

- Të thashë të flisje me të.

- Të flisja me të për çfarë? Dhe kur? Ajo ishte në punë, ti dhe unë po merrnim kostumin tënd, dhe dje në darkë ajo ndenji me Z-në. Unë nuk e takova. Fola me të. Në telefon dëgjohej *mirë*. Çfarë të bëja?

Eshtoni tundi kokën.

O Zot.

- Mos u mërzit, Xhuls, - tha Eshtoni. - Mamatë nuk dinë çdo gjë. Madje as unë nuk di çdo gjë.

- Po më kritikon?

- Jo.

- Të thashë çdo gjë që dija, - tha Xhuliani. - Nuk të fsheha asgjë.

- Ai uli kokën. - E mbajta për vete. Kështu mund t'ia dilja që kjo fluskë dashurie të mos pëlciste.

- Mos e humb toruan, - tha Eshtoni. - Qetësohu dhe fol me të dashurën tënde. E kush na qenka ky djali, meqë ra fjala?

- E çfarë rëndësie ka?

- Mos është ai gorilla që ishte te shfaqja me të? E mban mend, ai tipi që luajti Moses Jackson?

- Nuk e di, Eshton.

- Nuk pyete? Ke të drejtë, e kujt i intereson. Ajo ishte e fejuar me një idiot, edhe? Pa dyshim që e anuluan.

- Thua të jetë e vërtetë kjo? - tha Xhuliani.

- Po, sepse ajo nuk mund të martohet edhe me ty, *edhe* me të. Ky do të ishte mashtrim..., - fytyra e Eshtonit mori një shprehje turpi dhe ndërgjegjësimi të ri..., - dhe nuk di çdo gjë për *atë*, por di që *ti* dhe ajo keni rezervuar tek *Brentwood Country Club* këtë të premte mbrëma, ku një shef nga "Waikiki" do ju përgatisë një tortë me frutë pasioni, çfarëdo qoftë kjo. Vëlla, sytë tek unë. - Vështrimi i Eshtonit ishte intensiv, lutës, ngushëllues. - Çdo gjë do të bëhet mirë, mamatë nuk dinë çdo gjë. Shokët janë idiotë.

- A je i sigurt për këtë?

- Njëqind për qind, - tha Eshtoni, duke treguar buzëqeshjen e tij të mahnitshme. - Sepse unë jam një idiot.

- Pse nuk më tha ajo që mamaja e saj do të vinte?

- Harroi. Ishte e zënë. I doli nga mendja. Njësoj siç të del ty nga mendja të hapësh dyqanin apo të më takosh te hapësirat e produksionit të *Fox*. E di vetë ti...

- Po më kritikon?

- Po, Xhuls, - tha Eshtoni. - Këtë herë po të kritikoj.

- Pse nuk i tha mamasë së saj që do të martoheshim?

- Ti nuk e di që ajo nuk i tha, - tha Eshtoni. - Ndoshta i kanë prishur marrëdhëniet pikërisht, sepse i tha të ëmës. Nuk di shumë në lidhje me këtë, por kam dëgjuar që mamatë mund ta bëjnë këtë, të të çmendin, të të bëjnë të harrosh gjëra.

- Jo, mamatë, - tha Xhuliani. - Dashuria. Dashuria e bën këtë.

- Si të thashë edhe më parë, në lidhje me atë se përse nuk të mori në telefon, ndoshta nuk ka valë.

- Mos ia fut kot. Ajo është aty, - Xhuliani tregoi me gisht drejt amfiteatrit.

- Celulari i saj mund të jetë tejnxehur, si i yti, - tha Eshtoni. - Dielli bie mbi të gjithë celularët njësoj, Xhuls, te të drejtët dhe të padrejtët.

Xhuliani po humbiste fuqinë e të shprehurit.

- Celulari nuk është një megafon drejt pjesës tjetër të botës, - tha Eshtoni, - mezi është një bilbil. Ndonjëherë njerëzit nuk i përgjigjen thirrjes.

- Po, - tha Xhuliani, - ose ajo mund të ketë lënë mamanë e saj të merrej me mua, sepse nuk mund të përballej me mua.

- E di që kështu duket...

- Pse nuk ma tha emrin e saj të vërtetë?

- Sepse, - tha Eshtoni, - ajo do të jetë *ky* person, jo *ai* person. Personi që ajo do të jetë nuk është një vajzë irlandeze e quajtur Mia Mekenzi nga një lagje e vjetër, por një dukeshë e quajtur Jozefinë Kollins.

- Nuk do ia thoshe këtë burrit me të cilin do të martoheshe?

- Nuk e di, Xhulian, - tha Eshtoni. - A i ke thënë çdo gjë gruas me të cilën do të martohesh?

- Gjithsesi...

- Pikërisht.

Xhuliani u nxeh. - Ç'lidhje ka Topanga me çdo gjë? Fakti që humba aty, më bën më pak të aftë për t'u martuar me të?

- Nuk ka të bëjë me faktin që humbe, - tha Eshtoni, - ka të bëjë me faktin që desh vdiqe.

- Nuk vdiqa, veçse. E the dhe vetë. Në rastin konkret... këtu jam në ferr.

- A i the kush ishe përpara Topanga-s? - tha Eshtoni. - Kush doje të ishe? E shoh nga fytyra jote e acaruar që nuk i ke thënë. Pra, *ti* nuk i ke thënë çdo gjë. Pse nuk ia the? Mos më trego gishtin e mesit. Të them unë pse. Sepse tani ti je *ky* person. Siç ajo është *ai* person. Të gjithë duam të rishpikim veten, të jemi gjëja e re, jo

gjëja e vjetër. - Eshtoni vështroi duart e tij. - A i kam thënë Railit për mamanë time? Jo. Ajo mezi e di që kam një baba, i cili është ende gjallë. Këtë pjesë e kuptoj, vëlla. Ajo do që të martohet me ty si Jozefina, jo si Mia.

- A po martohet me Moses Jackson si Mia?

- Mendova se nuk e dije kush ishte?

- Po supozoj, - tha Xhuliani gjithë neveri.

- Shiko, për aq sa di ti, e dashura jote nuk i ka thënë ndonjëherë jo asnjë propozimi, - tha Eshtoni, - por është e qartë se nuk mund të martohet me më shumë se një person çdo herë.

- Sepse një nga këto martesë do të ishte e rreme, apo jo? - Xhuliani u drodh. Djersa i rridhte çurkë, por ai kishte ftohtë.

- Jo e rreme, - tha Eshtoni. - E pavlefshme në sytë e ligjit.

Mënyra se si e tha Eshtoni... me kaq kujdes... e bëri të tingëllonte sikur ai mendonte se kishte të paktën një shans të barabartë që bashkimi i pavlefshëm do të ishte i saji dhe i Xhulianit, jo i saji dhe i një idioti.

- Pse po përdor këtë ton zëri? - e pyeti Xhuliani - Ti sapo më the që çdo gjë do të bëhet mirë.

- Mirë do të bëhet.

- Dhe pesë minuta para kësaj më the që ajo do të më vdesë mua, - iu kthye Xhuliani dhe i ra timonit me forcë. - Zgjidh në cilën anë je.

- Nuk thashë që do të të vdesë ty, - tha Eshtoni duke marrë frymë. - Thashë që do të më vdesë *mua*.

Xhuliani ktheu kokën dhe ia nguli sytë shokut të tij.

- Po bëja shaka, - tha Eshtoni, dhe buzëqeshja e tij ishte zhdukur.

- Mrekulli. Pra, ajo të ka bërë të humbasësh dhe sensin e humorit, ndër të tjera. E pabesueshme.

Shfaqja *Paradise* përfundoi. Njerëzit filluan të dilnin nga teatri.

- Nëse ke nevojë për mua, - tha Eshtoni përpara se të largohej, - do të jem më poshtë tek *HomeState*, duke ngrënë një pjatë plot me *burrito* mëngjesi.

Xhuliani po e priste, mbështetur te bagazhi i makinës, me kokën të anuar në drejtim të trotuarit.

Ajo nuk e përmendi emrin e tij teksa përshekoi parkingun mes për mes dhe u ndal përballë tij, me fytyrën e saj të gjatë e të vijëzuar kuq e zi si një kloun grotesk, me makijazhin e skenës të fshirë si mos më keq, me beretën të vendosur shtrembër, dhe duart të kryqëzuara para gjoksit.

As Xhuliani nuk e përmendi emrin e saj.

- A të erdhi mesazhi im? - pyeti ajo me qetësi.

- E ke fjalën për mesazhin që thoshte të mos vija, sepse do të shkoje vetë në teatër, - tha Xhuliani, - apo për mesazhin që më paralajmëronte se mamaja jote do të më bënte pritë?

- Më fal, - tha Jozefina. - Ajo është e tmerrshme, apo jo?

- Ajo?

- Ardhja e saj pa paralajmëruar këtë mëngjes më tronditi. Ne patëm një zënkë të tmerrshme. Ajo gjithmonë i fut hundët aty ku nuk i takon. Unë u largova me nxitim dhe harrova të të dërgoja mesazh. Të shkrova më vonë. Ma merr mendja nuk e pe. Të shkruaja që ajo po më çmend.

- Si erdhe deri këtu?

Ajo bëri një pauzë para se të përgjigjej. - Më solli Popa W. me makinë. S'kisha ç'të bëja, Xhulian. Përndryshe do të bëhesha vonë.

- Popa W. të solli me makinë, - përsëriti Xhuliani me mërzi.

- Nuk është ndonjë gjë e madhe, - tha ajo. - Unë të shkrova. Të dërgova një e-mail përpara se të ngrihej perdja. Është shumë i rëndësishëm. E lexove?

- Celulari im u mbinxeh, - u përgjigj ai. Jashtë temperatura shënonte dyzet gradë celsius. Bluza e tij e lagur nga djersa i ishte ngjitur pas kurrizit.

- Më fal për të gjithë këtë, - tha ajo, - por mund të ta shpjegoj.

Nuk e dëgjoji mirë? Tha që mundet apo nuk mundet? - A e di se çfarë më tha mamaja jote? - tha ai.

- Xhulian, prit, më lër të flas e para.

Ai nuk priti. Filloi të fliste i pari. - Ajo më tha disa gjëra. Njëra prej atyre që më tha është se *i fejuari* yt do të vijë më vonë me avion të të marrë e të ktheheni në Nju-Jork së bashku.

Asaj i ra çanta përtokë. Duart e saj u ngritën për të mbuluar gojën e saj. - Oh, jo, - tha ajo. - Kjo *nuk mund* të jetë e vërtetë. Ajo nuk më tha asgjë për këtë sot në mëngjes, asgjë!

- Çfarë nuk mund të jetë e vërtetë? - pyeti Xhuliani. - Që ti ke një të fejuar tjetër përveç meje? Është vetëm një i fejuar tjetër, apo jo? Apo që ai po vjen të të marrë e të të kthejë në shtëpi?

- O Zot! Pse duhet të thoshte *gjithçka*? Ajo e di sa mërzitet ai. Çfarë ka menduar?

- Aha, - tha Xhuliani. - *Kjo pjesë domethënë.*

Ajo u përplas me çantën që i kishte rënë përtokë, bereta i rrëshqiti nga koka dhe ra. Ajo e ngriti me duart që po i dridheshin.

- Kjo është mamaja ime. Gjithmonë arrin t'i bëjë gjërat më keq. Xhuls, të lutem mund të më çosh në shtëpi? Do të të shpjegoj çdo gjë më vonë, por tani më duhet të iki *patjetër*.

- Më shpjego tani, - tha ai.

- Duhet të iki.

- Më thuaj.

- Jo!

Ai mbajti frymën. - Ti po më bërtet *mua*?

- Xhulian..., - tha ajo, duke shtrënguar duart. - Ti nuk e kupton. Duhet ta menaxhoj situatën në mënyrën time. Jo në mënyrën tënde. Mënyrën *time*.

Fytyra e saj shprehëse, e shkarravitur me vija rimeli të zi, nuk dukej më e tillë. Dukej sikur fshihte sekrete.

- Nuk e dija që ekzistonte një mënyrë e *jojta*, - tha ai, dhe duart po i digjeshin mbi makinë, e cila po nxehej gjithnjë e më shumë. - Mendoja se kishte vetëm *një* mënyrë.

- Në rregull. E di, që nuk..., çfarë pret që të të them?

Xhuliani nuk tha asgjë.

- Të thashë që po nxitoheshe, - tha ajo. - Ti sapo u ndave me atë Guenin apo këdo tjetër dhe mendova se isha thjesht dikush sa për të kaluar kohën.

- Sa për të kaluar kohën? - përsëriti ai - Ç'janë këto që thua? Ti nuk je një vajzë çfarëdo sa për të kaluar kohën. Ti je *ajo* vajzë.

Ajo nuk po e shikonte.

- Ose kështu mendoja.

- Të lutem, Xhulian.

- Cili është emri yt?

Ajo nuk po i përgjigjej.

- Cili është emri yt? - përsëriti Xhuliani me zë më të lartë. - Sepse ti erdhe me mua në bashki dhe firmose një copë letre ku lidhe emrin tënd me emrin tim me kontratë. Cilin emër vendose në atë dokument?

- Mía Mekenzi, - ajo mezi i shqiptoi këto fjalë.

Xhuliani kishte mbetur pa gojë.

- Mos më bërtit, - ulëriti ajo.

- S' thashë asnjë fjalë.

- Ti po ulërin si i xhindosur!

- S'thashë asnjë fjalë.

- Unë jam në proces për ta ndryshuar ligjërisht emrin në Jozefina, por duhet kohë. Do të ta thosha, por u zgjat pak si shumë, dhe nuk dija sesi.

- Çfarë u zgjat? - tha Xhuliani.

- Përdorimi i emrit fals.

- Aha.

Buza e saj u drodh. - Duhet të rregulloj shumë gjëra tani. E di këtë. Ti mendon se nuk e di? Mos e bëj çdo gjë më të vështirë. Edhe kaq është e vështirë.

- Po në lidhje me martesën tonë?

- Çfarë në lidhje me martesën tonë? - Ajo nuk e pa në sy.

- Po në lidhje me... *ty dhe mua?*

- Çfarë në lidhje me ne?

Ai mund ta duronte këtë neveri me kafshata të vogla, por neveria e hante atë me kafshata gjigante..

- A do të... - Xhuliani nuk e kuptoi si mundi t'i nxirrte fjalët nga goja - ... a do të martohesh me dikë tjetër?

Shpatullat e saj ishin kërrusur. - *E kisha në plan* të ndahesha me të përpara se të ikja për në L. A., - tha ajo, - por atë e zuri gripi dhe humbi një punë që e donte shumë. Ai është artist. Është shumë i ndjeshëm. I vuan lajmet e këqija. Nuk doja ta mërzisja edhe unë. Nuk më dukej sjellje e mirë. Mendova të vija këtu, të punoja për ca kohë, të lija pak hapësirë mes nesh, t'i mendoja gjërat më mirë dhe

pasi të kthehesha në Nju-Jork, do të dija çfarë të bëja. Por pastaj të njoha ty, Xhulian! Të njoha ty, dhe *gjithçka ndryshoi*.

- Oh, Zot.

- Pse po thua, oh Zot? Nuk e kupton? Çdo gjë ndryshoi *sepse* të njoha ty.

- Pra, jo vetëm që nuk i the për mua, por nuk i ke thënë as që nuk do të *martohesh* me të? - Xhuliani ndihej i trullosur. Ai po humbiste aftësinë për të kuptuar gjuhën. - Ai *akoma* mendon se ju do të martoheni. Burri me të cilin ke qenë për katër vjet po vjen në L. A. ngaqë mendon se ju të dy jeni ende të lidhur?

- Unë nuk doja t'ia lëndoja ndjenjat, - tha Jozefina me një zë të ulët. - Nuk dija si t'ia thosha.

Kështu merr fund bota. Në mes të ditës, në mes të jetës sate, në mes të një parkingu mbushur plot me makina dhe furgona të vegjël që shesin akulllore.

- Mendoja se më doje, - tha ajo, zëri i saj po dridhej. - Si mund të jesh kaq i inatosur me mua? Unë do i thosha...

- Prandaj më mbajte larg Zakijas, - tha Xhuliani, - sepse ajo dinte çdo gjë për ty. *Ki kujdes kush pretendon se je*.

- Jo, - tha ajo pa qenë e bindur.

- Prandaj nuk e ke vendosur unazën time? Që të mos ishte e nevojshme t'i shpjegoje gjë Z-së?

- Nuk e kam vënë unazën tënde, sepse është tepër e madhe.

- Tashmë nuk është më tepër e madhe, dhe megjithatë nuk ka asgjë në gishtin tënd, - tha Xhuliani. - Ti nuk i the mamasë sate për mua. Ti kishë rënë dakord të martohesh me dikë tjetër. Kush je ti? - Zëri i Xhulianit u thye teksa ai vetë po thyhej. - Apo e kam plotësisht gabim? Unë jam budallai në këtë mes? A jam *unë* ai të cilit nuk i ke thënë që do të martohesh me dikë tjetër?

- Nuk është kështu, Xhulian.

- Ti nuk iu përgjigje pyetjes sime.

- Nuk është kështu.

- Përgjigju pyetjes sime!

- Ti ishe kaq këmbëngulës! - tha ajo me zë të lartë - Martohu me mua, martohu me mua. Nuk dija çfarë të bëja.

- Unë nuk isha këmbëngulës! - bërtiti Xhuliani. - Unë të kërkova të martoheshe me mua, dhe ti the *po*. Ti mund të kishe thënë, më lër të mendohem për këtë, të rregulloje gjërat e tua dhe pastaj të më jepje një përgjigje. Ti mund të më kishe thënë për të. Mund t'i kishe thënë atij për mua. Mund të kishe folur me Zakijan, të pyesje *atë* çfarë të bëje. Madje mund të kishe thënë që nuk mund të martoheshe me mua, sepse ishte e pamundur. Mund të kishe bërë çfarëdolloj gjëje përveç asaj që bëre, që ishte të më thoshe *po*. Unë nuk isha *këmbëngulës!*

Lot dhe bojë rimeli rrodhën në fytyrën e saj, si lot rakuni.

- Ti do të martohesh me dikë *tjetër!* - Këto fjalë i shkaktuan të therura në zemër Xhulianit. Zëri i tij e tradhtoi për të thënë gjërat që ai donte të thoshte, gjërat që ai donte të bërtiste. Vendosi duart e tij të nxehta te tëmthtat duke dashur t'i shtypte përbrenda.

- Më fal, - tha ajo, - doja të ta thosha, thjesht nuk dija si. Ti ishe kaq i ëmbël me mua, kaq i mirë. Askush në jetën time nuk ka qenë atë qllim me mua sa ti. Nuk doja të të thyeja zemrën.

Ajo nuk donte t'i thyente zemrën.

- Përfundimisht, cili ishte plani yt? - tha ai. E kontrollloi veten që të mos rënkonte. - Që të ndahemi?

- Po mundohesha të gjeja momentin e duhur...

Xhuliani ngriti duart. - Mos fol më. Mos bëj më asgjë. Mjaft.

Ata qëndruan te parkingu koti i teatrit "Grek", me malet e lashta mbrapa tyre, me furgonin e vogël në qoshe që u shiste *tacos* dhe akullore mamave me fëmijë.

Ai donte ta tundte, ta lëndonte, ta përqafonte, dhe me përqaftimin e tij ta shtypte, të mbyste veten. Ai nuk i besonte më vetes që t'i shkonte pranë.

- Kjo që ndodhi me ne ishte e gjitha një mashtrim i ndyrë, apo jo? - tha ai. Grushtet e tij ishin të shtrënguara. Në sytë e tij kishte lot. - Një pantomimë e Venusit dhe Marsit.

- Jo! - Ajo bëri një hap drejt tij. - *Jo...*

Ai i ngriti duart në një pozicion bllokimi. - Po, ishte. Një gjë e rreme, një iluzion. Si drita në malin tënd. Asgjë nuk është e vërtetë. As ti, as unë, as unë dhe ti. - Fytyra e tij pulsonte gjak të nxehtë nën lëkurë. - Eshtoni ka të drejtë. Çdo gjë që ti bën është

një mashtrim. Prandaj mund të më trajtosh kështu. Për ty nuk jam asgjë tjetër përveçse një set nga një shfaqje e anuluar. Unë jam gati të çmontohem për t'u hedhur në plehra. Ti jo, vetëm po aktron për asgjë. Ti po jeton për asgjë. Sepse për ty nuk jam i vërtetë.

- Po, je, Xhulian, *të lutem!* - pëshpëriti ajo.

Ai u kthye anash, dhe kur ajo u vërsul drejt tij, ai e shtyu. - Mos m'u afro, - tha ai. - Largohu prej meje. Unë nuk e di kush je. Oh, Zoti im, unë nuk di as si të të thërras. Largohu prej meje.

- Xhulian, prit, të lutem... kam nevojë të... si do të kthehem në shtëpi?

- Pyet Popa W. - Xhuliani hapi derën e makinës me forcë. - Jam i sigurt që ai do të ishte më se i lumtur të të çonte në shtëpi, JoJo.

Ajo po qante me dënesë, duke qëndruar në parkingun e zbrazët, me krahët e saj rreth vetes. - Po unaza jote?

- Mbaje atë gjë të ndyrë. Të urrej. Nuk dua të të shoh më kurrë.

Ai u largua me makinë dhe fjalët e tij të fundit drejtuar asaj, i rrihnin si çekiç në kokë.



Nga Redaksia e

Zotit Di Gjithçka

Volumi 11, Numër 249



Parimet e fundit

Shekspiri ishte një adhurues i madh i kompleteve në të cilat rrjedhin pasoja të tmerrshme nga mashtrimet e vogla. Mendoni për dëmin e shkaktuar nga një shami tek "Otello".

E mira përfundon me lumturi, dhe e keqja me fatkeqësi. Kjo është ajo që do të thotë trillim.

Thënia e ditës:

Paniku i minutës së fundit: fjalë për fjalë do të thotë panik se mos mbyllet hyrja, ose frikë se mos mbetesh jashtë.

• Kurrë mos merr këshilla nga njerëz që nuk është e nevojshme të jetojnë me pasojat e zgjedhjeve të tua.

- Nëse vendos piper të kuq kur çahesh diku, do të të dhembë, por do të ndalojë gjakderdhjen. Në rastet kur nuk është shumë e thellë.*
- Për të trajtuar një plagë të hapur, lyeje me ngjitës Superglue. Në rastet kur nuk është shumë e thellë.*
- Mëso me çdo kusht nga gabimet e tua. Dhe më mirë akoma është të mësosh nga gabimet e të tjerëve. Është më e lehtë.*
- Ti nuk e ke njohur kurrë një grua derisa ajo të ka shkruar një letër.*

Citati mbyllës:

"Fjalët e thëna nga dashuria e madhe ose urrejtja e madhe vënë në lëvizje gjëra brenda zemrës njerëzore që nuk mund të kthehen kurrë".

Frederick Buechner

MISTERI

PASI XHULIANI U KTHYE NË SHTËPI, E LA CELULARIN të ftohej dhe lexoi *e-mail*-in e saj, e lexoi përsëri e përsëri derisa iu skalit në zemër. Disa orë më vonë e zuri gjumi në divan, pasi kishte parë në një kanal sportiv në televizor ca ndeshje të vjetra tenisi të *Wimbledon*, me zë aq të ngritur, sa e vetmja gjë që mund të dëgjonte ishte topi, që me një ritëm të përshpejtuar përplasej në bar, dhe zhurma ngjante si e shtënë arme me silenciator.



Xhulian, dashuria ime,

Më fal shumë. Derisa ta lexosh këtë mesazh, ka shumë gjasë që ta dish se çfarë lëmshi kam bërë. Ndihem tmerrësisht keq. Nuk kisha gjetur atë që kërkoja, kështu që jeta ime e shkretë ishte e mbushur me mbetjet e kërkimit tim të pafrytshëm. Nuk është faji im që ti u shfaqe kur unë po i humbisja shpresat. Pse u vonove kaq shumë z. Kruz. Më fal që nuk munda ta ndreq më shpejt kaosin që kam shkaktuar në jetën time. Gjithçka po del jashtë kontrollit, e di, por nuk mendova që, me të vërtetë, do të gjeja dikë si ti. Kush do ta kishte menduar se do të takoja një burrë të mirë, si kisha shpresuar dikur. Ëndërroja një tip si ti kur isha e re, por ka kaluar një kohë e gjatë që atëherë. Unë dhe ti ishim bashkë në oqean me rroba veshur, madje edhe me palltot tona. Kur të të shoh do të t'i tregoj të gjitha. Por kur, më në fund, të gjeta, nuk isha gati. E dreqosa. Bëra gabime. Pavarësisht se çfarë mendon ti, unë nuk jam e përkryer. Do bëj të pamundurën për të rregulluar gjithçka dhe shpresoj që kur të mbaroj, ti do të jesh duke më pritur. Të lutem mos hiq dorë prej meje.

E ndiej me gjithë zemër që për mua nuk ka të ardhme nëse nuk jemi bashkë.

Me dashuri,

Mia.



Të nesërmen në mëngjes herët i kishte ardhur një tjetër mesazh nga ajo në celular.

Xhuls, nuk po i përgjigjesh telefonatave të mia? Eja tani, përgjigju. Të thashë që do të rregulloja çdo gjë. Fario erdhi, dhe i thashë gjithçka. Ishte kaq e vështirë, por tani mbaroi. A mund të takohemi që të mund të shpjegojem? E di që je i mërzitur, dhe ke çdo të drejtë të jesh, por unë do t'i bëj gjërat më mirë. Të premtoj, nuk do të ketë më sekrete mes nesh. Më jep një shans tjetër. Më tako në mesditë, tek vendi ynë, te Coffee Plus Food. Dua thjesht të të them... nëse dëshiron ende të martohesh me mua, jam gati. Jam e lirë. Ti ishe kaq i mërzitur dje, dhe unë u frikësova e doja të mbroja veten, dhe nuk të thashë gjërat që duhet të kisha thënë. Më lër të korrigjoj gjithçka sot. Mos ji aq i inatosur me mua, megjithëse e meritoj. Shihemi në mesditë, shpresoj. Do të jem duke të të pritur.

Xhuliani nuk dinte ç'të bënte. I telefoni Eshtoni.

- Je i çmendur? - tha Eshtoni.

- Thjesht dua të dëgjoj çfarë ka për të më thënë.

- Të ka ikur mendja?

Xhuliani iu kthye po në mënyrë armiqësore. - Po gjithë ato gjërat që më the dje?

- I thashë për të të bërë të ndiheshe më mirë. Gjithashtu, dje nuk më the këto budallallëqe që sapo m'i the.

- Nuk t'i thashë se nuk i dija.

- Pikërisht! Pra, kur faktet ndryshojnë, ndryshojmë edhe opinionin. Këtë bëjnë njerëzit e arsyeshem, - tha Eshtoni. - Por duhet të më dëgjosh. Dje nuk ia kisha idenë që do të ishte i vërtetë skenari më i keq. Domethënë, dyshoja që mund të ishte, por shpresoja të mos ishte. Mendova se ajo do të ishte një gënjeshtare më e mirë.

Jo: eh, Xhuls, është po aq keq sa ti mendoje se ishte. Nuk jam, në të vërtetë, ajo që them se jam, dhe, në të vërtetë, të mashtrova

për muaj të tërë, dhe vajta me një djalë tjetër teksa isha me ty dhe po planifikoja të martohesha me dikë tjetër teksa po planifikoja të martohesha edhe me ty.

- Ky nuk është skenari më i keq, - tha Xhuliani. Ai kishte frikë se ajo donte të martohet me dikë tjetër. Ky ishte skenari më i keq.

- Nuk mund t'i kthesh gjërat siç ishin me të.

- Dhe nuk e dua këtë, - tha Xhuliani. - Dua të shkoj përpara, këtë dua.

- Tani që e di të vërtetën, nuk ka të ardhme me të, - tha Eshtoni.

- Nuk ka të ardhme të mirë.

Xhuliani nuk foli.

- E di që nuk e do këshillën time, - tha Eshtoni, - por *duhet* të më dëgjosh. Unë nuk jam njeriu i duhur në lidhje me këshillat për jetën. Ta tregova këtë sot në mëngjes. Dallimi është që, unë jam ai që duhet të jetojë me pasojat e zgjedhjeve të tua. Me pasojat e *të gjitha* zgjedhjeve të tua. Si atëherë kur ishim në Topanga. Të thashë të më prisje, të mos ikje vetëm, po a më dëgjove? Edhe atëherë mendoje se dije çdo drejt gjëje. Kur do të mësosh? Nuk e kupton që çdo gjë që bën, ndikon edhe tek unë.

- Në rregull.

- Mos më thuaj “në rregull”. Mos u mundo të më heqësh qafe.

- Do të shkoj ta dëgjoj çfarë ka për të më thënë, Esh. I detyrohem kaq. Të dëgjoj çfarë do të më thotë.

- Po, e di. Gjithçka që ti do, është të besosh gënjeshtret e saj të dëshpëruara, - tha Eshtoni. - Që ajo të do, e të tjera si këto, se nuk ekziston askush tjetër, dhe asnjëherë nuk do të ekzistojë. A i telefonove *Brentwood*-it për ta *anulluar*?

- Jo, akoma.

- Xhulian!

- Fillimisht do e dëgjoj, Eshton.

- Pse? Ti e di çfarë do të më thotë. Më fal, Xhuls. Nuk do të ndodhë më kurrë, Xhuls. Janë të gjitha broçkulla. Më prit, - tha Eshtoni, - do të jem aty për njëzetë minuta. Në orën njëmbëdhjetë kemi një takim për të parë skenën e një seriali komik të vjetër pranë magazinës së kanalit CBS. Ti e di që nuk mund të negocioj pa pesimizmin tënd. Mund të më ndalosh që të mos bëj ofertë për të blerë budallallëqet e *I Love Lucy*, për të cilat nuk kam nevojë dhe

nuk i përballoj dot. Do të shkojmë te *Shutters* për drekë. Marina Del Rey po ofron mësimë lundrimi për dy vetë në orën tre. Eja shkojmë të mësojmë si të lundrojmë.

- Jo.

- Nuk bën, Xhulian, - tha Eshtoni. - Ajo nuk është e mirë për ty. Asaj nuk mund t'i zihet besë. Nëse një grua mund të të gënjejë për diçka të tillë, ajo do të të gënjejë për çdo gjë. Çdo gjë. Nuk e kupton? Nuk mund të jesh me një njeri të tillë. Ti *pa dyshim* që nuk mund të martohesh me të.

- Kush flet për besim.

- A po më sheh gjë gati për t'u martuar?

- Nuk mund të mendosh për gjë tjetër përveç vetes sate? - shpërtheu Xhuliani.

- Çfarë keni të gjithë, mund të më thuash? - tha Eshtoni. - Nuk po mendoj për veten time. Po mendoj vetëm për ty.

Xhuliani nuk dinte çfarë të thoshte. Ai kishte frikë se shoku i tij kishte të drejtë. Ai nuk donte të dëgjonte më. E mbylli telefonin.

Në 11:30, Xhuliani shkoi me makinë te kryqëzimi i rrugëve "Melrose" dhe "Gower", te *Coffee Plus Food*, ku parkoi dhe gjeti një tavolinë të vogël metalike jashtë në rrugë. Porositi dy kafe, dy petulla dhe një byrek me salsicë. Nxori telefonin, lundroi pak në internet, u ul, dhe priti.

Ai uronte të mos e kishte marrë Eshtonin në telefon. Ai në përgjithësi kishte të drejtë, por në thelb gabohej. Argumenti i Eshtonit ishte një argument intelektual, joemocional. Ky ishte ndryshe. Askush nuk e dinte çfarë ndodhte, në të vërtetë, në intimitetin midis dy qenieve njerëzore. Ajo çfarë bënë disa njerëz nuk ishte tregues për atë që do të bënin njerëz të tjerë. Eksperienca të kaluara nuk ishin dëshmi e ngjarjeve të së ardhmes. Xhuliani e besonte këtë me vendosmëri. Fakti që një vajzë bëri një herë diçka të pabesueshme, kjo nuk do të thoshte që asaj nuk mund t'i besohej në të ardhmen. Kjo mënyrë e të menduarit ishte një falsitet logjik dhe mendja e Xhulianit e hodhi poshtë lehtë, si të gjuante një mizë. E ardhmja, bazuar që në përkufizim, ishte e panjohur.

Në një nivel emocional? Argumenti i Eshtonit nuk prekte dot as shtresën e parë të lëkurës. Xhuliani nuk mund të mos ishte me

të, kjo ishte e gjitha. Çdolloj hapi që duhej të bënte, do ta bënte. Çfarëdolloj marrëveshesh duhet të bënte me veten, ai do t'i bënte.

Fundi i argumentit.

Fundi i historisë.

Ai nuk mund të mos ishte me të.

Kafja po ftohej. Nuk po e pinte, sepse priste atë.

Mesdita erdhi dhe iku.

Ajo ishte vonë.

Tri makina policie, me sirenat ndezur, i kaluan zhurmshëm para.

Në “Melrose Avenue” kishte shumë trafik.

Pas disa minutash të palëvizshme, Xhuliani filloi të ndiente njëfarë shqetësimi, por më shumë ngjante me një frikë të pakuptueshme, që po e bënte të ngrinte si nga jashtë, ashtu dhe nga brenda.

A e kishte gënjyer? Kishte ndryshuar mendjen? Vendosi të mos vinte?

Ai filloi të dridhej në mënyrë të pashpjegueshme, edhe pse në L. A. temperatura ishte tridhjetë gradë. Çfarë nuk shkonte me të? U përpoq t'i rikthehej lundrimit në internet në celularin e tij. Por, shikimi i tij ishte i turbullt.

U ngrit, për të shtriqur këmbët, për t'u fokusuar në diçka në distancë... një këshillë jete për ata që ia ngulin sytë diçkaje nga afër për një kohë të gjatë si ekrane kompjuterësh dhe unaza martesash... duke u munduar të largonte ankthin e flohtë që vërshoi në trupin e tij.

Në këtë moment pa Jozefinën duke ecur drejt tij në rrugën “Melrose”. Ajo kishte vendosur të ecte nga “Normandie” për ta takuar atë në kafene. Ajo po buzëqeshte, duke ecur me ngadalë, pa u nxituar. Xhuliani ndjeu aq lehtësim, sa nuk e mbanin këmbët. Ai bëri një hap drejt saj dhe tha, - Zot, ku ishe?

- Jam këtu, - i tha.

- Fillova të merakosesha, - tha Xhuliani.

Nga tavolina ngjitur ai dëgjoi një burrë të thoshte: - A je mirë, plako?

Me ngadalë, Xhuliani u kthye. - Pse më flet mua?

- Sepse u rrëzove, vëlla.

Xhuliani u rrotullua në drejtim të vendit ku ajo sapo kishte qenë. Nuk kishte asgjë përveç trotuarit bosh. Duke i ngatërruar këmbët, ai rrëzoi një karrige dhe i bërtiti të panjohurit dashamirës. - Çfarë bëre? Çfarë bëre?

- Çfarë ke, or burrë, thjesht po mundohem të të ndihmoj. Nuk dukesh aq mirë. Do të telefonoj dikë?

Xhuliani vrapoi. Ai nuk ishte në gjendje për t'i dhënë makinës. Iu deshën më pak se gjashtë minuta për të përshkuar rrugën "Melrose" deri në "Normadie" me mokasinet e lehta që kishte veshur. Një autoambulancë e parakaloi me shpejtësi, pastaj një tjetër, tri makina zjarrfikësesh, dhe një makinë policie. Atij nuk iu desh të merrte kthesën që të merrte me mend situatën emergjente para shtëpisë së Zakijas. Ai e ndjeu në shpirt.

Por gjithsesi, duke parë turmën e njerëzve që ishin grumbulluar, dritat vezulluese, tymin mbytës, u detyrua të përkulej para.

Rruga ishte e bllokuar nga makina policie dhe drita për të ndaluar trafikun. Një oficer u mundua ta kapte. Për ta ndihmuar apo për ta ndaluar? - Unë jetoj këtu, - tha Xhuliani, duke e shtyrë. - Jetoj në atë shtëpi. - Fqinjët mbushën rrugën. Ai i shtyu, duke u munduar të arrinte aty ku ishin mbledhur më shumë njerëz. Nuk mund të shihte mbrapa shpinave të njerëzve. Ai vrapoi me shpejtësi dhe mezi po merrte frymë.

- *Como esta, mio Dio, como esta?* - një grua e vjetër në moshë po pyeste një grua më të re.

- Nuk e di, Mami, nëse ishte një përplasje me armë? Aksident? Askush nuk e di. Ndoshta shoferi pësoi infarkt dhe u përplas me pemën. Jam e sigurt që dëgjova të shtënë arme. Është e tmerrshme çfarë i ka ndodhur kësaj lagjeje.

- Dikush u qëllua me armë? Po pse është makina në flakë?

Një grua tjetër foli. Askush nuk donte ta kthente kokën larg rrugës të mbushur me njerëz.

- *Chica pobre! Que pena!*

- *Chica pobre?* - bërtiti një grua tjetër. - Popa W. u qëllua me armë!

- *Mio Dio!*

Askush nuk mund të shihte gjë.